

EMIL LAFE

## LIDHËZAT TE LIBRI I PARË SHQIP

Është një fakt i njohur që deri më sot vëmendjen e gjuhëtarëve që janë marrë me studimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, qoftë në planin sinkronik, qoftë në planin diakronik, e kanë tërhequr më shumë pjesët emërtuese të ligjëratës, ndërsa të ashtuquajturat pjesë shërbyese, kanë qenë, si të thuash, në periferi të studimeve gramatikore. Ndërkaq, këto pjesë shërbyese, sidomos parafjalët dhe lidhëzat, kryejnë në gjuhë shërbime shumë të rëndësishme, prandaj pa njohjen dhe studimin e gjithanshëm e të thelluar të tyre, nuk mund të bëhet një përshkrim i qartë e i plotë i sistemit gramatikor të shqipes së sotme ose të shekujve të shkuar. Duke e vënë re këtë mungesë, prof. Aleksandër Xhuvani në vitet e fundit të jetës së tij iu vu punës me zell për studimin e parafjalëve dhe na la një punim të plotë për këtë pjesë të ligjëratës<sup>1</sup>. Që prej asaj kohe studimi i pjesëve shërbyese të ligjëratës ka ecur mjaft përpara dhe sidomos vitet e fundit, gjatë punës për hartimin e një gramatike shkencore të gjuhës letrare të sotme. Për pjesëzat janë botuar dy studime të veçanta<sup>2</sup>, ndërsa për lidhëzat, megjithëse ende mungon një studim përgjithësues, japin një material të pasur tekstet e sintaksës të S. Piftit e të M. Domit dhe një numër punimesh të S. Floqit, botuar në këtë revistë.

Njohja e së shkuarës është kurdoherë e dobishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë të tashmen edhe në fushën e studimeve gramatikore. Studimi i gjithanshëm i gjuhës së veprës së Gjon Buzukut, si monumenti më i vjetër i letërsisë shqipe, është një nga detyrat e para që duhen përmbushur për të filluar një studim sistematik rreth zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi e të gjuhës letrare në veçanti në këta katër shekuj. Për gjuhën e librit të Gjon Buzukut nuk është shkruar pak<sup>3</sup>, por struktura morfologjike e saj, dhe aq më pak sintaksa, nuk janë përshkruar ende në mënyrë të plotë dhe sistematike. Një nga çështjet që meritojnë të studjohen më me imtësi është edhe ndërtimi e funksioni i lidhëzave. Duke ditur si paraqitet kjo pjesë e ligjëratës te libri i Buzukut, mund të kuptojmë më mirë se nga ç'bazë është nisur dhe si është zhvilluar ai sistem i pasur e i zhdërvjellët i

1) A. Xhuvani, *Parafjalët*, «Studime filologjike» nr. 1, 1964, fq. 7-59.

2) Josif Kole, *Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme*, «Studime filologjike» nr. 3, 1969 fq. 75-108; E. Angoni, *Pjesëzat në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike»; nr. 3, 1971 f. 3-20.

3) Pasqyrën më të plotë të studimeve të ndryshme për gjuhën e Buzukut e gjejmë te «Hyrja» e botimit kritik të kësaj vepre nga E. Çabej, «*Meshari*» i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik punuar nga E. Çabej, Pjesa e parë, Tiranë 1968.

mjeteve lidhëzore që ka gjuha e sotme letrare. Libri i Buzukut na jep një lëndë të pasur si për të hetuar mënyrën dhe fazat e formimit të lidhëzave të përngjitura e lokucione, ashtu edhe për të ndjekur zhvillimin e kuptimeve të tyre në shekujt e mëpastajmë. Sidomos për formimin e lidhëzave të përngjitura këtu dalin të dhëna me interes, që na lejojnë të shohim se në ç'kushte sintaktike ka ndodhur procesi i përngjitjes.

Në njëqind e tetëdhjetë e tetë faqet që janë ruajtur të plota prej «Mesharit» të Buzukut dalin 56 lidhëza (të thjeshta, të përngjitura e lokucione)<sup>4</sup>, dhjetë prej të cilave përdoren me dy a më shumë kuptime. Po t'i numërojmë këto të fundit si fjalë të veçanta për çdo kuptim që mund të kenë, atëhere numri i përgjithshëm i lidhëzave arrin në 75, por 26 prej tyre janë përdorur vetëm nga një herë, ndërsa 9 vetëm nga dy herë.

Ky punim u hartua duke u mbështetur në vjeljen shteruese të krejt lidhëzave që dalin te «Meshari»<sup>5</sup> dhe duke analizuar një për një të gjitha përdorimet e tyre, kurdoherë në krahasim edhe me tekstin latin të Biblës. Kjo na ka dhënë mundësi të shënojmë për çdo lidhëz sa herë përdoret me këtë ose atë kuptim dhe ta plotësojmë punimin kështu edhe me të dhëna statistikore, që në shumë raste ndihmojnë për të kuptuar më qartë zhvillimet që kanë ndodhur në sistemin lidhëzor të shqipes.

#### I. Tipet e lidhëzave nga pikëpamja e prejardhjes dhe e ndërtimit të tyre.

Nga pikëpamja e prejardhjes, lidhëzat që dalin te «Meshari» do t'i ndajmë në: 1) lidhëza të parme, «origjinare» (d.m.th. që nuk rrjedhin prej pjesësh të tjera të ligjëratës) dhe 2) lidhëza të prejardhura (d.m.th. që janë formuar prej pjesësh të tjera të ligjëratës a prej fjalësh të tjera).

Lidhëza të parme janë *e*, *edhe*<sup>6</sup>, *ma*, *në*, *o*, *opur*, *po*, *por*<sup>7</sup>, *pur*, *tekë*. Nga këto, veçuesja *opur* (përdorur vetëm një herë) dhe kundërshtorja *pur* (përdorur katër herë) duket qartë se vijnë përkatësisht nga it. *oppure* «o, ose» e *eppure* «megjithatë». Nga vetë përdorimi shumë i kufizuar i tyre, kuptohet lehtë se ato nuk janë huazime të gjuhës së popullit, por huazime librash. Edhe fjala *tekë*, që del te Buzuku gjithësej katër herë, ndër to dy herë si lidhëz qëllimore, është një turqizëm e marrë nëpërmjet serbokroatishtes dhe nuk del

4) Shih pasqyrat në fund të punimit.

5) Shembëllat jepen sipas transkribimit të Eqrem Çabejt. Brenda kllapash shënohen: numri i faqes së fotokopjes, shtylla (me *a* e majta me *b* e djathta) dhe numri i rreshtit. Citimi bëhet sipas botimit, «Meshari» i Gjon Buzukut (1555), Botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë 1968.

6) Në kundërshtim me përshtypjen e përgjithshme se *edhe* vjen nga *e* + *dhe*, duke u nisur nga dëshmia e autorëve të vjetër dhe e kolonive arbëreshe që nuk kanë fare *dhe*, po vetëm *edhe*, këtë lidhëz do ta mbajmë si fjalë të thjeshtë, ndërsa *dhe*-në e sotme si një formim regresiv nga zbërthimi i *edhe*-së në *e* + *dhe* (shih: E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, V, Buletin i USHT; seria shk: shoq. nr. 2, 1962, f. 111).

7) Lidhëzat kundërshtore *po* e *por* nuk kanë dallim morfologjik, por vetëm fonetik, prandaj do t'i mbajmë si fjalë njësoj të thjeshta.

më te autorët e tjerë të vjetër e as në ndonjë dialekt. Të tria këto lidhëza *opur*, *pur* dhe *tekë* duhen mbajtur si lidhëza vetjake të Buzukut. Të tjerat janë edhe sot fjalë të mbarë gjuhës (*e*, *edhe*, *në*, *o*, *po*, *por*), me përjashtim të kundërshtores *ma* që ka dalë nga përdorimi. Lidhëzat *ma* e *o* pranohen si huazime nga it. *ma* «por»<sup>8</sup> e *o* «o, ose»<sup>9</sup>. Mendimi i Meyerit se *dhe* vjen nga tq. *de*, ndërsa *po* e *por* nga lat. *porro* nuk pranohet më<sup>10</sup>. Është vënë në dyshim edhe etimologjia e *e* nga lat. *et*, që jep Meyeri në fjalorin e tij etimologjik<sup>11</sup>. Etimologjia e lidhëzave të tjera është ende e diskutueshme.

Të gjitha lidhëzat e parme morfologjiksht janë fjalë të thjeshta.

Lidhëzat e prejardhura të Buzukut janë shumë më tepër se të parmet dhe nga pikëpamja e ndërtimit paraqiten si a) të thjeshta, b) të përbëra, c) lokucione.

Lidhëzat e thjeshta janë gati të gjitha me burim përemëror. Ndër to dallohen dy grupe: a<sub>1</sub>) lidhëza që gjenetiksht lidhen me ndajfolje përemërore dhe që duket se janë mjaft të vjetra në gjuhë: *ku*, *kur*, *si*, *tek*, *tuk* dhe a<sub>2</sub>) lidhëza të formuara nga trajta rasore të ngurosura të përemrave pyetës e lidhorë, *qi*, *qysh*<sup>12</sup>, *sa*, *se*.

Me burim jopëremëror në këtë kategori lidhëzash janë vetëm tri: veçuesja *a*, që vjen nga pjesëza pyetëse *a*<sup>13</sup>, *kini* «sikur», që s'është gjë tjetër veçse trajta e vetës së dytë shumës e urdhërores së foljes *kam*<sup>14</sup>, dhe *djerie*, që është njëkohësisht edhe parafjalë. Përdorimi mjaft i kufizuar i kësaj fjale si lidhëz, në krahasim me përdorimin e saj si parafjalë, është një provë që tregon se lidhëza ka dalë nga parafjala dhe jo anasjelltas<sup>15</sup>.

Lidhëzat e përngjitura janë gjithashtu pak, gjithësej dhjetë. Sipas natyrës së fjalëve që hyjnë në përbërjen e tyre ato mund të ndahen në: b<sub>1</sub>) lidhëza që kanë si fjalë të dytë një nga lidhëzat e thjeshta përemërore (*sā*, *se*, *si*) dhe b<sub>2</sub>) lidhëza të formuara pa pjesëmarrjen e ndonjë lidhëze përemërore. Duke marrë parasysh dhe fjalën e parë të përngjitjes, në nëngrupin b<sub>1</sub> dallojmë këto nëndarje

8) G. Meyer; *Etymologisches Wörterbuch*; f. 252; sipas tij lidhëza *ma* ka hyrë edhe në greqishten e re e në serbokroatishten. T. Papahagi; *Dictionarul dialectului aromân*; f. 649 e jep edhe për aromunishten. Nga autorët e vjetër, veç Buzukut, ku kjo lidhëz del 105 herë, një *maa* (me *a* të gjatë) ka edhe Bardhi te lat. *sed*. Prania e kësaj lidhëze te dialektet e te shkrimtarët e arbëreshëve të Italisë, duke filluar (sipas St. E. Mann; *An historical albanian-english dictionary*, 1948 f. 258) me Varibobën, është e vetëkuptueshme. Siç duket, në kohë të mesme, kjo lidhëz do të ketë qenë përdorur jo vetëm nga shkrimtarët e Veriut, por edhe nëpër të folmet e atyre anëve që kanë pësuar një ndikim më të fortë nga italishtja, siç është Shqipëria Veriperëndimore, pa mundur të shtrihet më gjerë e të mbijetojë deri sot.

9) G. Meyer, *vep. cit.*, f. 314.

10) E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* (dorëshkrim).

11) E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, V, Buletin i USHT, seria shk. shoq. nr. 2 1962; f. 111.

12) Etimologjiksht *qysh* (*qish*), *që*, *qi*, *ç*, (*çë*) janë një fjalë, por si ka dalë pikërisht forma *qysh* (*qish*), kjo ende nuk është sqaruar (shih: E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* II, Buletin i USHT seria shk. shoq. nr. 1 1961, f. 71).

13) E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* I, (në shtyp).

14) E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* XII, «Studime filologjike», nr. 1, 1964, f. 68.

15) Nga sa kemi hetuar, *deri*, *gjer*, *njer* e të tjera variante fonetike të kësaj fjale përdoren si lidhëza kohore vetëm nëpër disa të folme anësore, si në ato të Shkodrës, Dibërës e Korçës.

të mëtejshme: lidhëza që kanë fjalë të parë një lidhëz të thjeshtë: *ose, porsî*; lidhëza që kanë si fjalë të parë një parafjalë: *mbassi, përsâ, përsë*; lidhëza që kanë si fjalë të parë një ndajfolje: *mâse*<sup>16</sup>, *veçëse*.

Në grupin *b*<sub>2</sub> (lidhëza të formuara pa pjesëmarrjen e ndonjë lidhëze përemërore) hyjnë *as, mos e ndo*. Dy të parat kanë të përbashkët elementin e dytë, që s'është gjë tjetër veçse pjesëza e mohimit *s*<sup>17</sup>, por, ndërsa *as* shërben vetëm si lidhëz, *mos* është një pjesëz mohimi që, duke u përsëritur para gjymtyrësh emërore të bashkërenditura, ka kaluar në lidhëz me kuptimin «as». Lidhëza *ndo*, siç mund të kuptohet lehtë, është formuar nga përngjitja e lidhëzës kushtore në me foljen *do*, që sipas Hahnit<sup>18</sup>, Kamardës<sup>19</sup> e Meyerit<sup>20</sup> është trajta e vetës së dytë të foljes *dua*.

Lokucionet lidhëzore të Gjon Buzukut janë rreth njëzet e pesë: *aqë sâ, ashtu qi, djerie kur, djerie mbë herë qi, djerie mos, djerie sâ, gjithë herë qi, kinë se, mbë herë qi, mirë se, mirë se në, në kloftë qi, në kloftë se, parë se, për gjithë herë qi, përherë qi, porsî në, qish kur, sâ ku, se në dhe lokucionet dyshe e trishe: jo se ... ma ... edhe, jo se ... por (edhe), porsî ... ashtu, si ... ashtu, se ... në*.

Duke i klasifikuar të parat sipas fjalës lidhëse me të cilën janë bashkuar fjala ose fjalët e tjera të lokucionit dhe sipas përkatësisë kategoriale të këtyre të fundit, marrim pasqyrën e mëposhtme:

1) Lokucione të formuara me pjesëmarrjen e një lidhëze:

a) lidhëz e bashkuar me një ndajfolje: *aqë sâ, ashtu qi, mirë se*<sup>21</sup>, *parë se, sâ ku*. Me përjashtim të lokucionit të fundit, në gjithë të tjerët lidhëza zë vendin e dytë. Lokucioni kohor *sâ ku*, mënyrën e formimit të të cilit nuk kemi mundur ta sqarojmë, përfaqëson nga kjo pikëpamje një rast të veçantë;

b) lidhëz e bashkuar me një parafjalë: *djerie kur, djerie sâ, qish kur*;

c) lidhëz e bashkuar me një trajtë foljore: *kinë se*<sup>22</sup>.

ç) lidhëz e bashkuar me një trajtë foljore të prirë nga një lidhëz tjetër: *në kloftë qi, në kloftë se*;

d) lidhëz e bashkuar me një lidhëz tjetër (kjo e fundit mund të jetë vetë një lokucion): *porsî në, se n(ë), mirë se në*;

16) Rrethanat e përdorimit e të formimit të kësaj lidhëze të përngjitur na e bëjnë të qartë se fjala e parë e saj *mâ* është ndajfolja e sasisë dhe jo lidhëza kundërshtore homonime (e cila ndërkaq përgjithësisht nuk e ka a-në të gjatë); shih edhe më poshtë f. 120.

17) Për formimin e tyre shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* I, Buletin i USHT, seria shk. shoq. nr. 4, 1960, f. 27, Po ai, *Studime rreth etimologjisë... XIV*; «Studime filologjike», nr. 3, 1964, f. 40.

18) J. G. von Hahn, *Albanesische Studien*; Heft III, Jena 1854, f. 23.

19) D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno 1864, f. 304.

20) G. Meyer, *vep; cit.*, f. 299;

21) Me përjashtim të së parës herë ku del kjo lidhëz (në 60b45) Buzuku shkruan ndaras: *mirë se*. E. Çabej në transkribimin e tij ndjek mënyrën e shkrimit të Buzukut, por jep si lexim të dytë edhe *mirëse* si një fjalë. Duke iu mbajtur si edhe për gjithë fjalët e tjera vetëm leximit të parë *mirë se*, këtë lidhëz po e trajtojmë si lokucion. S. Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, (dispensë) botim i USHT, Tiranë 1961, f. XXXVIII transkribon *mirëse* si një fjalë dhe e nxjerr kalk pas it. *benché*.

22) Fjala *kinë* e këtij lokucioni ka dalë nga urdhërorja *kini* e foljes *kam* me errësimin e *i*-së në *ë*, shih: E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* XII; «Studime filologjike», nr. 1 1964, f. 68.

dh) lidhëz e bashkuar me një pjesëz: *djerie mos*<sup>23</sup>.

2) Lokucione të formuara me pjesëmarrjen e përemrit lidhor *qi*: *gjithë herë qi, për gjithë herë qi, mbë herë qi, djerie mbë herë qi, përherë qi*. Në të gjitha këto lokucione me vlerë kohore përemri lidhor *qi* i referohet emrit *herë*, i cili te *përherë qi*, duke u bashkuar me parafjalën *për*, ka dhënë një ndajfolje: *përherë*.

Në grupin e lidhëzave dyshe bëjnë pjesë këto lokucione: *jo se ... ma ... edhe, jo se ... por (edhe)*, që të dyja me kuptimin «jo vetëm... por (edhe)», *porsi ... ashtu, si ... ashtu, se ... në*. Katër të parat janë lokucione bashkërenditëse këpujore. I fundit është një lokucion kushtor me kuptimin e lidhëzës së sotme *në se*, kur përdoret në fjali kushtore. Veç tri shembëllave me *se ... në* Buzuku ka edhe dy herë *se n(ë)*: me një fjali kundrinore në 176b41-2 dhe me një fjali kushtore te «Pas-thënia» në f. 386 rreshti 40<sup>24</sup>.

## II. Tipet e lidhëzave nga pikëpamja e funksioneve sintaktike dhe vërejtje rreth përdorimit të tyre.

Pasi trajtuam prejardhjen dhe ndërtimin e lidhëzave që përdor Gjon Buzuku, le t'i shohim tani një për një të grupuara sipas funksioneve sintaktike. Siç dihet, sipas funksioneve sintaktike lidhëzat ndahen në: *lidhëza bashkërenditëse* dhe *lidhëza nënrenditëse*<sup>25</sup>.

### Lidhëzat bashkërenditëse

Lidhëzat bashkërenditëse shërbejnë për të bashkuar dy gjymtyrë ose dy fjali me të njëjtën vlerë nga pikëpamja sintaksore.

Sipas kuptimeve që kanë e sipas marrëdhënjeve që shprehin, lidhëzat bashkërenditëse ndahen në: 1) lidhëza bashkërenditëse *këpujore*, 2) lidhëza bashkërenditëse *veçuese*, 3) lidhëza bashkërenditëse *kundërshtore*<sup>26</sup>.

#### 1. Lidhëzat bashkërenditëse këpujore.

Lidhëzat bashkërenditëse këpujore që gjejmë te Gjon Buzuku janë këto: *e, edhe, ende, as, mos* (nga këto, tri të parat kanë kuptim pohor, ndërsa dy të fundit kuptim mohor) dhe lokucionet *jo se ... ma ... edhe, jo se ... por (edhe), porsi ... ashtu* e *si ... ashtu*.

23) Që *mos* në këtë lokucion nuk ka kuptimin e pjesëzës mohuese, por ka vetëm kuptim përforcues dhe është pjesë e lidhëzës, shih më poshtë f. 133. Ky lokucion, që sot në variantet fonetike *der(i) mos, gjer mos* etj. përdoret vetëm me mënyrën lidhore, duke hyrë *mos-i* shpeshherë midis pjesëzës të e foljes, del nëpër ato të folme që kanë *deri* e *gjer* si lidhëza kohore dhe është pas gjase një kalk pas modeleve *бок не* të serbokroatishtes e *бокамо не* të bullgarishtes.

24) Për formimin e këtij lokucioni shih E.Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XV*, «Studime filologjike», nr. 4 1964, f. 96.

25) Shih pasqyrën përmbledhëse të tyre në fund të punimit.

26) Lidhëza përmblylëse te Gjon Buzuku nuk ka. Për këtë do të flasim më me hollësi në fund të trajtimit të lidhëzave bashkërenditëse.

1) Lidhëza *e* është fjala që ka dendurinë më të lartë në «Mesharin» e Gjon Buzukut. Ajo është përdorur gjithësej 8071 herë, me një mesatare prej gati 43 herë për faqe. Arësyeja e një dendurie kaq të lartë duhet kërkuar te veçoria e stilit biblik, që siç dihet, i parapëlqen shumë ndërtimet parataktike me këtë lidhëz. Por shqipja e kohës së Buzukut veç lidhëzës *e* ka pasur edhe një lidhëz tjetër sinonimike me të: *edhe*, e cila është përdorur 243 herë. Pra denduria e përdorimit të lidhëzës *e* te Gjon Buzuku është shumë më e lartë se denduria e përdorimit të lidhëzës *edhe*. Nuk ka arësye që të mos besojmë se ky raport pasqyron në thelb një veçori edhe të shqipes popullore të asaj kohe, së paku për ato anë nga ishte autori ynë. Me kalimin e kohës duket se lidhëza *edhe* fitoi një vlerë semantike më të veçantë dhe u shtri dalëngadalë, duke e ngushtuar përdorimin e lidhëzës *e*<sup>27</sup>. Është mjaft interesant një krahasim, qoftë edhe fare i pjesshëm, rreth përdorimit të këtyre lidhëzave te Gjon Buzuku e te Kostandin Kristoforidhi. Për të bërë këtë krahasim kemi marrë në mënyrë krejt arbitrare pjesën e djalit plangprishës (Ungjilli i Lukës 15,11-32). Në tekstin latinisht të kësaj pjese gjejmë 43 herë lidhëzën *et*. Buzuku në 8 raste e ka lënë pa e përkthyer këtë lidhëz, në 35 rastet e tjera e ka përkthyer me *e*, duke e përdorur këtë lidhëz edhe në 14 raste të tjera, të cilave nuk u përgjigjet ndonjë *et* në tekstin latinisht. Pra në këtë pjesë te Buzuku kemi gjithësej 49 *e*, por asnjë *edhe*. Te K. Kristoforidhi (përkthimi gegërisht) gjendja paraqitet ndryshe: aty gjejmë 43 herë lidhëzën *edhe* e 15 herë lidhëzën *e*. Kristoforidhi nuk i përdor krejt njëllëj këto dy lidhëza sinonimike. Në krye të periudhës, për shembull, nuk ka *e*, si te Buzuku, por *edhe*. Le të krahasojmë paragrafet 31-32 të pjesës në fjalë te Buzuku e te Kristoforidhi.

Buzuku: *E i tha përindi: Bër, ti je përherë me muo, e gjithë kafshëtë e mī janë të tū. E u<sup>28</sup> desh me u gëzuom e me marë kā plot, përse kŷ ŷit vēllā kle vdekunē, e u ngjāll, kle bdjerē e u gjet.*

Lat.: At ipse dixit illi: Fili, tu semper mecum es, et omnia mea tua sunt: epulari autem et gaudere oportebat, quia frater tuus hic mortuus erat, et reuixit: perierat, et inuentus est.

Kristoforidhi: *Edhe ai i tha, o Dial, ti jē përherë bashkë me mue, edhe gjithë të miatë janë të tuatë. Edhe duhej me u gazëmuem e me u gëzuem: sepse kyj yt-vëlla qe i vdekun' e u ngjall për-së-ri; edhe qe i hupun', e u gjind.*

Siç shihet, në këta dy paragrafë te Buzuku gjejmë 6 herë lidhëzën *e*, ndërsa te Kristoforidhi 4 herë lidhëzën *edhe* dhe 3 herë lidhëzën *e*.<sup>29</sup>

27) Sipas K.Cipos (*Sintaksa*, 1952, f. 11) e M.Domit (*Gramatika e gjuhës shqipe Sintaksa*, 1955, f. 130) lidhëza *e* i lidh gjymtyrët ose fjalitë e bashkërenditura më ngushtë se lidhëzat *dhe*, *edhe*. Ne pajtohemi me këtë mendim, me gjithë kundërshtimin e S. Floqit (shih: *Fjalja e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, në «Buletin për shkencat shoqërore» 2, 1956 f. 10), por duhet pranuar se veçantitë e përdorimeve të këtyre lidhëzave këpujore sinonimike ende nuk janë vënë në dukje.

28) Shenja *u* shënon një *u* gjysmëzanore.

29) Kristoforidhi ka një *edhe* më tepër (*edhe qe i hupun' e u gjind*) pas gr. *zai ἀπολωλὸς ἦτο zaí eúrēθη*

Përdorimin e lidhëzës *e* si edhe të gjithë lidhëzave të tjera bashkërenditëse do ta shikojmë së pari në fjali e pastaj në periudhë.

Në fjali lidhëza *e* shërben për të bashkuar dy gjymtyrë homogjene: kryefjalë, kallëzues, kundrina, cilësorë, plotës etj., p.sh. *u e këjo gruo ishnjim ndë një shtëpī* «ego et mulier haec habitabamus in domo una» (170a29 Mbretërit III 3,17); *Ti je ndima eme e të ruojtunitë tem* «Adjutor meus, et liberator meus es tu» (52b10 Psalm 69,6); *Përmbi kë të shofsh Shpirtinë me u djergunë e me pushuom përmbi të, aj anshtë aj qi të pagëzonjë ndë Shpirt shenjt* «Super quem videris Spiritum descendentem, et manentem super eum, hic est qui baptizat in Spiritu sancto» (98b34 Gjoni 1,33); *E gjet ndë klisëhë ata qi shisnë qëtë e dhentë e pollumbatë* «Et invenit in templo vendentes boves et oves et columbas» (170b33 Gjoni 2,14); *Aj të vë përpara tī porsī porteka e porsī ranza e barit qi lindetë për të thātë* «Et ascendet sicut virgultum coram eo, et sicut radix de terra sitiēti» (214b28 Isaia 53,2) etj.

Lidhëza *e* mund të bashkojë edhe dy gjymtyrë johomogjene (p.sh. një plotës kohe e një plotës vendi): *përherë e mbë gjithë vend na ndimo* «Semper et ubique nos praevēni» (98b41 Postcommunio), por bashkërenditja këpujore e këtyre gjymtyrëve shpjegohet me anë të një elipse logjike të kallëzuesit: «*përherë [na ndimo] e mbë gjithë vend na ndimo*», si pasojë e së cilës lidhëza *e* ka dalë ndërmjet një plotësi kohe e një plotësi vendi. Lidhëza *e* merr pjesë edhe në disa lokucione të formuara nga përsëritja e një numërori: *të marrsh shtatë e shtatë* «tolle septena et septena», *q gjithë zojshīt qi fluturonjinë, kā d̄y e kā d̄y* «cunctumque volatile secundum genus suum», *e ata qi hinë ishnë p̄r d̄y e d̄y* «bina et bina ex omni carne» (230a5, 38, 39 Gjenezja 7, 2, 3, 14, 15).

Duke e parë tani lidhëzën *e* në periudhë, duhet të mbajmë parasysh se lidhëzat këpujore japin vetëm idenë e lidhjes në mënyrën më të përgjithshme, më të padiferencuar, më abstrakte, dhe prandaj lloji i marrëdhënjeve midis dy fjalive të bashkërenditura këpujore varet nga përmbajtja reale e tyre e jo nga lidhëza.<sup>30</sup>

Lidhëza *e* mund të bashkojë dy a më shumë fjali të bashkërenditura, që kanë ndërmjet tyre:

1) *Marrëdhënje thjesht këpujore: ti neve q anēmikut na ruoj, e q ditet së mortisë sanë na përze* «Tu nos ab hoste protege, Et mortis hora suscipe» (12a3 Ad sextam); *Gëzoni me ata qi gëzonjënë, e klanī me ata qi klanjënë* «Gaudere cum gaudentibus: flere cum flentibus» (100a36 Romakët 12, 15) etj.;

2) *Marrëdhënje kohore*. Këtu duhen dalluar: a) fjali që tregojnë veprime që kryhen në të njëjtën kohë, dhe b) fjali që tregojnë veprime që kryhen njëri pas tjetrit: *U kleshë me ngjërūom dhenë e atë me patë* «Circuivi terram et perambulavi eam» (384a30 Jobi 1,7); *Ju të*

30) *Sovremennyj russkij jazyk II*, pod redakciej E.M. Gallkinoj-Fedoruk, Moskva 1964, f. 540.

*dini se mbas d̄y diçç k̄a me u b̄am Pashka, e i biri i n̄ieriut k̄a me klenë tradhëtuum me u vum mb̄ë kryqt* «Scitis quia post biduum Pascha fiet, et filius hominis tradetur ut crucifigatur» (202b21 Mateu 26,2);

*Hinje se dimëni shkoi, e shiu vote* «Jam enim hiems transiit, imber abiit, et recessit» (332a41 Kënga e Këngëve 2, 11); *Afërou tash e më puth, biri em; Ngrey, ati em, e ha n̄ gjajet së birit tit* «Accede ad me, et da mihi osculum, fili mi», «Surge, pater mi et comede de venatione filii tui» (146b27, 44 Gjenezë 27,26,31);

3) *Marrëdhënje përqasjeje e kundërvënjeje: Hinje se Ezau em vëllā anshtë leshëtār, e u jam p̄a lesh* «Nosti quod Esau frater meus homo pilosus sit, et ego lenis» (146a33 Gjenezë 27,11); *Rëzonie ju këtë klishë, e u për tr̄i dit ta trajtonj* «Solvite templum hoc, et in tribus diebus aexcitabo illud» (172a2 Gjoni 2, 19); *U erdhshë ndë shtëpi tande, e nukë dhae ujë kambëvet mive, e këjo me lot laj kambëtë e m̄i* «Intravi in domum tuam, aquam pedibus meis non dedisti haec autem lacrimis rigavit pedes meos (196a14,15 Luka 7,44); *Sā trima të tim et kanë bukë tepërë, e u vdes un̄i!* «Quanti mercenarii patris mei abundant panibus, ego autem hic fame pereor!» (148b7 Luka 15,17); *përse k̄y em bir kle vdekunë, e u ngjall, kle bdjerë e u gjjet* «quia hic filius meus mortuus erat, et revixit: perierat, et inventus est» (148b26 Luka 15,24) etj.

4) *Marrëdhënje shkak-pasojë ose kusht-pasojë: Nd atë mot ish dita e festësë Xhudhivet, e vote Jezu ndë Jeruzalemt* «In illo tempore: Erat deis festus Judaeorum, et ascendit Jesus Jerosolymam» (130b23 Gjoni 5,1); *E shëtunde anshtë sod, e s t ep ligja me n̄uom shtratë ansi vendi* «Sabbatum est, non licet tibi tollere grabattum tuum» (132a2 Gjoni 5,10); *E pleqtë shihnë gjithë ditënë se ajo hin e se ajo shetatën; e u dogj zemëra e tyne nde e dashunit të saj* «Et videbant eam senes quotidie ingredientem, et deambulantem: et exarserunt in concupiscentiam ejus» (164a23 Danieli 13,8) *Ecëni edhe ju ndë vëneshtë teme, e u juve t u ap qish për të dërejhtë të jetë* «Ite et vos in vineam, et quod iustum fuerit dabo vobis» (106a38 Mateu 20,4) etj.

5) *Marrëdhënje qëllimore: Dan̄i pleqtë njanënë n̄ sjetërit, e u t̄i gjukonj* «Separate illos ab invicem procul, et dijudicabo eos» (78a28 Danieli 13,51).

Lidhëza e te Gjon Buzuku përdoret edhe në konstruktet që përmbajnë një enumeracion, të cilat janë mjaft të shpeshta në stilin e shkrimit të shenjtë: *E atë trat dërguonë e erdh me t att e me t amët e me të bijt e me gjithë gjen̄i të saj* «Et statim miserunt. Et venit cum parentibus, et filiis, et universis cognatis suis» (Danieli 13,29-30 164b23-25); *Qëtë por lëvronjinë, e garetë po kullosnjinë ndaj ta; e rynë Sabbejtë, e grabitnë gjithëqish kle, e trimatë gjithë i lëshuonë për fillt të shpatës; e u qyqe vetëmë shpëtova* «Boves arabant, et asinae pascebantur juxta eos, et irruerunt Sabaei, tuleruntque omnia, et pueros perucusserunt gladio, et evasi ego solus ut nuntiarrem tibi» (384b11-14 Jobi 1,14-15) etj.

Një veçori tjetër e gjuhës së Gjon Buzukut, që ka të bëjë edhe me stilin biblik në përgjithësi, është përdorimi i gjerë i lidhëzës e si shtesore (term i S. Floqit<sup>31</sup>, i përdorur me kuptimin e rus. *prisojedini-*

31) S. Floqi, *Fjalë e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, «Bulletin për shkencat shoqërore», nr. 2, 1956, f. 7.

*telnyj*, të cilin Shçerba në fjalorin e tij të njohur ruisht-frengjisht e përkthen *de jonction*, kurse O.S. Ahmanova<sup>32</sup> e përkthen vetëm anglisht me *conjunctive*). Siç ka vënë re L.V. Shçerba, lidhëzat bashkërenditëse mund të përdoren edhe me një funksion tjetër: në atë rast ato nuk i bashkojnë këto ose ato elemente në një të vetme, por vetëm i «pranëbashkojnë» (rus. *prisojedinjajut*) te elementi paraardhës<sup>33</sup>. Ndryshe nga rasti i lidhëzave bashkërenditëse, kur «të dyja gjymtyrët janë të pranishme në vetëdijen tonë, qoftë edhe në një formë të turbullt, që në fillim të të folurit, në këtë rast elementi i dytë shfaqet në vetëdije pas të parit ose në kohën e shprehjes së tij. Nga pikëpamja formale ky dallim funksioni shprehet me anë të theksit të frazës, nganjëherë me anë të pauzës dhe në përgjithësi me anë të intonacionit (kërkime ekzakte në lidhje me këtë nuk ka)»<sup>34</sup>.

Konstruktet me fjali shtesore janë mjaft karakteristike për stilin biblik. Lidhëza e në këtë rast vë njërin pranë tjetrit e i bën, si të thuash, varg fakte të ndryshme që dalin shkallë-shkallë në vetëdijen e folësit, p.sh. *E tha Zotynë Moiseut: Ndej dorënë tande përmbi detit, e të kthenenë ujënatë përmbi ata të Egjipit, e përmbi qerr të tyne e përmbi kalorët të tyne. E ndeni Moiseu dorënë e vet përmbi detit, e ktheu deri nde e klenët të ti ndënatatet; e ata të Egjipit por iknjinë përpara ti, e dërgoi pjetiposhtë ata të Egjipit ndë vjedmis detit. E u kthyenë ujënatë e mbëluonë qertë e kalorëtë përçark forcësë Faraonit, qi mbas si erdhënë ndë dët, e nukë mbet në sish asnjë frymë. E të bijtë e Israelit ecnë për të thatë për vdjesmis detit, e ujënatë u klenë atyne mūr mbë të djathët e mbë të shtëmanktët. E e shpëtoi Zotynë popullinë e ti t Israelit në duorshit së Egjipet. E pā populli i Israelit ata të Egjipit vdekunë pranë detit për të madht të mujtunë qi dora e Tinëzot kā fuqī; e druojtinë populli i Israelit e besuonë Tinëzot e Moiseut sherbëtori ti* «Et ait Dominus ad Moysen: Extende manum tuam super mare, ut revertantur aquae ad Aegyptios super currus et equites eorum. Cumque extendisset Moyses manum contra mare, reversum est primo diluculo ad priorem locum: fugientibusque Aegyptiis occurrerunt aquae, et involvit eos Dominus in mediis fluctibus. Reversaeque sunt aquae, et operuerunt currus et equites cuncti exercitus Pharaonis, qui sequentes ingressi fuerant mare: nec unus quidem superfuit ex eis. Filii autem Israel perrexerunt per medium sicci maris, et aquae eis erant quasi pro muro ta dextris et a sinistris: Liberavitque Dominus in die illa Israel de manu Aegyptiorum. Et viderunt Aegyptios mortuos super littus maris, et manum magnam quam exercuerat Dominus contra eos: timuitque populus Dominum, et crediderunt Domino, et Moysi servo ejus» (234a10-32 Eksodi 14,26-31). Të tilla shembëlla ka gati në çdo faqe të librit të Buzukut. Edhe ai vetë, ndoshta nën ndikimin e këtij stili, «psthënie» e shkurtër në fund të librit e ka ndërtuar në pjesën më të madhe me fjali e periudha që nisin me lidhëzën e të përdorur me vlerë shtesore: *U lus mbas sodi mā shpesh të yini në klishë, përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në e mbarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbë jū. E ata qi u monduonë djerie tash, mā*

32) O. S. Ahmanova, *Silovar' lingvističeskikh terminov*, Moskva, 1966, f. 362, 398.

33) L. V. Shçerba, *O çastjah reči v russkom jazyke në «Izbrannye raboty po ruskomu jazyku»*, Moskva, 1957, f. 80.

34) Po ai, *po aty*,

*mos u mondonjënë. E ju t ini të zgjedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë kã me klenë me jũ, ju tue ndjekunë të drejtënë e tue lanë të shirembënë. E këta ju tue bãm, Zotynë ka me shtuom' ndër jũ, se të korëtë taj të nglatetë djerie n së vjelash, e të vjelëtë djerie n së mbjellash. E u ma duo të mbaronj vepërënë teme, Tinëzot tue pëlqem (188)*

Pak herë lidhëza e është përdorur si pjesëz përforcuese me kuptimin edhe (shih më poshtë f. 112): *Ata në janë Xhudhĩ, edhe u jam. Ata në janë Izraeliti, e u «Hebraei sunt? et ego: Israelitae sunt? et ego» (108a14 Korintasit II 11,22); E m̄basandaj e një Xhakon gjak m Ungjill shkoi, e si e pã, bani kini nukë e sheh «Similiter et levita, cum esset secus locum, et videret eum, pertransiit» (292a6 Luka 10,32), shih dhe 190b39 etj.<sup>35</sup>. Një herë tjetër kjo lidhëz është përdorur posikur të ishte një ndajfolje korrelative: *ku ish fuqia e shpirtit, e yinjinë «ubi erat impetus spiritus illuc gradiebantur» (354b18 Exekieli 1,12).**

Disa herë është vështirë të thuhet për një e nëse është lidhëz apo trajtë e shkurtër përemërore. Kjo ndodh në ato raste kur në vend të një e-je që ka Buzuku, duke pasur parasysh origjinalin dhe natyrën e shqipes, pritej të kishim dy e, prej të cilave e para të ishte lidhëz, kurse e dyta trajtë e shkurtër përemërore, p.sh. *E zunë, e qitnë jashtë vëneshtënë, e n̄vranë «Et adprehensum eum eiecerunt extra vineam, et occiderunt», Kristoforidhi: «Edhe si e zunë, e nxuernë jashtë veshtit, edhe e vranë (144b18 Mateu 21,39); E shpunë n̄lidhunë e dhanë ndër duor të t madhit Pilat «Et vincitum adduxerunt eum, et tradiderunt Pontio Pilato», Kristoforidhi: «Edhe si e lidhnë, e prunë, edhe e dhanë ndër duer të Pontiut Pilatit»; E m̄bassi e patnë qellunë n̄ dhunë, i xveshnë cohënë e soldatet, e n̄veshnë ndë petëka të ti, e shpunë me e vum m̄bë kryqt «Et postquam inluserunt ei, exuerunt eum clamyde, et iduerunt eum vestimentis eius, et duxerunt eum ut crusifigerent» Kristoforidhi: «Edhe m̄bassi lueitnë me atë, i sveshnë klamidën', edhe i veshnë petkat' e atë, edhe e prunë për me e kryqëzuem» (208a7; b43 Mateu 27,2, 31); Askush nukë ndhezën luqerënë, e ve m̄bë të n̄fshehunë, as përndenë mastelt «Nemo lucernam accendit, et in obscondito ponit, neque sub modio», Kristoforidhi: *Edhe kurkushi, ku ndes kandinë s'e ve ndë vend të mpshefëtë, as ndënë hu të drithit» (374b20 Luka 11,33); shih edhe 148b17,35; 178a21; 206a16; 210b25; 220b28; 222b25, 39; 230b43; 232b27; 238b33; 242a33; 270a32; 274a32; 300a40; 310a16; 316b32; 328b34; 340a5; 344a35 etj. Kemi gjetur nja njëzet e pesë shembëlla të tilla, po me një shqyrtim më të vëmendshëm të tekstit, mund të dalë edhe ndonjë tjetër**

E. Çabej (duke gjykuar pas pikësimit që ka përdorur, khs. shembëllat më lart) duket se i mban këto e më fort për trajta të shkurtëra përemërore sesa për lidhëza. Në të vërtetë, në shembëllat e mësipërme, sipas natyrës së shqipes, janë po aq të domosdoshme si lidhëza

35) Këtë përdorim të e-së, që E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* — (dorëshkrim) e ka vënë re për ndonjë dialekt konservator si çamërishtja: *erdhnë e ata*, me sã kam mundur ta ndjek, e ka të rëndomtë toskërishtja verilindore (Korçë-Pogradec), khs. *se erth'e për neve dit e shentëruar* M. Grameno, *Mallkimi i gjuhës shqipe*, 1921, f. 40; *A më merr e mua* M. Kuteli, *Ago Jakupi*, 1943, f. 67. Në gëgerishten, siç duket, kjo vlerë e e-së nuk është ruajtur.

ashtu dhe trajta e shkurtër përemërore<sup>36</sup>. Po si shpjegohet atëhere që ka vetëm një *e* në vend të dyve? Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një përkthim, ne besojmë se në punë e sipër, Buzuku mekanikisht, sa herë ka parë një *et* në origjinalin latin, ka shkruar në fletën e tij një *e*, të cilën e ka ndjerë njëkohësisht edhe si një trajtë të shkurtër që shpreh kundrinën e drejtë. Për një përkthyes pa përvojë, i cili rrëfëhet duke thënë: «*nukë çuditem se në paça fëjyem, këjo tue klenë mā e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë*» nuk janë të papritura të tilla gabime. Nuk përjashtohet edhe lënja jashtë nga ana e Buzukut ose e radhitësit e një *e*-je, në raste kur do të mblidheshin tri të tilla p.sh. e *enuraneh* në vend të *e e enuraneh* etj. Por ajo që na bën të besojmë edhe më fort se mungesa e një *e*-je te shembëllat në fjalë ka thjesht karakter subjektiv, është fakti se gjashtë herë Buzuku nuk ja ka lejuar vetes gabimin e mësipërm dhe ka shkruar: *e e mer*; *e e bani*; *e e shanë*; *e e shpëtoi*, *e e pagëzoi*, *e e adoron* (106a4, 41; 214b36; 234a26; 246b19; 310a10). Këtu çon peshë edhe një shembëll e vetme ku shihet se Buzuku e ka ndjerë një *e* edhe si lidhëz edhe si nyjë: *kÿ anshtë i dërejtë, e pā-dërejtë, ndë të s ashtë* «*hic verax est, et iniustia in illo non est*» (172b45 Gjoni 7,18).

Në këtë mënyrë numrit 8071 që dhamë në krye për lidhëzën *e*, duhet t'i shtojmë edhe njëzet e pesë rastet në fjalë, ku një *e* e vetme bën, si të thuash, edhe punën e lidhëzës, edhe të përemrit të pakteksuar.

2) Fjala *edhe* është përdorur si lidhëz këpujore e mirëfilltë vetëm nja dhjetë herë, p.sh. *E mbë herët të njëmbëdhjetë orësh duol edhe gjjet të tjerë, e u thotë* «*Circa undecimam vero exiit, et invenit olios stantentes: et dicit illis*» (106a43, Mateu 20,6); *E tue i lanë, vote edhe u lut të tretënë herë* «*Et relictis illis iterum abiit et oravit tertio*» (204b44 Mateu 26,44); *por atë droni qi mundën shpirtinë edhe mishtë me shkatëruom ndë flakët të zjarmit* «*sed potius eum timete qui potest et animam et corpus perdere in gehennam*» (360a38 Mateu 10,28); khs. edhe 248b18; 282a1-2, 366b30; 376b25, 29; 378a29.

Pak herë Buzuku e ka përdorur lidhëzën *edhe* si shtesore, duke përkthyer me të lidhëzën *sed* të latinishtes, ose duke e shtuar ai vetë në disa raste kur në origjinalin latin nuk ka ndonjë lidhëz, p.sh. *U të shtie Shpirtinë tem përmbi gjithë mish, e të përfetixonjënë bijtë taj e bijatë tuoj, e pleqtë taj të shohënë andëra e të ritë taj të shohënë të pana. Edhe përmbi sherbëtorët e përmbi sherbëtorëtë nd ato dit u të shtie Shpirtinë tem.* «*Effundam spiritum meum super omnem carnem: et prophetabunt filii vestri et filiae vestrae: senes vestri somnia somniabunt, et iuvenes vestri visiones videbunt. Sed et super servos meos, et ancillas in diebus illis effundam spiritum meum*» (270b21 Joeli 2,28-29); *Më*

36) Siç ka vënë re J. Rrota (*Monumenti mā i vjetri i Gjuhës Shqype D.Gjon Buzuku*<sup>2</sup> f. 18), autori ynë «e përgjithsisht edhe tjerë shkrimtarë të hershëm nuk e përdorin pleonazmin, qi ka hi aq fort sod, me persritë obiektat (e diftuem nji herë nëpërmjet t'emnit) me grimcime peremnore». Ndërkaq shembëllat tona nuk i përkasin kësaj kategorie, sepse në to nuk është fjala për përsëritjen e kundrinës, por për shprehjen ose mosshprehjen e saj. Me këtë rast duam të shtojmë se pohimi i J. Rrotës ka një vlerë relative, pasi krahas shembëllave si «*e atë në mbarofshi*» ose «*tha Jezu dishipujet vet*» etj., që e vërtetojnë këtë pohim, ka edhe mjaft të tjera si «*mbet Jezu vjedmis dishipujet vet e u tha atyne*» ose «*E i tha Shpirti Filipit*» etj., që e kundërshtojnë.

*rā ndë mend n ditëshit plaka, e u kujtuoshë ndë gjithë vepërat të tū; edhe ndë punët të duoret tuve u kujtoneshë* «Memor fui dierum anti-quorum, meditatus sum in ómnibus operibus tuis: in factis manuum tuarum meditabar» (46b44 Psalmus 142,5); khs. edhe 76b43, 80b17, 276a23, 286b33-34, 340b9-10, 366b7, 378b17.

Në pjesën më të madhe të rasteve (rreth 138 herë) fjala **edhe** është përdorur si një pjesëz përforcuese me kuptimin e it. *anche, ancor, púre*, gjerm. *auch*, fr. *aussi*. P.sh. *E kle grishunë edhe Jezū e dishipujtë e tī mbë darsmë* «Vocatus est autem et Jesus et discipuli eius ad nuptias» — it. E fu invitato anche Gesù co' suoi discepoli alle nozze; në një tjetër përkthim: E fu invitato *púre* Gesù so' suoi discepoli alle nozze; — gjerm. Jesus aber und seine Jünger wurden *auch* auf die Hochzeit geladen; — fr. et Jèsus fut *aussi* invité aux noces avec ses disciples (100b3 Gjoni 2,2); *Ecëni edhe ju ndë vënështë teme* «Ite et vos in vineam» — it. Andate *anche* voi nella mia vigna; — gjerm. Gehet ihr *auch* hin in den Weinberg; — fr. Allez *aussi* à ma vigne (106b2 Mateu 20,7); *Në më shërben kush, ndjekëmë; e tuk të jem u, edhe sherbëtori em të jetë* «Si quis mihi ministrat, me sequatur: et ubi sum ego, illic et minister meus erit» — it. Chi mi serve, mi segua; e dove son io, ivi sarà *ancora* colui che mi serve; në një tjetër përkthim: Chi mi serve, mi segua; perche dove sarò io quivi sarà *anche* il mio servo; — gjerm. Wer mir dienen will, der folge mir nach; und wo ich bin, da soll mein Diener *auch* sein; — fr. Si quelqu'un me sert, qu'il me suive; et là où je suis, là *aussi* sera mon serviteur (200a12 Gjoni 12,26).

Në shembëllat e mësipërme Buzuku me **edhe** ka përkthyer et të latinishtes, kurse në disa raste të tjera edhe *etiam* ose *quoque*, p.sh. *Kush anshtë kÿ qi edhe katetë liron?* «Quis est hoc, qui etiam peccata dimittit? (196a26 Luka, 7,49); *E gjithë ata qi të mos u përzanë, ju tue dalë anso qytedje, shkondëni edhe pluhëninë n kambëshit suojshe për dëshmi kondra tyne* «Et quicumque non receperint vos, exeuntes de civitate illa, etiam pulverem pedum vestrorum excutite in testimonium supra illos» (268b41 Luka 9,5); *E një jetërë ditë tue ardhunë bijtë e Tinëzot ata me iu nfalë përpara faqesë Tinëzot, erdh edhe ndër ta Satanasi* «Factum est autem cum quadam die venissent filii Dei, et starent coram Domino, venisset quoque Satan inter eos, et staret in conspectu eius» (384b43 Jobi 2,1).

Është për të vënë re se Buzuku disa herë shton një **edhe** të tepërt që mungon në origjinalin latin, p.sh. *E kishnë edhe pak peshk* «Et habebant pisciculos paucos» (364a24 Marku 8,7); *ashtu të shkënxenjë edhe drita juoj përpara njerëzet* «sic luceat lux vestra coram hominibus» (372b32 Mateu 5,16); khs. edhe 46b44, 340b9-10, 366b7, 382b17, 386b11<sup>37</sup>.

Veç përdorimeve të mësipërme, fjala **edhe** në tekstin e Buzukut haset rreth 44 herë si ndajfolje me kuptimin e lat. *adhuc, iterum, nondum, necdum, ergo* etj. Duke pasur parasyshe gjithë këto, nuk është vështirë të përfundojmë se kjo fjalë në krye të herës ka qenë një ndajfolje që mori më pas kuptimin e lidhëzës këpujore e të pjesëzës.

37) Për përdorimin pleonastik të lidhëzave **e, edhe**, dhe shih: H. Pedersen, *Albanische Texte mit Glossar*, f. 123; M. Lambert, *Die hypothetische Periode im Albanischen*, Ind. Forsch. XXXIV, f. 188, shën 1.

Në gjithë librin e Buzukut, siç pamë, *edhe*-ja me funksionin e një lidhëze këpujore është përdorur vetëm nja dhjetë herë. Nga kjo del se përdorimi i gjerë i kësaj fjale si lidhëz bashkërenditëse këpujore është një zhvillim që ka ndodhur në kohën pas Buzukut.

Me kuptimin e pjesëzës përforcuese *edhe* (it. *anche*, fr. *aussi*, gjerm. *auch*) është përdorur një herë dhe fjala *ende*, e cila mirëfilli është një ndajfolje. *E tash u jam nfallë gjithëve, e lutëni Tenëzonë ende për muo* (386 rreshti 45 Pashënja). Në një rast tjetër kuptimi i kësaj fjale nuk del qartë: *E por përmbi gjithë këto Zotynë i gjithë hirvët, qi në na grishi, ende pak tue klenë munduom, ndë të madht lavd të ti për Krishtnë Jezu, përhapë t u jetë hjekunë, e t u konfirmojë për të mbetunë* «Deus autem omnis gratiae, qui vocavit nos in aeternam suam gloriam in Christo Jesu, modicum passos ipse perficiet, confirmabit, solidabit» (278b27 Pjetri I 5,10).

Fjala *ende* te Buzuku del vetëm te këto dy shembëlla dhe në asnjë prej tyre nuk ka kuptimin e një lidhëze këpujore. Sot në të folmet e Shqipërisë së Mesme kjo fjalë në variantet fonetike *ene*, *ne* përdoret gjerësisht si lidhëz këpujore në vënd të lidhëzës *edhe*, e cila, siç na kumton edhe M. I. Çeliku, studjues i këtyre të folmeve, mungon krejt në ato anë.

3) Lidhëza *as* në librin e Buzukut është përdorur rreth 208 herë, por në rreth 120 raste ajo ka kuptimin e një pjesëze përforcuese mohore. Kur përdoret si lidhëz në periudhë, *as* ka gjithashtu edhe kuptimin e një pjesëze që përforcon mohimin.

Lidhëza *as* shërben si për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ashtu edhe dy fjali, p.sh. *E zjarmi nukë preku Axarinë as shokëtë e ti* «et non tetigit eos omnino ignis» (94a13 Danieli 3,50); *E të dy ishnë fort të dërejtë përpara faqesë Tinëzot, ata tue ecunë ndë gjithë ordhënat e nde e dërejtat të Tinëzot pā të ndishkuom as të anëkuom* «Erant autem iusti ambo ante Deum incendentes in omnibus mandatis et iustificationibus Domini sine querella»; *përse aj të jetë i madh përpara faqesë Tinëzot e të mos pie venë as venë n mjalti* «erit enim magnus coram Domino, et vinum et sicera non bibet» (326b21, 42 Luka 1,6, 15).

*E tha Akaxi: Nukë të lypinj, as nukë të tentonj Tenëzonë* «Et dixit Achaz: Non petam, et non tentabo Dominum» (88b3 Isaia 7,12); *E aj të mos gjukonjë si të shohë me sÿ, as si të gjegjetë me veshë të ndishkonjë* «non secundum visionem oculorum iudicabit, neque secundum auditum aurium arguet» (90a26 Isaia 11,3); *ma z di se kaha vjen as ku vete* «sed non scis unde veniat, et quo vadat» (326a13 Gjoni 3,8).

Në një enumeracion lidhëza *as* mund të vihet edhe përpara fjalës së parë, p.sh. *E sod ndë këtë mot na nukë kemi as zot, as profetë, as krye, as olokausto, as offertë, as të nfallë; as kiem, as vend tuk na të nfallnjim të paratë tonë përpara faqesë sate* «Et non est tempore hoc princeps, et dux, et propheta, neque holocaustum, neque sacrificium, neque oblatio, neque incensum, neque locus primitiarum coram te» (194b1-3 Danieli 3,38).

Lidhëza *as* e përsëritur *as...as* haset rrallë te Buzuku: *As pr emënit tem bē rëshim mos bani, as mos turpëno emënitë e Tinëzot Zotit, thotë Zotynë. As mos hi për të keq fqinjësë sate, as mos ju rando për të keq* «Non perjurabis in nomine meo, nec pollues nomen Dei tui. Ego Dominus. Non facies calumniam proximo tuo, nec vi opprimes

eum» (192a28-34 Levitiku 19,13); **As n së trembunit së tyne mos trembī, as mos trazoni** «Timorem autem eorum ne timueritis, et non conturbemini» (282a31-32 Pjetri I 3,14).

Lidhëzën *as* te Buzuku e gjejmë të përdorur edhe si shtesore, zakonisht në periudhë po ndonjëherë edhe në fjali, p.sh. *E mos bani të ini grishunë atë mbë dhët, përse një anshtë Ati uij qi anshtë mbë qiellt. As mos grëshitī mjeshtra, përse një anshtë mjeshtri uij, Krishti* «Et patrem nolite vocare vobis super terram: unus enim est Pater vester qui in caelis est. Nec vocemini magistri: quia Magister vester unus est Christus» (138a43 Mateu 23,9, 10); *Mos trazonetë zemëra juoj, as mos trembetë* «Non turbetur cor vestrum, neque formidet» (264b14 Gjoni 14,27); *E Gjeci vote përpara tyne e vu tojagënë përmbī faqe të djalët, qi aty frymë s ish ndë të, as gjā të gjallë n si* «Giezi autem praecesserat ante eos, et posuerat balucum super faciem pueri, et non erat vox, neque sensus» (178b32 Mbretërit IV 4,31).

Siç thamë më lart, në numrin më të madh të rasteve, *as* është përdorur si pjesëz përforcuese mohore. Ajo është antonimi i pjesëzës edhe që trajtuam më sipër. P.sh. *E venë barë të madhe qi nukë mundë baretë, e i venë mbë krahë tjerëvet; e ata as me një gisht nukë duonë me i vëlizunë* «Alligant autem onera gravia et importabilia, et inponunt in humeros hominum: digito autem suo nolunt ea movere» (138a29 Mateu 23,4); *E i tha Jezu: As u nukë të gjukonj* «Dixit autem Jesus: Nec ego te condemnabo» (168a7 Gjoni 8, 11); *E aj nukë ju përgjegj as fjalë, aqë sã gjukatësi çuditë fort* «Et non respondit ei ad ullum verbum, ita ut miraretur praeses vehementer» (208a39 Mateu 27,14) etj.

4) Lidhëza *mos*. Një veçori e gjuhës së Buzukut është përdorimi i fjalës *mos* si lidhëz me kuptimin «as». Me këtë kuptim fjala *mos* është përdorur gjithësej 50 herë, nga të cilat 41 herë vetëm në f. 25, 26 e 27 në Decem precepta dei dhe De septem operibus misericordie. Lidhëza *mos* bashkon zakonisht dy gjymtyrë të një fjalie dhe vetëm në nja dy raste edhe dy fjali, p.sh. *as për ndonjë mëndyrë me mos rām ndë kat, mos me femënë mos me mashkullë* (62b2,2); *E mos vini ar mos vistar këha mbë këtë jetë* «Nolite thesaurizare vobis thesauros in tera» (114a3 Mateu 6,19); *E mos dëshëro shtëpinë e fqinjësë sate; e mos dëshëro gruoënë e fqinjësë sate, as sherbëtuorë, as sherbëtořenë, mos kanë e tī, as agërinë e tī* «Non concupisces domum proximi tui: nec desiderabis uxorem eius, non servum; non ancillam, non bovem, non asinum» (156b8 Eksodi 20, 17); *e ndë të s ashtë mos bukurī mos të zdritunë* «nos est species ei, neque decor» (214b29-30 Isaia 53,2); *Mos trazoni mos dhenë, mos detinë, mos lisavet, djerie mos shënojmë sherbëtorëtë e Tinëzot n ballë* «Nolite nocere terae neque mari, neque arboribus, quoad usque signemus servos Dei nostri in frontibus eorum» (346a17, 18, 18 Apokalipsi 7,3). *I treti kat moitar, kī anshtë tue prituom nieri ndë arësye të shpirtit, as ndonjë të mirë aj nukë bani mos mbë meshë, mos kryq, mos me ndigluom Ungjillë shenjtë, mos me u rëfyem, mos me u konguom mbë herë* (64b3-5) etj.

#### Lokucione këpujore

Veç lidhëzave të thjeshta këpujore, te Gjon Buzuku, ndonëse rralle, gjenden edhe disa lokucione. Një palë prej tyre janë formuar prej lidhëzave *si, porsī* e ndajfoljes *ashtu* ose prej lidhëzave të përmendura dhe lidhëzës këpujore *e*.

Lokucioni *si ... ashtu (edhe)* del katër herë: *Mer, Gjon, shenjtë e Kryqsë si në ballë ashtu mbë zemërë* (68b25-6); *Kloftë vollundetja jote, si mbë qiellt ashtu edhe mbë dhët* «Fiat voluntas tua sicut in caelo, et in terra» (76b19-20); *si shpirti i atët ... ashtu shpirti i birit* «ut Anima patri ita et anima filii» (128b9-10 Exekieli 18,4); *në gjithë mishënashit si të zogjet e të govedavet, ashtu në qishdo fare janë në shtansëshit që përmbi dhë janë* «ex omni carne, tam in volatilibus quam in bestiis et universis reptilibus, quae reptant super terram» (232a15-6).

Një variant i këtij lokucioni është *porsi ... ashtu (edhe)*, që del dy herë: *Vollundetja jote kloftë, porsi mbë qiellt, ashtu edhe mbë dhët* «Fiat voluntas tua sicut in caelo, et in terra» (52a30-1); *aj me ngjërnuom shpirtënatë tonë e korporatë tonë, porsi njanënë ashtu tjetërinë* «ut hoc solemne jejunium, quod animabus corporibusque curandis salubriter institutum est» (118a30 Oratio). Në një rast gjymtyrët e këtij lokucioni dalin me renditje të përkundërt: *E përurë prifti Ezdrë librinë e ligjsë përpara shumicësë, ashtu burrët porsi gruosë* «Attulit ergo Esdras sacerdos legem coram multitudine virorum et mulierum» (238b13 Esdra II 8,2).

Lokucionet e formuara nga lidhëzat *si* (në rastin përkatës *sī* me *ī* të gjatë), *porsi* me lidhëzën këpujore *e* dalin vetëm nga një herë: *e u bani me rām shī si i pari e i voni* «et descendere faciet ad vos imbre matutinum et serotinum sicut in principio» (270a6 Joeli 2,23); *na jemi mbë këtë shekullë një të panë porsi në engjëjsh e në njerëzsh* «quia spectaculum facti sumus mundo, et angelis et hominibus» (348b45-350a1 Korintasit I 4,9).

Lokucionet e mësipërme shërbejnë për të bashkërenditur jo fjali, po vetëm gjymtyrë fjalish.

Një tjetër lokucion këpujor që del 5 herë te Buzuku është *jo se ... por (edhe)* me vlerën e lokucionit të sotëm *jo vetëm ... por (edhe)*. Ai shërben për të bashkërenditur gjithashtu vetëm dy gjymtyrë fjalie, p.sh. *Anshët shkruom: Jo se ndë bukë të vetëme të gjellinjë i Biri i njerit, por ndë gjithë fjalë që vjen në gojet së Tinëzot* «Scriptum est Non in pane solo vivit homo, sed in omni verbo, quod procedit de ore Dei» (120b33-4 Mateu 4,4); *jo se kambëtë, por edhe duortë e kryetë* «non tantum pedes meos, sed et manus et caput» (218a28-9); *Sherbëtorëtë të jenë përvutë zotënivet, jo se atyne që janë të mirë e të përvutë, por edhe atyne që janë fort t egrë* «Servi, subditi in omni timore dominis, non tantum bonis et modestis, sed etiam discolis» (254a33-4 Pjetri I 2,18); *E jo se ajo vetë ka të trishtuom, por edhe për të vërtetë na që kemi të përzanëtë e Shpirtit shenjt* «Non solum autem illa sed et nos ipsi primitias Spiritus habentes» (280a45-bl Romanët 8,23); *e jo se muo të m apë, por gjithë atyne që të duonë t ardhunitë e tī* «non solum autem mihi, sed et his qui diligunt adventum eius» (370a32 Timoteu II 4,8).

Të njëjtën vlerë me lokucionin e trajtuar më sipër ka edhe *jo se ... ma ... edhe* që del vetëm një herë: *tue proveduom ndë kafshë qish për të mirë janë jo se përpara Tinëzot, ma në mundë banetë edhe përpara gjithë njerëzet* «providentes bona, non tantum coram Deo, sed etiam coram omnibus hominibus» (102a1-2 Romakët 12,17). Për gëgërishten e sotme nuk dimë që të përdoret gjëkund *jo se* me kuptimin «jo vetëm».

## 2. Lidhëzat bashkërenditëse veçuese

Gjon Buzuku ka përdorur këto lidhëza veçuese: *a*, *ndo*, *o*, *ose*, *opur*.

1) Lidhëza *a* është përdorur vetëm një herë: *Se mā mundën Zotynë se një njeri o një shtrigë a një qi ban mëngjī* (60a35). Duket se kjo lidhëz nuk ka qënë e dialektit të autorit tonë, por ai në shembëllën e mësipërme me këtë *a* i është shmangur përdorimit dy herë afër e afër të lidhëzës *o*.

2) Lidhëza *ndo* është përdorur nga Buzuku vetëm një herë si e përsëritur *ndo...ndo*: *e me këtë dëshir ja dëshëron ti me mujtunë me ja marë, ndo për kusëri ndo për forcë nukë kursenishnjë* (64a1, 1).

3) Lidhëza *o* është më e shpeshta nga gjithë lidhëzat veçuese që gjejmë te Gjon Buzuku. Ajo është përdorur 136 herë, zakonisht me kuptimin e lat. *aut, sive, vel*. Ajo mund të shprehë marrëdhënje veçimi si midis dy gjymtyrëve të një fjalie ashtu edhe midis dy fjalive të një periudhe, duke u vendosur midis tyre ose duke dalë përpara secilës. Në rastin e fundit veçimi bëhet më i theksuar. P.sh. *Lypë një shenj tit Zot Zotit tit n fundit së ferësë o n së naltët së qiellsë*. «Pete tibi signum a Domino Deo tuo in profundum inferni, sive in excelsum supra» (88b1 Isaia 7,11); *Vëllazënë, tue pasunë dhunëtī e të dana porsī kuj anshtë dhanë hiri, o profetī pr arësye të fesë, o kush mpsōn urtënë, o kush konforton ndë herë të konfortit, o kush shufren të mitunënë, o aj qi anshtë përmbi të tjerë për të ditunit, o kush ka mishërier ndë gazëmend* «Fratres: Habentes autem donationes secundum gratiam quae data est nobis, differentes: sive prophetiam secundum rationem fidei: sive ministerium in ministrando: sive qui docet in doctrina: qui exhortatur in exhortando: qui tribuit in simplicitate: qui praeest in sollicitudine: qui miseretur in hilaritate» (100a16-20 Romanët 12,6-8); *E ishnë aty gjashtë vedrë n guri vutë, porsī ish të purifikuomitë e Xhudhivet, qi mbaj e sijado dÿ o trī masë* «Erant autem ibi lapideae hydriae sex positae, secundum purificationem Judaeorum, capientes singulae metretas binas vel ternas» (100b11 Gjoni 2,6); *E gjithëqish vepëra ju bani o nde e thanë o nde e bām, gjithë kafshëtë bani pr emënë të Jezu Krishtit* «Omne quodcumque facitis in verbo aut in opere, omnia in nomine Domini Jesu» (104b10,11 Kolosianët 3, 17); *Karitati kurajtë nukë bdirëtë, e në u sosshinë profetitë, o gluhëtë të mëngonjënë, o të ditunitë të bdirëtë* «Caritas numquam excidit: sive prophetiae, evacuabuntur: sive linguae, cessabunt: sive scientia, destruetur» (110b26,26 Korintasit 13,8).

Disa herë Buzuku lidhëzën *o* e ka përdorur edhe në fjali pyetëse me kuptimin e lidhëzës *apo* të shqipes së sotme, e cila nuk del te ky autor, ose me kuptimin e lidhëzës *an* të latinishtes. P.sh. *A ti je aj qi kām me ardhunë, o tjetërë presmë?* Tu es qui venturus es, an alium expetamus? (86a19 Matheu 11,3); *E kush të na dae n së dashunit së Jezu Krishtit? t idhunitë? të votëtë n fill? të bduomitë? o uja? të xveshunë? o perikulli? o shpata?* «Quis nos separabit a caritate Christi? tribulatio an angustia, an persecutio, an fames, an nuditas, an periculum, an gladius?» (350b42-43 Romanët 8,35). Po me këtë kuptim Buzuku ka përdorur një herë lidhëzën *opur* nga it. *oppure*: *A ti e thuo vetë këta, opur të tjerë tÿ të mpsuonë n meje?* A temet ipso hoc dicis, an alii tibi dixerunt de me? (222a45 Gjoni 18,34).

4) Lidhëza ose është përdorur vetëm një herë në korrelacionin *o...ose*: *O na të jemi idhënuom për të konfortuomit taj e për të n̄falët, ose na të jemi bām me ditunë për të bamit ditunë taj e të n̄falët* «Sive autem tribulamur, pro vestra exhortatione et salute: sive exhortamur, pro vestra exhortatione, quae operatur in tolerantia eorumdem passionum quas et nos patimur» (358a17 Korintasit II 16). Buzuku i shkruan ndaras pjesët përbërëse të kësaj lidhëse, por E. Çabej në transkribimin e tij i ka bashkuar, duke dalluar me të drejtë në shembëllën e mësipërme një lidhëz të vetme, ndryshe nga dy raste të tjera ku *o* dhe *se*, ndonëse në jukstapozicion, e ruajnë pavarësinë e tyre kuptimore dhe paraqiten si dy lidhëza, e para veçuese, e dyta fthilluese: *Zot, kur na të pām se ti ishñjē unētē, e na të dham me n̄granē; o se ti kle eççim e na t̄y dham me pītē?* Domine, quando te vidimus esurientem, et pavimus: sitientem, et dedimus tibi potum? (122b34 Mateu 25,37); *E në do kush me bām vollundetnē e t̄i, të njohē n̄ sē ditunīt a mundē jetē n̄ Sinēzot, o se u në flas n̄ vetēhej* «Si quis voluerit voluntatem eius facere, cognoscet de doctrina, utrum ex deo sit, an ego a me ipso loquar (172b41 Gjoni 7,17). Nga këto tri shembëlla, siç ka vënë në dukje E. Çabej, mund të vihet re mënyra dhe koha e formimit të kësaj lidhëse. «Aty shihet se në kohë të këtij autori ose të pakën në ndjenjën gjuhësore të tijne, përngjitja e dy lidhëzave *o se* në një lidhëz të re nuk u kish kryer. Përngjitja u bë më parë në ato rasa ku *se*-ja kryesonte një fjali, duke u lidhur ajo drejtpërdrejt me predikatin e kësaj, sh. shembëllin e parë të Buzukut. Pastaj lidhëza e shtriu përdorimin e saj edhe përpara pjesëve të ndryshme të ligjëratës, para një emri, një përemri etj.»<sup>38</sup>.

### 3. Lidhëzat bashkërenditëse kundërshtore.

Gjon Buzuku përdor këto lidhëza kundërshtore: *ma (mā)*, *po*, *por*, *pur*, *māse*, *veçëse*.

1) Lidhëza *ma (mā)* është përdorur 103 herë në «Mesharin» e Buzukut me kuptimin e lidhëzave *autem* e *sed* të latinishtes. Ajo shërben për të vënë përkundër dy gjymtyrë të një fjalie ose dy fjali të një periudhe. P.sh. *E ata të venē mbē mundime për jetē të jetēsē, ma të dērejtētē ndē gjellēt të jetēsē* «Et ibunt hi in supplicium aeternum: iusti autem in vitam aeternam» (124a17 Mateu 25,46); *Përse Zotynē nukē u grishi ndē punē të pāglana, ma ndē shenjtēnī*, Non enim vocavit nos Deus in inmundita, sed in sanctificatione» (134b37 Tesalonicasit, I 4,7); *Përse na shohmē tash për pasēqyrē e për figurē; ma kur të vinjē ajo herē na të dukemi faqe n̄ faqe. Tash njoh për pjesē: ma atēherē të njoh porsi u jam njohunē* «Videmus nunc per speculum in aenigmate: tunc autem facie ad faciem. Nunc cognosco ex parte: tunc autem cognoscam sicut et cognitus sum» (110b36, 38 Korintasit I 13,12); *E u tha atyne: Ju për të vërtetē të pini kelqinē tem, ma me ndenjūnē mbē të djathēt teme e mbē të shtëmanktēt nukē përket muo me e dhanē, ma kuj të jetē dhanē n̄ Atit sim* «Ait illis: Calicem quidem meum bibetis: sedere autem ad dextram meam vel sinistram non est meum

38) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XVI*, «Studime filologjike», nr. 1. 1965, f. 4.

dare vobis, sed quibus paratum est a Patre meo» (140a26, 29 Mateu 20,23); *Zani anshtë zani i Jakobit, ma duortë janë të Ezaut* «Vox quidem vox Jacob est: sed manus, manus sunt Esau» (146b19 Gjenezë 27,22); *Shpirti tuk do del, e i gjegjë zanë e tî, ma z di se kaha vjen as ku vete* «Spiritus ubi vult spirat: et vocem eius audis, sed nescis unde veniat, aut quo vadat» (326a12 Gjoni 3,8).

Siç shihet nga shembëllat e sjella më sipër e siç na del edhe nga analiza e shembëllave të tjera, lidhëza *ma* përdoret zakonisht në fjali që shprehin një përqasje, një kundërvënje, duke treguar dallimin a ndryshimin midis dy fjalive homogjene.

Ndonjëherë Buzuku ka ndërtuar një fjali kundërshtore me lidhëzën *ma*, së cilës nuk i përgjigjet një *autem* ose një *sed* në origjinalin latin, p.sh. *Ndë Damaskut aj qi ish vum përmbi gjint të regjit Aretë, ruon qytetnë me më zanë; ma për një fënestrë u kleshë kaluom për murt ndë një shportë* «Damasci praepositus Gentis Aretae regis, custodiebat civitatem Damascenorum ut me comprehendet: et per fenestram in sporta dimissus sum per murum (108b2 Korintasit II 11, 32-33); *E lypnjinë si të munda zinjinë, ma druonjinë shumicënë* «Et quaerentes eum tenere timuerunt turbas» (144b40 Mateu 21,46) etj.

Te Buzuku lidhëza *ma* është përdorur shumë herë edhe si shtesore, ashtu si përdoret edhe lidhëza *autem* e latinishtes, p.sh. *E mos vini ar mos vistar këha mbë këtë jetë, qi tenja e bre e të ndryshkëtitë, e qi kusarëtë e nxjerënë e vjedhënë. Ma vinie arë e vistarë mbë qiellt, tek as tinja as të ndryshkëtitë nukë e bre* «Nolite thesaurizare vobis thesauros in terra: ubi aerugo, et tinea demolitur: et ubi fures effodiunt, et furantur. Thesaurizate autem vobis thesauros in caelo: ubi neque aerugo, neque tinea demolitur» (114a5 Mateu 6,19-20); *Për të vërtetë u juve thom, ata e përzunë pagëtyrënë e tyne. Ma ti kur të bajnsh lëmoshënë tande, ban të mos die e shtëmankta jote qish ban e djatha jote* «Amen dico vobis, receperunt mercedem suam. Te autem faciente eleemosynam, nesciat sinistra tua quid faciat dextra tua» (118a7 Mateu 6, 2-3); *E mos shuoni shpirtënatë, as mos shani profetitë. Ma gjithë kafshëtë tuoj zaminonî, e ata qish për të mirë ka me u dalë, ata bani të mbani* «Spiritus nolite extinguere: prophetias nolite spernere. Omnia autem probate: quod bonum est tenete» (134a33 Tesalonikasit I 5, 19-21).

Lidhëza *mā* me *a* të gjatë haset vetëm një herë: *Për ditë feste dÿ kate janë njeri me u përkatënuom: ... Mā këta e thom, se ditë feste anshtë dupio kati* (62a2).

2) Lidhëza *po*. Kjo lidhëz është përdorur vetëm katër herë: *porsi njani burrë o jetëra gruo, qi kurajtë të ginë nukë di, po e ka mallëkuom Zotynë* (66a18); *Po qish votë me pātë?* «Sed quid existis?» (86a31, 35 Mateu 11,8, 9); *E ata e pyesnjinë: Po kush je ti, Elia?* «Et interrogaverunt eum: Quid ergo? Helias es tu?» (86b34 Gjoni 1,21). Siç shihet nga këto shembëlla, lidhëza *po* është përdorur zakonisht në krye të një fjalie pyetëse. Është për t'u vënë re se kjo lidhëz është përdorur të katra herët brenda dhjetë faqeve: një herë në f. 28 e tri herë në f. 38. Më tej Buzuku nuk e ka përdorur më këtë lidhëz.

3) Lidhëza *por*. Kjo lidhëz është më e shpeshta nga gjithë lidhëzat kundërshtore të Buzukut. Ajo është përdorur gjithësej 177 herë. Rastet e përdorimit të kësaj lidhëze në fjali janë të paka: *E Zotynë e ngjalli të tretënë dite e bani aj me klenë ditunë, jo gjithë popullit por parë neve, qi na për këto kafshë klem zgjedhunë për të vërtetë n Sinëzot*

«Hunc Deus suscitavit tertia die, et dedit eum manifestum fieri non omni populo, sed testibus praeordinatis a Deo» (240b11 Punët 10, 40-41) etj.

Lidhëza *por* përdoret pra kryesisht për të lidhur dy fjali, nga të cilat e dyta ndonjëherë mund të paraqitet edhe si e paplotë, duke i munguar kallëzuesi ose folja këpujë, p.sh. *u gjā nukë banj n vetëvetëhenë, por si më mpsoi Ati* «a me ipso facio nihil, sed sicut docuit me Pater» (136b13 Gjoni 8,28); *E kështu, vëllazënë, nukë jemi bijtë e sherbëtoresë, por të së pasherbëtoresë* «Itaque, fratres, non sumus ancillae filii, sed liberae» (168b14 Galatasit 4,31); *Të ditunitë s ashtë temtë, por të Atit qi më dërgoi* «Mea doctrina non est mea, sed eius qui misit me» (172b38 Gjoni 7, 16) etj.

Lidhëza *por*, ndryshe nga lidhëza *ma*, shërben më tepër për të lidhur dy fjali që shprehin jo një përqasje, po një kundërshtim, i cili mund të paraqitet me disa nuanca të ndryshme. Në tekstin latin lidhëzës *por* të Buzukut në shumicën dërmuese të rasteve i përgjigjet lidhëza *sed* e fare rrallë: *autem*, p.sh. *E porsie bie shiy e bdora n qiellshit e mā përhapëtë nukë kthen, por e pi dheu, e atë ban me frujtuom* «Et quomodo descendit imber, et nix de caelo, et illuc ultra non revertitur, sed inebriat terram, et infundit eam, et germinare eam facit» (124b8 Isaia 55,10); *E ajo jetëra tho: As muo as tÿ të mos epetë, por le ta danë* «Econtrario illa dicebat: «Nec mihi nec tibi sit, sed dividatur» (170b20 Mbretërit III 3, 26); *Mos më prekë, përse edhe u nukë jam votë tek Ati em. Por ecë tek të mī vëllazënë* «Noli me tangere, nondum enim ascendi ad patrem meum: vade autem ad fratres meos» (248a2 Gjoni 20,17); *E të vinjë mot qi mā ndë këto shembëlltyrë të mos u flas, por nçelë t u ap me ditunë n Atit* «Venit hora cum iam non in proverbiiis loquar vobis, sed palam de Patre adnuntiabo vobis» (258a3 Gjoni 16,25).

Ndonjëherë lidhëza *por* është përdorur edhe në vend të lat. *ergo, igitur, verumtamen*. P.sh. *E u tha atyne: Por ndë se ini pagëzuom?* «Ille vero ait: In quo ergo baptizati estis?» (262a45 Punët 19,3); *Ashtu u maravejuo Izaku fort, e tha: Por kush kle aj qi kle për gjā, e muo më përū e u angra n gjithësej parë se ti vinjë?* Expavit Isaac stupore vehementi: et ultra quam credi potest, admirans, ait: Quis igitur ille est qui dudum captam venationem attulit mihi, et comedi ex omnibus priusquam tu venires? (148a4 Gjenezit 27,33); *Hinje se u ta truonj përndenë të mujtunit tat, por ruoju n gjellet së tī* «Ecce in manu tua est, verumtamen animam illius serva» (386a18 Jobi 2,6).

Vetëm në një rast lidhëza *por* shërben për të ndërtuar një bashkërenditje kundërshtore të dy fjalive shkakore, e para prej të cilave përmban një mohim: *E këta e tha. jo se atī i dhimbë për të vobegjit, por përse ish kusār* «Dixit autem hoc non quia de egenis pertinebat ad eum, sed quia fur erat (212b13 Gjoni 12,6).

Në ndonjë pjesë ungjilli që del dy herë në librin e Buzukut mund të vemë re se ai një herë ka përdorur lidhëzënë *ma* e një herë tjetër lidhëzënë *por*, p.sh. *Ju për të vërtetë të pini kelqinë tem, ma me ndenjunë mbë të djathët teme e mbë të shtëmanktët, nukë përket muo me e dhanë, ma kuj të jetë dhanë n Atit sim - E u tha atyne: Kelqinë qi u kam me pīm ju ta pini, ma me ndenjunë mbë të djathët e mbë të shtëmanktët, ata nukë përket muo me ya dhanë juve, por atyne qi t u jetë dhanë n Atit sim* «Ait illis: Calicem quidem meum bibetis: sedere autem ad dexteram meam et sinistram non est meum dare vobis, sed quibus paratum

est a Patre meo» (140a29; 336b1 Mateu 20,23). Lidhëza por te Buzuku në mjaft raste përdoret si shtesore, p.sh. *U për gjithë enëshit jam ngjeruom me të idhunë; se u juve në gjegjsha, anshtë mordja eme, e në mos u gjegjsha, u nukë mund u shpëtonj   duorshit suoijsht. Por ma mirë m ashtë muo  dër duor tuoj me mos r m e  d  faj p rpara faqes  Tin zot me mos h m* «Angustiae sunt mihi undique: si enim hoc egero, mors mihi est: si autem non egero non effugiam manus vestras. Sed melius est mihi absque opere incidere in manus vestras, quam peccare in conspectu Domini» (164b6 Danieli 13,22-23); *Nd at  mot tha Zotyn  dishipujet vet: U vete tek aj qi m  d rgoi, e askush mos m  pyes  tek vete. Por p rse u juve fola k to kafsh  n  t idhun  mbushi zem r n  taj* «At nunc vado ad eum qui me misit; et nemo ex vobis interrogat me, Quo vadis? Sed quia haec locutus sum vobis, tristitia implevit cor vestrum» (256a16 Gjoni 15,5-6) etj.

4) Lidh za pur del vet m n  kat r raste, dy prej t  cilave u p rkasin atyre pjes ve nga Rituali q  Buzuku i ka hartuar vet , pra nuk i ka p rkthyer nga Rituali roman: *E si ansht  k jo dhun , pur del... kall zuom* (62a43); *E aj qi k  t  vedn , e pur bie  d  kat me tjet r ; ashtu edhe gruoja n  f jef t , f jen  de e shtat t kat mort r* (66a28). Kuptimi i periudh s s  par  nuk del qart , sepse fleta XXI n  at  vend  sht  e d mtuar dhe fjal t midis del e kall zuom si edhe t  tjera m  posht  mungojn . Megjithat  ajo duket se ka kuptimin «prap se-prap ». Te periudha e dyt  pur, e prir  nga lidh za e, ka kuptim kund rshtor-lejor, af rsisht si lat. *tamen*, dhe mund t  merret edhe si n  lokucion e pur.

N  dy shemb llat e tjera pur prihet nga lidh za tjet r kund rshtore ma: *u nuk  jam i denj  ti me h m  d  sht pi teme, ma pur thuo n  fjal  t  vet me, e t  jet  sh ndoshun  sherb tori em* «non sum dignus ut intres sub tectum meum: sed tantum dic verbo et sanabitur puer meus» (102a36 Mateu 8,8); *U bana si ti m  ordh nove, ma pur edhe ansht  vend.* «Domine, factum est ut imperasti et adhuc locus est» (278a40 Luka 14,22). K tu kemi t  b jm  me n  rast kontaminacioni (siç e quan Haversi), t  cilit nga fusha e shqipes mund t'i shtojm  edhe lidh z n sepse (se+pse), e cila gjen analogjin  e vet t  quia enim e latinishtes e te *deshalb weil, deswegen weil e denn weil* t  gjermanishtes<sup>39</sup>.

5) Fjala *m se*, p rgjith sisht me a t  gjat , del si lidh z n nt mb dhjete her , me kuptimin «p rveç se, veçse», duke pasur si korresponduese n  tekstin latin lidh z n nisi ose ndajfoljen *praeter*. Ajo p rdoret n  n  fjal  mohore dhe ka dal  nga bashkimi i ndajfoljes *m * me lidh z n krahasore se, duke marr  kuptimet e m sip rme ose duke u shnd rruar n  pjes z me kuptimin «vet m, veç»<sup>40</sup>: *m se n  fjal  thuo e t  jet  sh ndoshun  sherb tori em* «sed tantum dic verbo et sanabitur puer meus» (114b21-22 Mateu 8,8); khs. edhe 124b42, 136b20, 140b4.

Lidh za *m se*  sht  lidh z kund rshtore me nuanc  kufizimi. Fjal a q  vjen pas saj ka si funksion q  ta kufizoj  n  n  far  m nyre mohimin q  p rmban ajo pjes  e fjalis  q  ndodhet para lidh z s: *E t  mos i epet  shenj m se t  Jon s  profet * «et signum non dabitur

39) Wilhelm Havers, *Handbuch der erkl renden Syntax*, Heidelberg, 1931, f. 83 v.

40) E. Çabej, *Studime rreth etimologjis  s  gjuh s shqipe* (dor shkrim).

ei nisi signum Jonae prophetae» (86b28 Mateu 12,39); *u nukë jam klenë dërguom mase për dhent* «Non sum missus nisi ad oves» (128b45 Mateu 15,24); *e s ish kush mbrenda mase të dy pleqtë njshehunë* «et non erat ibi quisquam, praeter duos senes obsconditos» (164a33 Danieli 13,16); khs. edhe 132b43, 134a7, 136b43, 150a15, 168a4 etj. Kjo lidhëz vetëm dy herë del e përdorur në periudhë: *tue prekunë dejtë e tū, shtatnë tand, jo për tjetërë mase me dhanë appetit korpit tit e të pëlqyem* (68a7 Rituali); *η teje nukë duomë mase ti të grëshitesh buri ynë* «tantummodo invocetur nomen tuum super nos» (238a37 Isaia 4,1).

6) Lidhëza *veçëse* është përdorur një herë të vetme nga fletët e fundit të librit: *Mā gjā nukë vijen, veçëse me u qitunë jashtë e me u shkalë η nierëzishit* «ad nihilum valet ultra nisi ut mittatur foras et conculcetur ab hominibus» (372b24 Mateu 5,13). Kjo lidhëz, së cilës në tekstin latin i përgjigjet *nisi*, ka të njëjtin kuptim me *mase* që u trajtua më sipër, dhe si ajo përdoret në një fjali mohore. Por, ndërsa lidhëza *mase* me kalimin e kohës doli nga përdorimi, lidhëza *veçëse* erdhi duke u përdorur gjithnjë e më dendur dhe ja zuri vendin së parës plotësisht. Arësyeja e këtij zëvendësimi duhet kërkuar te kuptimi i elementeve të para ndajfoljore që përmbajnë këto lidhëza të përngjitura. Ndajfolja *veç* shpreh pikërisht idenë e kufizimit, të rezervës, ndryshe nga ndajfolja e sasisë *ma* (tosk. *më*), e cila në ndërtim si *ma se i mirë* ose *ma se pesë vetë* shpreh kuptimin e shkallës sipërore ose krahasore të sipërisë. Duke qenë pra kuptimi i *veçëse* më i qartë sesa i *mase*, vetvetiu kjo e dyta erdhi duke dalë nga përdorimi.

Te Gjon Buzuku nuk ka lidhëza përmbyllëse<sup>41</sup>. Dy fjalë: *përkaqë* e *prashtu*, kanë te ky autor kuptimin «prandaj»<sup>42</sup>, por asnjera prej tyre nuk mund të konsiderohet si lidhëz, sepse, kurdoherë që janë përdorur drejt<sup>43</sup>, ato i gjejmë të prira nga lidhëza e (gjithmonë në rolin e një lidhëze shtesore), gjë që tregon se funksionin lidhës e përmbush e-ja, kurse *përkaqë* e *prashtu* janë vetëm ndajfolje shkaku. Në tekstin latin atyre u përgjigjen ndajfoljet *ergo*, *ideo(que)*, *igitur*, *ita-que*, *propterea* ose përemrat *hoc* e *quod* me parafjalën *propter: propter hoc, propter quod*. Po sjellim disa shembëlla: **E përkaqë ju të përzini njani tjetërinë për ndër** «Propter quod suscipite invicem» (84b37 Romakët 15,7); **E përkaqë ligja anshtë kondra t prometuomit Tinëzot?**

41) Në traditën e gramatologjisë shqiptare, te lidhëzat bashkërenditëse, krahas këpujoreve, kundërshtoreve, e veçueseve, dallohen edhe lidhëzat përmbyllëse, natyrën dhe funksionin e veçantë të të cilave këtu nuk do ta prekim.

42) Kuptimin «prandaj» të *përkaqë* e kanë shënuar kohët e fundit E. Çabej në *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XV*, «Studime filologjike», XVIII (I), nr. 4, 1964 f. 83 v. e K. Ashta, *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555)*, Buletini shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, 1965, f. 77. I dyti edhe e përcakton këtë fjalë si ndajfolje, por nga ana tjetër *prashtu* e mban si lidhëz (po aty, f. 84).

43) Në pak raste Buzuku ka përdorur gabimisht një *e përkaqë* a *e prashtu* për lat. *autem, nam, et, si, quoniam, sed. ut*, duke e ndryshuar kuptimin dhe raportet sintaktike të tekstit latin (shih 276b16; 294b13, 35; 382b9-10; 290b19; 258b20; 278a31; 320b2; 190b26; 246b3; 102a8; 286a2); dy herë ka shtuar pa nevojë një *përkaqë* pas lidhëzës kundërshtore *ma* (14b24; 162a26) dhe pesë herë ka shtuar vetë një *e prashtu*, së cilës në tekstin latin nuk i përgjigjet ndonjë nga ndajfoljet me kuptimin «prandaj» (shih 116a37; 226a16; 236a42; 254a16; 256a1). Gjithësej *përkaqë* del 19 herë, kurse *prashtu* 87 herë.

«Lex ergo adversus promissa Dei? (292b2 Galatët 3, 21); **E prashtu u juve thom se juve t u jetë marë regjënija e Tinëzot** «Ideo dico vobis, quia auferetur a vobis regnum Dei» (144b30 Mateu 21,43); **E prashtu dalmë jashë qytetnë** «Exeamus igitur ad eum extra castra» (37a29 Hebreasit 13,13) etj.

### Lidhëzat nënrenditëse

Te Gjon Buzuku dalin këto lloje lidhëzash nënrenditëse: ftilluese, vendore, kohore, kushtore, shkakore, rrjedhimore, qëllimore, lejore e krahasore. Le të shqyrtojmë me radhë secilin prej këtyre grupeve.

#### 1. Lidhëzat ftilluese

Kjo kategori përfaqësohet prej lidhëzave *se, qi, përse*<sup>44</sup>, *se në*.

1) Lidhëza ftilluese *se* është përdorur 473 herë. Në tekstin latin kësaj lidhëze i përgjigjen zakonisht lidhëzat *quia, quod, quoniam, ut*, të cilat në latinishten postklasike, me ngushtimin e përdorimit të konstruktit *accusativus cum infinitivo*, filluan të përdoren edhe si lidhëza ftilluese, p.sh. *përse të dini se u jam Zotynë qi thëres emënit tit* «ut scias quia ego Dominus, qui voco nomen tuum» (92b24 Isaia 45,3) shih dhe 98b37, 112b40, 120b40 etj.; *Juve thom se shumë kanë me ardhunë prej së dalët së diellët e prej së ndenjunit* «Dico autem vobis quod multi ab oriente et occidente venient» (102a45 Mateu, 8. 11); shih dhe 106a2, 108a45, 112a18, 114b29 etj.; *përse të dinë në së dalët së diellët djerie mbe e ndenjunit se tjetërë s ashtë jashtë muo* «Ut sciant hi, qui ab ortu solis, et qui ab occidente, quoniam absque me non est» (92b33 Isaia 45,6); shih edhe 106a17 etj.; *E muo asgjā nukë anshtë se u të jem gjukuom në jush o në gjyqit së kësaj jete* «Mihi autem pro minimo est ut a vobis iudicer, aut ab humano die» (94b14 Korintasit I 4, 3); *anshtë mirë për jū se u të vete* «expedit vobis ut ego vadam» (256a19 Gjoni 16,7) etj.

Lidhëzën *se* Buzuku e ka shtënë në punë edhe për përkthimin e konstruktit *accusativus cum infinitivo* dhe të konstruktit të formuar nga një emër plus një pjesore të tashme veprare, p.sh. *Mā ata kujtonjinë se anshtë ndër shoqënīt* «Existimantes autem illum esse in comitatu» (98a23 Luka 2,44); *tue përutë të sëmunë ndë shtretënat në gjithë viseshit qi gjegjunë kishnë se Krishti ish ardhunë* «coeperunt in grabattis eos qui se male habebant circumferre, ubi audiebant eum esse» (120a5 Marku 6,55) etj.; *Ndë atë mot pā Gjoni Jezunë se vin tek aj, e tha* «Altera die videt Johannes Jesum venientem ad se, et ait» (98b20 Gjoni 1,28); *E tue gjegjunë shumicënë se shkonjinë, pyeti qish anshtë ata* «Et cum audiret turbam praetereuntem, interrogabat quid hoc esset» (112a16 Luka 18,36) etj.

Në shumë raste të tjera Buzuku e ka përdorur lidhëzën *se* për

44) Kuptimet dhe përdorimet e lidhëzave *se* e *përse*, i kam trajtuar veçan dhe më gjerë në një kumtesë për Konferencën II të studimeve albanologjike (janar 1968), mbasi e kisha përfunduar punimin e pranishëm. Shih: *Mbi disa lidhëza nënrenditëse te Gjon Buzuku*, në «Konferenca II e studimeve albanologjike» III, Tiranë 1970, ff. 159-165.

përkthimin e konstrukteve latine asindetike, të cilat disa herë edhe i parafrazon, p.sh. *Ngre përçark sytë e tu, o Jeruzalem, e shih se gjithë u mbëlodhnë e erdhnë në ty* «Leva in circuitu oculos tuos, et vide: omnes isti congregati sunt, venerunt tibi» (96a12 Isaia 60,4); *përse të dukenë se banjënë pëndesë me të ngjënuom* «ut pareant hominibus ieiunantes» (112b38 Mateu 6,16); shih edhe 98a4, 100a44, 122b41, 124b30, 130b5 etj.

Fjalitë që ndërtohen me këtë lidhëz, siç shihet edhe nga shembëllat, janë zakonisht kundrinore e rrallë kryefjalore. Në pak raste me lidhëzën se ndërtohen edhe fjali kallëzuesore, p.sh. *E ti kur të ngjënojnsh, lyej kryetë tat e laj faqenë tande, përse mos dukesh njerëzet se ngjënon* «Tu autem cum ieiunas unge caput tuum, et faciem tuam: ne videaris hominibus jejunans (112b44 Mateu 6,17-8); *Na kemi ngjënuom, e ti u dëftove se nukë pae; na munduom shpirtënatë tonë, e ti u dëftove se nukë di gjā* «Quare jejunavimus, et non aspexisti: humiliavimus animas nostras et nescisti? (116a28-30 Isaia 58,3); *Erdh tek dishipujtë e tī, e i gjet se flinjinë* «Et venit ad discipulos, et invenit eos dormientes» 204b32 Mateu 26,40); shih edhe 204b42; 294b33; 382a4.

Lidhëzën se e gjejmë disa herë edhe me fjali të varura përcaktore, p.sh. *Gruoja kur piell, kā të dhimtunë, përse i vjen hera; e mbassi kā lēm djalëtë, mā nukë i bie ndë mend anso dojesh për gazëment se leu një njeri mbë shekullit* «Mulier cum parit tristiciam habet, quia venit hora eius: cum autem pepererit puerum, iam non meminit pressurae propter gaudium: quia natus est homo in mundum» (254b17 Gjoni 16,21); *edhe të vinjë mot se kush t u nvrasë, atī t i duketë se kā bām sakrificio Tinëzot e të madh të pëlqyem* «Sed venit hora, ut omnis qui interficit vos, arbitretur obsequium se praestare Deo» (276a24 Gjoni 16,2);<sup>45</sup> *për të vërtetë u juve thom se kā me ardhunë hera, e anshtë, se të vdekunitë të gjegjenë zanë e Birit Tinëzot* «Amen, amen dico vobis, quia venit hora et nunc est, quando mortui audient vocem Filii Dei» (382a14 Gjoni 5,25). Në këto dy shembëllat e fundit se-ja bën punën e një ndajfoljeje lidhore kohore (*hera... kur*, lat. *hora... quando*), gjë që na tregon një fazë të vjetër të zhvillimit të kësaj lidhëze, kur ajo e ruante kuptimin e përemrit pyetës-lidhore prej të cilit buron. Në shqipen e sotme nga lidhëzat ftilluese vetëm që-ja mund të përdoret në vend të një ndajfoljeje lidhore kohore, khs. *ditënë që (=kur) hyri prilli... etj.*<sup>46</sup>

Lidhëza se në një rast është përdorur me kuptimin e lidhëzës së sotme nëse: *Kush e di se Zotynë të mos pëndonetë, e të kthenetë në furiet së mënīsë tī, e të mos bdiremi?* «Quis scit si convertatur, et ignoscat Deus: et revertatur a furore irae suae, et non peribimus?» (188a43 Jona 3,9).

45) Siç mund të vihet re edhe nga disa shëmbulla të sjella më lart, Buzuku përdor lidhëzën se edhe në raste kur gegërishtja e sotme përdor *qi* (256a19, 276a24) ose një ndërtim me përcjelloren (204b32).

46) Është për t'u përmendur me këtë rast që përemri lidhor se (i cili që te Buzuku përdoret si i tillë vetëm i shoqëruar me parafjalë të rasës kallëzore e rrjedhore), përveç rasteve më të shumta kur është i zbërthyeshem në për. dëft. *ai + për*. lidh. që, na del dy herë edhe thjesht në vend të «i cili»: *Lutemi atī qi neve bani e atī qi neve na ep gjellë me se gjellijmë, neve e gjithë shekullit* (82a35): *E aj atë ças nfaqe tyne u ngriti, muor shtratë e tī ndë se dërgjë, e vo më shtëpi të tī*. «Et confestim surgens coram illis, tulit in quo iacebat: et abiit in domum suam» (270b7 Luka 5,25). Te shëmbëlla e parë me se është baras me «me të cilën», te shëmbëlla e dytë ndë se është baras me «në të cilin».

Lidhëzën se në katër raste e gjejmë të përdorur në mënyrë pleonastike me fjali pyetëse të zhdrejta para ndajfoljes lidhore *kaha*: *E mbassi starisfati e kërkoi, ujëtë ish bām venë, e nukë dij se kaha vjen* «Ut autem gustavit architriclinus aquam vinum factam et non sciebat unde esset» (100b16 Gjoni 2,9). Edhe në tri shembëllat e tjera (shih 174a26, 28; 326a12) fjalia kryesore ka si kallëzues foljen *di*.

2) Lidhëza *qi* si ftilluese te Buzuku është shumë e rrallë. Në dy raste atë e gjejmë të përdorur me një fjali kundrinore që varet nga folja *bëj*<sup>47</sup>: *ndë gjithë oratë e të lutunë bani qi me vepërat të hirit të jenë ditunë të lipunatë tuoj ndaj Tenëzonë* «in omni oratione et obsecratione, cum gratiarum actione, petitiones vestrae innotescant apud Deum» (86b20 Filipasit 4,6); *E zhdo n sish thanë: A s të mujtëke kÿ, qi sytë e d verbënit lenë nçilën, me bām kÿ qi mos vdis?*<sup>48</sup> «Quidam autem dixerunt ex ipsis: Non poterat hic, qui aperuit oculos caeci, facere ut et hic non moreretur?» (182b32 Gjoni 11,37).

Me fjali kryefjalore lidhëzën *qi* Buzuku nuk e ka përdorur ndonjëherë<sup>49</sup>.

Përsa i takon përdorimit të lidhëzës *qi* me fjali përcaktore, ka vetëm një rast që është i qartë: *Kā vjen këta qi e ama e Tinëzot erdh tek u?* «Et unde hoc mihi ut veniat mater Domini mei ad me? — khs. it. E donde a me questo, che la Madre del Signor mio venga da me? — gjerm. Und woher kommt mir das, dass die Mutter meines Herrn zu mir kommt?» (90b3 Luka 1,43). Ka te Buzuku edhe nja tri raste të tjera ku fjala *qi* mund të mbahet si lidhëz ftilluese e një fjalie përcaktore, sado që ndjehet edhe si një përemër a si një ndajfolje lidhore: *E tue pām Jezu atë se dergjë, e tue njohunë se shumë mot kish qi prit, i tha* «Hunc cum vidisset Jesus iacentem, et cognovisset quia multum iam tempus habet, dicit ei (130b38 Gjoni 5,6); *kā me ardhunë hera qi as mbë këtë mal, as n Jeruzalem ju të adroni Atënë* «venit hora, quando neque in monte hoc, neque in Hierosolymis, adorabitis Patrem»; *Ma kā me ardhunë një herë, e tash anshtë, qi të vërtetë adoratorë të adronjënë Atënë* «Sed venit hora et nunc est, quando veri adoratores adorabunt Patrem» (162a8, 13 Gjoni 4,21, 23)<sup>50</sup>.

3) Lidhëza *përse* është përdorur si ftilluese tri herë: *Ashtu e ju kur të shihni këto kafshë me u bām, ju të dini përse afërë anshtë regjënja e Tinëzot* «Ita et vos cum videritis haec fieri, scitote quoniam prope est regnum Dei» (84b4 Luka 21,31); *U të lus, Zot, kujto u përse u përpara faqesë sate u eca nde e dërejte e me zemërë fort të mirë, e u bana qish për të mirë kle përpara faqesë sate* «Obsecro, Domine, memento quaeso quomodo ambulaverim coram te in veritate, et in corde perfecto, et quod bonum est in oculis tuis fecerim» (118a41 Isaia 38,3); *E u juve thom përse asndonjë ansish qi klenë grishunë, të mos kërkonjënë n darket sime* «Dico autem vobis quod nemo viro- rum illorum qui vocati sunt, gustabit caneam meam» (278a43-4 Luka 14,24).

47) Edhe në shqipen e sotme fjalia kundrinore që varet prej kësaj foljeje mund të ndërtohet vetëm me lidhëzën që (*qi*) e jo me *se*.

48) Buzuku ka ngatërruar vendin e *kÿ*-së së dytë; duhej: *me bām qi kÿ mos vdis*.

49) Është e tillë në burim lidhëza *qi* e lokucionit në *kloftë qi*, i cili ashtu si edhe lokucioni tjetër sinonim në *kloftë se* del vetëm një herë (shih më poshtë te lidhëzat kushtore).

50) Khs. *mot se, hera se* në f.. 123.

Siç shihet, te shembëlla e parë lidhëzës përse të Buzukut i përgjigjet një *quoniam* në tekstin latin, në shembëllën e dytë ajo del si një shtesë e Buzukut, i cili në këtë rast ia ka ndryshuar strukturën dhe deri diku kuptimin frazës latine, në rastin e tretë teksti latin ka *quod*.

4) Lokucioni **se n(ë)**, të cilit sot i përgjigjet lokucioni *në se* me renditje të përkundërt, del si ftillues vetëm një herë: *U nukë di se n ashtë i përkatënuom* «Si peccator est, nescio» (176b41-2 Gjoni 9,25).

*Shënim.* Me funksionin e një lidhëze ftilluese një herë të vetme del te Gjon Buzuku edhe një *si*: *E kërkoi tregëtinë e saj si anshtë e mirë* «Gustavit et vidit quia bona est negotiatio ejus» (334a39 Libri i Proverbavet 31,18)<sup>51</sup>. Për këtë rast, ku Buzuku nuk ka dhënë një përkthim të saktë, ndoshta radhitësi do ta ketë marrë për i një e të dorëshkrimit të Buzukut.

## 2. Lidhëzat vendore.

Fjalët që dalin si lidhëza vendore te Gjon Buzuku janë *ku*, *tek* dhe *tuk*. Asnjë prej tyre nuk është lidhëz e mirëfilltë: *ku* është ndajfolje dhe përdorimi ndajfoljor i kësaj fjale mbizotëron mbi përdorimin lidhëzor, *tek* e *tuk* janë me burim ndajfoljor dhe përdoren më dendur si fjalë lidhëse sesa si lidhëza. Në tri raste është përdorur si lidhëz vendore ndajfolja *kudo* dhe në dy raste del si fjalë lidhëse ndajfolja pyetëse *kaha*. Kjo është e gjithë pasqyra e mjeteve lidhëzore me të cilat ndërtohen fjalitë vendore te Gjon Buzuku. Siç shihet, këto mjete janë mjaft të paka në krahasim me ato që zotëron gjuha sot. Lokucionet lidhëzore të vendit te Buzuku mungojnë krejt.

1) Lidhëza *ku* del vetëm katër herë. Në të katra rastet në tekstin latin asaj i përgjigjet ndajfolja *ubi*: *Xe ku anshtë urta, ku anshtë vertydja, ku anshtë të ditunitë* «Disce ubi sit prudentia, ubi sit virtus, ubi sit intellectus» (236a7, 7, 8 Baruku 3,14); *ku ish fuqia e shpirtit, e uringinë* «ubi erat impetus spiritus illuc gradiebantur» (354b11 Exekieli, 1, 12). Nga shembëllat e mësipërme shihet se fjalia vendore e ndërtuar me këtë lidhëz tregon vendin ku kryhet ose vendin për ku drejtohet veprimi i fjalisë kryesore.

*Shënim.* Veç këtyre katër rasteve të përdorimit si lidhëz, fjala *ku* del 34 herë si ndajfolje. Po të heqim nga ky numër dy raste kur ajo është përdorur gabimisht për pasthirmën *euge* (52b4), mbeten 19 raste të përdorimit në fjali pyetëse dhe 13 raste të përdorimit në fjali kundrinore si: *pyeti ata ku Krishti të lindë* «sciscitabatur ab eis ubi Christus nasceretur» (96a39 Mateu 2,4); *Zot, u Babilonienë s e dī ku anshtë, as liqenë z dī ku jet* «Domine, Babylonem non vidi, et lacum nescio» (190a28, 29 Danieli 14,34) etj. Në këto fjali kundrinore që përmbajnë një pyetje të zhdrejtë ndajfolja *ku* bën punën e një mjeti lidhës dhe prandaj nuk na u duk pa vend të jepnim shembëllat e mësipërme.

2) Lidhëza *tek* del vetëm tetë herë. Fjalitë e varura të ndërtuara me këtë lidhëz tregojnë vendin ku kryhet ose vendin për ku drejtohet veprimi i fjalisë kryesore, por, ndryshe nga fjalitë e ndërtuara me lidhëzën *ku*, ky vend paraqitet më i përcaktuar, sepse *tek* do të

51) Të kihet parasysh për këtë shembëll se *kërkoi* është përdorur me kuptimin «gustavit».

thotë jo thjesht *ku*, po diçka si «atje ku»<sup>52</sup>, p.sh. *E këto kafshë u banë ndë Betaniet përte Jordanit, tek Gjoni pagëzon* «Haec in Bethania facta sunt trans Jordanen ubi erat Johannes baptizans» (88a7 Gjoni 1,28); *Përse tek anshtë ari e vistari uit, aty anshtë edhe zemëra jote* «Ubi enim est thesaurus tuus, ibi est et cor tuum» (114a9 Mateu 6,21); *tek u vete, ju nukë mundë vini* «Quo ego vado, vos non potestis venire» (136a38 Gjoni 8,21); shih edhe 78a29; 136a40; 188b20; 324a44; 330a18, 21. Në të gjitha këto raste në tekstin latin lidhëzës tek i përgjigjet ndajfolja *quo* ose *ubi*.

*Shënim.* Pesë herë *tek* është përdorur si fjalë lidhëse për të ndër-tuar fjali përcaktore: *Ma vinië ari e vistarë mbë qiellt, tek as tinja as të ndryshkëtitë nukë e bre* «Thesaurizate autem vobis thesauros in caelo: ubi neque erugo neque tinea demolitur» (114a6 Mateu 6, 20); shih edhe 180b16; 232a39; 242a24; 340b11.

Në pesë raste të tjera ndajfoljen *tek* e gjejmë edhe si mjet lidhës të një fjali kundrinore, p.sh. *përse u di kaha erdhshë e tek u vete; e ju nukë dini kaha u vinj e tek u vete* «quia scio unde veni et quo vado: vos autem nescitis unde venio, aut quo vado» (184b31,32 Gjoni 8,14). Në fjalitë e mësipërme gjenden edhe ato dy raste të përdorimit të ndajfoljes pyetëse *kaha* si fjalë lidhëse, që u përmendën në hyrje të trajtimit të kësaj kategorie lidhëzash. Shembëlla të tjera me *tek* në fjali kundrinore gjenden në 98a39-40; 256a16 dhe 314b39. Në të parën prej tyre fjalia e ndërtuar me *tek* zë vendin e një fjali lidhore të tekstit latin: *E ata nuk e muorë fjalënë tek aj e tha* «Et ipsi non intellexerunt verbum quod locutus est ad eos» (98a39-40 Luka 2,50). Këtu fjalia *tek aj e tha* është një kundrinë e dytë e foljes *muorë* (= kuptuan, muarën vesh) dhe jo një fjali që përcakton kundrinën *fjalënë*.

3) Lidhëza vendore *tuk* e cila lidhet me *tu* (primitivi i *këtu*)<sup>53</sup> ka të njëjtin kuptim me *tek*. Kjo lidhëz vendore del te Buzuku dymbëdhjetë herë. Në tekstin latin asaj i përgjigjet zakonisht ndajfolja *ubi*: *Përse tuk janë dy o tre mbëljedhunë pr emënit tem, aty jam edhe u ndë vjedmis tyne* «Ubi enim sunt duo, vel tres congregati in nomine meo, ibi sum in medio eorum» (156a15 Mateu 18,20); *u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë m̄ i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mirë* (Pasthënia 386 rreshti 38), shih edhe 186a1; 188b13; 200a12; 222a5 etj.

*Shënim 1.* Njëzet e pesë herë *tuk* është përdorur si fjalë lidhëse: njëzet e katër herë me fjali përcaktore dhe një herë me fjali kundrinore: *U kthenj më shtëpi teme tuk dola* «Revertar in domum meam, unde exiui» (126b45 Mateu 12,44); *m Jeruzalem anshtë vendi tuk duhetë me u lutunë* «in Hierosolymis est locus ubi adorare oportet» (162a6 Gjoni 4, 20); *E nukë gjet pëllumbi kon tuk të pushon majetë e thuovet saj* «Quae cum non invenisset ubi requiseret pes ejus» (230b39 Gjeneza 8,9), shih dhe 182a8, b14, 21, 42; 194b3 etj.

*Shënim 2.* Në tri raste është përdorur si lidhëz vendore ndajfolja *kudo*, p.sh. *përse kudo të të dërgonj, ti të veshte* «quoniam ad omnia, quae mittam te, ibis» (326a44 Jeremia 1,7); shih edhe 204a4; 302a20-21.

52) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXI*, «Studime filologjike» XX(III) 1966, nr. 2, f. 61.

53) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* (dorëshkrim).

### 3. Lidhëzat kohore

Kategoria e lidhëzave kohore ashtu si në shqipen e sotme edhe te Gjon Buzuku është më e pasur se çdo kategori tjetër lidhëzash. Në të bëjnë pjesë lidhëza të thjeshta: *djerie, kur, sã, se, si, tek, tuk, qysh*; lidhëza të përngjitura: *mbassi, përsã*; lidhëza lokucione: *djerie kur, qish kur, djerie sã, djerie mos, djerie mbë herë qi, mbë herë qi, gjithë herë qi, për gjithë herë qi, përherë qi, parë se, sã ku*.

#### *Lidhëzat e thjeshta*

1) Lidhëza *djerie* del te Buzuku gjithësej 14 herë zakonisht me kuptimin e lat. *donec* e ndonjëherë *usque dum, quoad usque*. Në një periudhë me fjali kohore të ndërtuar me lidhëzën *djerie* tregohet se veprimi i fjalisë drejtuese zgjat deri në çastin që fillon veprimi i fjalisë së varur, p.sh. *Këtu itëni djerie u të kthenj tek ju* «Expectate hic donec revertamur ad vos» (126a28 Eksodi 24,14); *Zot, lee edhe këta vjetë, djerie ta rmonj për qark e t i shtie pak të majm* «Domine, dimitte illam et hoc anno, usque dum fodiam circa illam, et mittam stercora» (304b15 Luka 13,9); *e tue votë por uij tue predikuom Ungjillë për gjithë qytet, djerie erdh ndë Cezaret* «et pertransiens evangelizabat civitatibus cunctis, donec veniret Caesaream» (246b24-5 Punët 8,40); shih edhe 24a21; 42a26; 58a36; 204b21; 246b24-5 etj.

Folja kallëzues e fjalisë kohore të ndërtuar me lidhëzën *djerie* është zakonisht në mënyrën lidhore, fort rrallë edhe në dëftore. Nga të 14 fjalitë kohore të ndërtuara me këtë lidhëz dhjetë e kanë kallëzuesin në mënyrën lidhore dhe vetëm katër në mënyrën dëftore.

Fjalja kohore e ndërtuar me lidhëzën *djerie* e ka vendin gjithmonë pas fjalisë drejtuese.

2) Lidhëza *kur* është përdorur 131 herë dhe ka kështu dendurinë më të lartë nga gjithë lidhëzat e tjera kohore. Ajo është përdorur kryesisht në vend të lidhëzës latine *cum* e ndonjëherë edhe në vend të *quando*.

Lidhëza *kur* tregon kohë në mënyrë të përgjithshme, pa e konkretizuar raportin kohor midis fjalisë kohore dhe fjalisë drejtuese të saj<sup>54</sup>. Konkretizimi i këtij raporti del jo nga kuptimi i lidhëzës, po nga marrëdhënja që ekziston midis foljeve-kallëzues të këtyre fjalive. Ky raport mund të jetë dy farësh: raport njëkohësie e raport sukseSIONI kohor. Njëkohësia mund të jetë: a) e plotë, b) e pjesshme. Njëkohësi të plotë ka në ato raste kur tregohet se dy veprime përputhen në pikëpamje të kohës gjatë gjithë zhvillimit të tyre, p.sh. *kur tî ban lëmoshënënë, mos bjerë trombetësë përpara veti* «Cum ergo facies elemosynam, noli tuba canere ante te» (118a1 Mateu 6,2); *Përse aj të jetë porsî lisi qi anshtë mbjellë ndaj ujë, qi larg shtie ranzëtë e tî për qark ujit, e nukë dro kur vjen vapa* «Et erit quasi lignum quod transplantatur super aquas, quod ad humorem mittit radices suas: et non timebit cum venerit aestus» (140b38 Jeremia 17,8); *Shumë të veja*

54) Siç dihet, në sfondin e marrëdhënjeve kohore mund të lindin edhe kuptime të tjera që shpeshherë i dobësojnë shumë këtë marrëdhënie kohore.

*ishnë ndë mot të Illiut ndë Israelt, kur kle mbërshelë qiellja për tri vjetë e gjashtë muoj* «multae viduae erant in diebus Heliae in Israel, quando clausum est caelum annis tribus et mensibus sex» (154a16 Luka 4,25) etj. Në këto raste foljet-kallëzues të fjalisë drejtuese e kohore janë në të njëjtën kohë, d.m.th. të dyja në të tashmen ose të dyja në të shkuarën (në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme të saj, p.sh. si më lart e pakryer dhe e kryer e tejshkuar).

Njëkohësi të pjesshme ka në ato raste kur tregohet se dy veprime (me shtrirje kohore të pabarabartë) përputhen pjesërisht gjatë kohës së zhvillimit të tyre, p.sh. *Zot, u nukë kam nieri qi kur vëlizetë bëraka, të më lëshonjë mbrenda* «Domine, hominem non habeo, ut cum turbata fuerit aqua, mittat me in piscinam» (130b40 Gjoni 5,7); *Për qish punë dishipujtë e tū nukë ruonjënë ordhëninë e pleqet, qi nukë lanjënë duortë kur venë me ngranë bukë?* «Quare discipuli tui transgrediuntur traditionem seniorum? non enim lavant manus suas cum panem manducant» (156b38 Mateu 15,2) etj. Edhe në këto shembëlla të njëkohësisë së pjesshme foljet-kallëzues të fjalisë kohore e drejtuese janë të dyja në të njëjtën kohë.

Suksesion kohor ka në ato raste kur është fjala për dy veprime që pasojnë njëri-tjetrin. Në këtë mes veprimi i shprehur në fjalinë kohore ngjet para veprimit të fjalisë drejtuese. P.sh. **Kur** të shofsh atë qi asht xveshunë, mbëloe «cum videris nudum, operi eum» (116b8 Isaia 58,7); **Kur** të jetë ardhunë i Biri i njerit ndë lavdit të madh të tī, e gjithë engjëjtë shenjtë me të, atëherë të rie përmbi shkamt të lavdit madh tī «Cum autem venerit Filius hominis in maiestate sua, et omnes angeli cum eo, tunc sedebit super sedem maiestatis suae» (122b12 Mateu 25,31); **Kur** të vinjë i zoti i vëneshtësë, qish të banjë atyne punëtorëve? «Cum ergo venerit dominus vineae, quid faciet agricolis illis? (144b19 Mateu 21,40); e **kur** ky ujt bīr, qi përpiu gjithë pasënë e tī tue gjellë me grāt të këqia, erdh, ti i nthere atë mëzatnë e majm «sed postquam filius tuus, hic, qui devoravit substantiam suam cum meretricibus, venit, occidisti illi vitulum saginatum» (148b40 Luka 15,30); *E shumica qi ish klenë me të kur grishi Laxarinë n vorit e ngjalli n mordjet ata dëshmonjinë n si* «Testimonium ergo perhibebat turba quae erat cum eo quando Lazarum vocavit de monumento et suscitavit cum mortuis» (198h32 Gjoni 12,17); *përse kur ju shihni se glembi i tī merr me u njomunë, ze me qitunë gjethtë, ju dini atëherë se prendëvera anshtë afërë* «cum iam ramus eius tener fuerit, et folia nata, scitis quia prope est aestas» (314a44 Mateu 24,30); *Nd atë mot Toma, një n së dymbëdhjetësh, qi grëshitë Didimo, s ish me ta kur erdh Jezu* «Thomas autem unus ex duodecim, qui dicitur Didymus, non erat cum eis quando venit Iesus» (318a37 Gjoni 20,24); **Kur** tī ish një mā i rī, ti ngjishishnë e uinjë tek donje «Cum esses iunior, cingebas te, et ambulabas ubi volebas» (330a16 Gjoni 21,18); *E edhe s ishnë nkriuom të nthellat e ujit kur u kleshë zanë* «Nondum erant abyssi, et ego iam concepta eram (340b9 Libri i Proverbeve 8,24) etj.

Nga këto shembëlla shihet se foljet kallëzues në fjalinë kohore e drejtuese mund të jenë të dyja në të njëjtën kohë, p.sh. në të tashmen (shih 116b8; 314a44), në të pakryerën (shih 330a16), në të kryerën e thjeshtë (shih 148b40), në të kryerën e plotë (shih 340b9), ose në kohë të ndryshme, p.sh. në të tashmen e lidhoret te kohorja e në të ardhshmen e tashme te drejtuesja (shih 144b19), në të ardhshmen e përparshme te kohorja e në të ardhshmen e tashme te drejtuesja (shih 122b12),

në të kryerën e thjeshtë te kohorja e në të pakryerën ose të kryerën e plotë te drejtuesja (shih 318a37; 198b32).

Fjalja kohore me lidhëzën *kur* rri përgjithësisht para fjalisë drejtuese, por mund të rrijë edhe pas saj.

*Shënim:* Në tri raste *kur* është përdorur si fjalë lidhëse e një fjalisë përcaktore: *djerie mb atë ditë kur t apë Zotynë shinë* «usque ad diem in qua Dominus daturus est pluviā» (138a11, Mbretërit III 17,14); shih edhe 116a31; 320b25.

3) Lidhëza *sā*, me *a* të gjatë, është përdorur gjithësej 19 herë, zakonisht me kuptimin e lat. *dum*, p.sh. *thërritëni sā anshtë afërë* «invocate eum, dum prope est» (124a40 Isaia 55,6); shih edhe 130b41; 200a36, 38; 296a7 etj; një herë me kuptimin e lat. *donec*: *E Xhudhitë nuk kishnë besë se aj ish klenë verbënë e aj kish përzanë të panëtë, sā grishnë t atnë e t amënë e tī* «Non crediderunt ergo Iudaei de illo, quia caecus fuisset et vidisset donec vocaverunt parentes eius qui viderat» (176b22 Gjoni 9,18); tri herë në kuptimin e lat. *cum*: *E aj sā tha këto kafshë, ngriti zanë një gruo n shumicet, tha Jezut* «Factum est autem cum haec diceret, extollens vocem quaedam mulier de turba dixit illi» (152a2 Luka 11,27); shih edhe 284b1, 322a17. Në disa raste të tjera Buzuku e ka përdorur këtë lidhëz për të përkthyer (ndonjëherë duke parafrazuar) me një fjali kohore disa ndërtime e shprehje të tekstit latin, te të cilat nuk ka ndonjë fjali kohore me lidhëzat e sipërpërmendura, p.sh. *përse besonjënë, sā gjegjenë* «qui at tempus credunt» (110a20 Luka 8,13); *E si mbaroi me e bekuom, sā memzi ish dām Jakobi n faqejet së Izakut përintit vet, erdh Ezaū* «Vix Isaac sermonem impleverat: et egresso Jacob foras, venit Esau» (146b40 Gjenezja 27,30); *E atë ças sā erdh tek Jezu, tha* «Et confestim accedens ad Jesum, dixit» (206a15 Mateu 26,49) etj.

Siç mund të shihet edhe nga shembëllat e dhëna më lart, fjalitë kohore me lidhëzën *sā* kanë këto kuptime:

a) Në rast se midis fjalisë drejtuese e fjalisë së varur ka raport njëkohësie, kjo e fundit tregon caqet kohore brenda të cilave zhvillohet veprimi i fjalisë drejtuese (shih më lart 124a40). Foljet-kallëzues të fjalisë drejtuese e kohore në këtë rast duhet të jenë në të njëjtën kohë.

b) Fjalja kohore tregon momentin fill pas të cilit ndodh veprimi i fjalisë drejtuese, p.sh. *por sā u vete, një tjetërë përpara muo hīn* «dum venio enim ego, alius ante me descendit» (130b41 Gjoni 5,7) etj. Edhe për këtë rast foljet-kallëzues të fjalisë kohore e drejtuese duhet të jenë në të njëjtën kohë.

c) Fjalja kohore tregon cakun deri kur zgjat veprimi i fjalisë drejtuese (shih 176b22).

Në tri raste që Buzuku lidhëzën *sā* e ka përdorur për lat. *cum* ai i ka ndryshuar raportet kohore në frazën latine nga «në kohën kur, në kohën që» në «sapo, sa kohë që», pra në këto raste lidhëza *sā* nuk është përdorur drejt.

Fjalja kohore me lidhëzën *sā* rri përgjithësisht para fjalisë drejtuese, por mund të rrijë edhe pas saj.

Një herë Buzuku ka përdorur një *sā* në vend të lidhëzës ffilluese se: *E u ba sā vdiq i vobegu, e kle shpūm n engjëjshīt ndë gjī të Abramit*. «Factum est autem ut moreretur mendicus, et portaretur ab angelis in sinum Abrahae» (142a15 Luka 16,22).

4) Lidhëza *se* si kohore është përdorur pesë herë. Të pesa herët

fjalë e ndërtuar me të varet prej një fjalisë kryesore që ka si kallëzues foljen *jam* dhe i referohet një emri me kuptim kohe: *Anshtë e treta ditë se këto kafshë janë bātë* «tertia dies hodie, quod haec facta sunt» (242a6 Luka 24,21); *E pyeti t atnë: Sā mot anshtë se atë e kish gjetunë ata të keq?* Et interrogavit patrem eius: Quantum temporis est ex quo hoc ei accidit? (300a21 Marku 9,21); *Bija eme pak herë anshtë se vdiq* «Filia mea modo defuncta est» (312a34 Mateu 9,18); shih edhe 74a42, 246a5. Në të gjitha shembëllat e mësipërme lidhëza se ka kuptimin «që se», «që kur». Fjalitë e varura me lidhëzën se janë postpozitive.

Fjalë kohore e ndërtuar me lidhëzën se rri pas fjalisë drejtuese.

5) Lidhëzën *si* te Gjon Buzuku e gjejmë gjithsej 124 herë. Ajo është përdorur zakonisht në vend të lidhëzave latine *cum*, *cumque*, *ut*, *postquam* e *quando* p.sh. *Gjithë njeri ve përpara venënë e mirë, e si dehenë, atëherë u ep mā të udobë* «Omnis homo primum bonum vinum ponit: et cum inebriati fuerint, tunc id quod deterius est» (100b20 Gjoni 2,10); shih edhe 102a28; 104b21; 106b3; 110a17,20; 112a14,24; 130b42; 144b3; 162b15; etj. etj.; *E si duolë n barket, ashtu atë trat e njohne* «Cumque egrresi essent de navi, continuo cognoverunt eum» (120a1 Marku 6,54) shih dhe 152b5; 154b30; 178b7; 340a29; *E gjithë populli si këta panë, dhanë lavd Tinëzot* «Et omnis plebs ut vidit, dedit laudem Deo» (112a29 Luka 18, 43); shih edhe 138a3; 170a2; 182a6,35; 182b11, 24; 190b38; 194b35; 220b11; 224b32 etj. etj.; *E si u pat lām kambëtë gjithëve, muor petëkatë e tī* «Postquam ergo lavit pedes eorum, et accepit vestimenta sua» (218a35 Gjoni 13,12) shih dhe 228a34, 232a45; 238b29; *Ma si u bashë njeri, u qita mbanë ato kafshë të djelmënisë* «quando factus sum vir evacuavi quae erant parvuli» (110b34 Korintasit I 13,10). Në këtë shembëllën e fundit Buzuku për *quando* të latinishtes duhej të kishte përdorur lidhëzën *kur*.

Me fjali kohore të ndërtuara me lidhëzën *si* Buzuku ka përkthyer edhe ablativin absolut, pjesoren e tanishme veprare e pjesoren e kryer pësore me vlerë kohore të latinishtes, p.sh. *A di ti se farizejtë, si këtë fjalë gjegjë, u skandalixuonë ndër vetëhenë?* «Scis quia Pharisaei audito verbo scandalizati sunt?» (158a19 Mateu 15,12); shih edhe 166a43; 204a22; 210b9; 218a9 etj.; *E si Jezu gjegj këta, u maravejuo* «Audiens autem Jesus miratus est» (102a42 Mateu 8,10) shih dhe 98a26; 144b14; 148b13; 164b37; 274a20 etj.; *E Jezu si e pā, i tha* «Intuitus autem cum Jesus dixit» (316a2 Gjoni 1,42) etj.

Siç shihet nga shembëllat e sjella më lart, në periudhat me fjali kohore të ndërtuara me lidhëzën *si*, veprimi i fjalisë drejtuese paraqitet si i zhvilluar pas veprimit të fjalisë kohore.

Fjalë kohore me lidhëzën *si* rri gjithmonë përpara fjalisë drejtuese.

6) Lidhëza kohore *tek* në «Mesharin» e Gjon Buzukut është përdorur gjithsej pesë herë dhe që të pesë herët për të përkthyer pjesoren e tashme veprare me vlerë kohore të latinishtes: *E tue pasunë qyrë Jezunë tek vin, tha: Hinje Qengji i Tinëzot. E atë gjegjë tek flit, e ndoqnë Jezunë. E tue u rutulluom Jezu ata pa tek e ndiqnë, tha* «Et respiciens Jesum ambulatantem, dixit: Ecce agnus Dei. Et audierunt eum duo discipuli loquentem, et secuti sunt Jesum. Conversus autem Jesus et videns eos sequentes se dixit» (314b33, 34, 36 Gjoni 1,36-38); shih edhe 98a29; 106a36.

Fjalia kohore e ndërtuar me lidhëzën *tek* tregon një veprim të njëkohshëm me të fjalisë drejtuese.

7) Të njëjtin kuptim me *tek* ka edhe lidhëza *tuk* e përdorur vetëm dy herë: *I pari kat ky anshtë: buri o gruoja, tuk sheh se anshtë buri i bukurë, ajo trajtonetë e vete me u dëftuom* (66a34); *pā dy vëllazënë ... tuk shtinjinë rjetë ndë dēt* «vidit duos fratres... mittentes rete in mare» (316b27 Mateu 4,18).

8) Lidhëza *qysh* është përdorur prej Buzukut gjithësej pesë herë katër herë për lat. *cum* e një herë për *dum*: *U të santifikonj emënitë tem të madhtë, përse të dīnë gjindja se u jam Zotynë e u qysh klofsha njohunë n jush, e të jem shenjtënuom ndër jū* «Et sanctificabo nomen meum magnum, quod pollutum est inter Gentes, quod polluistis in medio earum: ut sciant Gentes quia ego Dominus ait Dominus exercituum, cum sanctificatus fuero in vobis coram eis» (74b17 Ezekieli 36,23); *E tash ya thom parë se të jetë bām, përse, qysh kloftë bām, ju të besoni* «Et nunc dixi vobis prius quam fiat: ut cum factum fuerit, credatis» (264b20 Gjoni 14,29); *E u juve thom: Banī miq të begativet të së diekeqesë, përse ju qysh mēngofshi, t ini përzanë nde e mbetunat të jetësë glatë* «Et ego vobis dico; facite vobis amicos de mamona iniquitatis: ut, cum defeceritis, recipiant vos in aeterna tabernacula» (286b3 Luka 16,9); *E qysh na jemi gjukuom n Sinëzot na jemi ndi-shkuom, përse mos jemi dënuom me shekullit* «Dum indicamur autem, a Domino corripimur, ut non cum noc mundo donnemur» (216b43 Korintasit I 11,32); shih edhe 286a32.

Është për të vënë re se në të katër shembëllat ku *qysh* është përdorur për lat. *cum*, folja-kallëzues e fjalisë kohore vihet në mënyrën dëshirore.

Lidhëza *qysh* nuk ka ndonjë kuptim kohor të specifikuar. Ajo është si një sinonim i lidhëzës *kur* dhe vlera kohore e fjalive të ndërtuara me anë të saj përcaktohet nga marrëdhënja midis kohës së kallëzuesit të atyre fjalive me kohën e kallëzuesit të fjalisë drejtuese.

### Lidhëzat e përngjitura

Te Gjon Buzuku gjenden këto dy lidhëza kohore të përngjitura: *mbassi* e *përsā*.

1) Lidhëza *mbassi* që ka kuptim sinonimik me lidhëzën *si* është përdorur 27 herë. Dymbëdhjetë herë në tekstin latin asaj i përgjigjet lidhëza *postquam*, gjymtyra e dytë e së cilës nuk është po ajo e lidhëzës shqipe: (khs. *mbassi* < *mbas* + *si* e *postquam* < *post* «*mbas*» + *quam* + «*se*») dhe disa herë lidhëzat *cum* e *ut*, p.sh. *E mbassi ta mundonjënë, kanë me e nvrām* «et postquam flagellaverint, occident eum» (112a8 Luka 18,33); *E mbassi pleqtë folnë, u mbaruonë sherbëtorëtë fort* «Postquam autem senes locuti sunt, erubuerunt servi vehementer» (164b14 Danieli 13,27); shih edhe 170a31-2; 200b34-5; 204b9; 208b41 etj.; *E mbasi gjithë populli dahe mbas mjesëdite, hīn Suzana* «Cum autem populus revertisset per meridiem, ingrediebatur Susanna» (164a18 Danieli 13,7); shih edhe 254b15; 280a1; *E mbassi stratisfati e kërkoj, ujëtë ish bām venë* «Ut autem gustavit architriclinus aquam vinum factam» (100b15 Gjoni 2,9).

Nga mungesa e emrave foljorë abstraktë në shqipen e shekullit XVI, Buzukut disa herë i ka ardhur më mbarë që një emër foljor

të latinishtes me parafjalën *post*, ta japë shqip me një fjali kohore me lidhëzën *mbassi*, sesa të përdorë parafjalën *mbas* me një mbiemër prejppjesor të substantivuar, p.sh. *E tue dalë jashtë n voreshit mbassi Krishti y ngjall, erdhne ndë qytet shenjte* «et exeuntes de monumentis post resurrectionem eius, venerunt in sanctam civitatem» (210b5-6 Mateu 27,53); po kështu edhe 240a44; 342a20.

Në përgjithësi Buzuku e ka përdorur drejt lidhëzën *mbassi*, me përjashtim të atyre rasteve kur e ka për lat. *cum*, në të cilat marrëdhënjet e njëkohësisë të tekstit latin autori ynë i ka shndërruar në marrëdhënie paskohësie.

Duhet vënë re se Buzuku ka ndjerë një dallim midis *si* e *mbassi*. Kështu në 124 raste të përdorimit të lidhëzës *si* vetëm 4 i përgjigjen lat. *postquam*, kurse në 27 raste të përdorimit të *mbassi* 12 i përgjigjen lat. *postquam*. Përshtypja jonë është se me lidhëzën *si* veprimi i fjalisë drejtuese e kohore paraqiten si më të lidhur, sikur vijojnë menjëherë njëri pas tjetrit, kurse me lidhëzën *mbassi* këto veprime duket sikur kanë një kufi të dallueshëm mirë ndërmjet tyre. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shqipen e sotme.

Në periudhën me fjali kohore të ndërtuar me lidhëzën *mbassi* veprimi i fjalisë drejtuese vjen pas veprimit të fjalisë së varur kohore. Fjalια kohore me lidhëzën *mbassi* e ka vendin zakonisht para fjalisë drejtuese, por mund të rrijë edhe pas saj. Nga të 27 fjalitë kohore me këtë lidhëz që gjenden te Buzuku 19 rrinë përpara e 8 pas fjalisë drejtuese.

2) Lidhëza *përsā* gjendet vetëm katër herë në «Mesharin» e Buzukut me kuptimin e lat. *dum*: *Lypëni Tenëzonë, përsā gjindetë; Vgjai Tenëzonë përsā gjindetë, grëshitenie përsā anshtë afërë* «Quaerite Dominum, dum inveniri potest: invocate eum, dum prope est» (124a39; 234b22, 23 Isaia 55,6); *A s na ish dhezunë zemëra jonë përsā na fal pr udhët* «Nonne cor nostrum ardens erat in nobis dum loqueretur in via» (242a35 Luka 24,32).

Midis fjalisë kohore të ndërtuar me lidhëzën *përsā* e fjalisë drejtuese të saj ka raport njëkohësie dhe fjalια kohore shënon caqet brenda të cilave kryhet veprimi i fjalisë kryesore. Në këtë kuptim lidhëza *përsā* është sinonime me lidhëzën *sā*, kur kjo ka vlerën që është përshkruar në pikën a f. 47, veçse lidhëza *përsā* e jep në një mënyrë më të dallueshme idenë e përcaktimit të kohës së veprimit të fjalisë drejtuese.

Në të katër shembëllat e mësipërme fjalια kohore me lidhëzën *përsā* është vendosur pas fjalisë kryesore.

### Lidhëza lokucione

Te «Meshari» i Buzukut janë përdorur këto lokucione lidhëzore me kuptim kohor: *djerie kur, qish kur, djerie sā, djerie mos, djerie mbë herë qi, mbë herë qi, gjithë herë qi, për gjithë herë qi, përherë qi, parë se, sā ku*.

1) Lokucioni *djerie kur*<sup>55</sup> është përdorur tetë herë në vend të lat. *quoad usque, usque dum, donec* p.sh. *E përkaqë ju mos gjukoni asndonjë kafshë parë herësë, djerie kur të vinjë Zotynë* «Itaque nolite

55) Në një rast del një *kūr* me *α* të gjatë (360a7).

ante tempus iudicare, quoad usque veniat Dominus» (94b22 Korintasit I 4,5); *E hinje yilli qi patnë pātë ndë dalët të diellët u duol përpara, djerie kur erdh përmbi djalët* «et ecce stella quam viderant in oriente antecedebat eos, usque dum veniens staret supra ubi erat puer» (78b9-10 Mateu 2,9); *Përse sã herë ju të hani këtë bukë e ju të pini kelqinë, ju të promendëni mordnë e Tinëzot djerie kur të vinjë* «Quotienscumque enim manducabitis panem hunc, et calicem bibetis, mortem Domini adnuntiatis donec veniat» (216b30-1 Korintasit I 11,26); *nukë e lëshou, djerie kur aj të përziq portekënë e regjënise* «non dereliquit illum, donec afferret illi sceptrum regni» (356b41 Libri i Urtës 10,14), po kështu edhe në 276b11; 314b6; 360a7.

Në periudhën me fjali kohore të ndërtuar me lidhëzën *djerie kur* tregohet se veprimi i fjalisë drejtuese zgjat deri në çastin që nis veprimi i fjalisë së varur, pra lokucioni *djerie kur* ka të njëjtën vlerë me lidhëzën e thjeshtë *djerie*, me ndryshimin që e përcakton më mirë çastin e mbarimit të veprimit të fjalisë drejtuese. Folja-kallëzues e fjalisë kohore me lidhëzën *djerie kur* është zakonisht në të tashmen e lidhores; vetëm një herë del në të pakryerën e po kësaj mënyre e një herë tjetër në të kryerën e thjeshtë të dëftores (shih shembëllat më lart). Fjalialia kohore me lidhëzën *djerie kur* në të tetë rastet qëndron pas fjalisë drejtuese.

2) Lokucioni *qish kur* del vetëm një herë dhe është antonimi i *djerie kur*, pasi fjalialia kohore e ndërtuar me këtë lokucion shënon çastin e fillimit të veprimit të fjalisë drejtuese, d.m.th., veprimi i fjalisë drejtuese, dhe i së varurës kohore nisin të dy në të njëjtën kohë. Ja dhe shembëlla e Buzukut: *Ti nukë më puthe; e këjo, qish kur hini, nukë ka pushuom me puthunë kambëtë e mī* «Osculum mihi non dedisti: haec autem ex quo intravit, non cessavit osculari pedes meos» (196a17 Luka 7,45).

3) Lokucioni *djerie sã* gjendet vetëm pesë herë dhe është përdorur me kuptimin e lat. *donec*, p.sh. *uçeli Noe fëniestërë e barkësë, e dërgoi korbnë, qi mã nukë kthey, djerie sã u thanë ujënatë* «Aperiens Noe fenestram arcae, quam fecerat, dimisit corvum: qui agrediebatur et non revertebatur, donec siccarentur aquae» (230b35-6 Gjenezja 8,6-7); *e fort lypën djerie sã ta ketë gjetunë* «et quaerit diligenter, donec inveniat» (280a14-15 Luka 15,8), po kështu edhe në 292a43 e 332b38; një herë Buzuku «usque ad mortem» e ka përkthyer shqip *djerie sã përzū mort* (202b8 Filipasit 2,8).

Në të gjitha rastet fjalialia kohore e ndërtuar me lidhëzën *djerie sã* tregon cakun deri ku zgjat veprimi i fjalisë drejtuese. Ajo rri gjithmonë pas fjalisë drejtuese.

4) Lokucioni *djerie mos* del te Buzuku tetë herë, kryesisht me kuptimin e lat. *donec* e ndonjëherë *quoad usque*. Fjala *mos* këtu nuk është pjesëz mohuese, sepse nuk mohon ndonjë gjë, por vetëm përforcon kuptimin e cakut, pra ajo është element që hyn në përbërjen e lidhëzës<sup>56</sup>. Ky element qëndron kurdoherë para kallëzuesit, po mund të jetë i ndarë prej lidhëzës *djerie* nga ndonjë gjymtyrë tjetër e fjalisë. Lokucioni *djerie mos* ka të njëjtën vlerë me lidhëzën e thjeshtë

56) Khs, ç'thuhet për lidhëzën *noka he* të rusishtes në *Sovremennyj russkij jazyk II*, pod redakciej prof. E. M. Gallkinoj-Fedoruk, Moskva 1964, f. 574, shënim 1: «he këtu hyn në përbërjen e lidhëzës... dhe nuk është pjesëz mohimi, sepse nuk shpreh ndonjë mohim, por vetëm përforcon kuptimin e cakut».

*djerie*. Nga tetë fjalitë kohore të ndërtuara me këtë lokucion lidhëzor, gjashtë e kanë foljen-kallëzues në mënyrën lidhore e vetëm dy në dëftore, p.sh. *Për të vërtetë u juve thom: se këjo farë mos të shkonjë djerie gjithë këto mos jenë* «Amen dico vobis quia non praeteribit generatio haec, donec omnia fiant» (84b7 Luka 21,32); *ata nukë e njohne djerie mos bekou bukënë* «et quomodo cognoverunt eum in fractione panis» (242a44 Luka 24,15); *Mos trazoni mos dhenë, mos detinë, mos lisavet djerie mos shënojme sherbëtorëtë e Tinëzot n ballë* «Nolite nocere terae neque mari neque arboribus, quoad usque signemus servos Dei nostri in frontibus eorum» (346a18 Apokalipsi 7,3); shih edhe 66a10; 178b27-8; 198b28; 338a15; 372b41. Në të gjitha këto raste fjalia drejtuese përmban një pjesëz mohimi *mos a nuk*.

Fjalia kohore e ndërtuar me lidhëzën *djerie mos* qëndron kurdoherë pas fjalisë drejtuese.

5) Te lokucionet *djerie mbë herë qi* (382b44), *mbë herë qi* (374b14), *gjithë herë qi* (62b10), *për gjithë herë qi* (16a33; 22b36; 30a37), *përherë qi* (12b31) lidhëza e vërtetë është *qi*, kurse elementet e tjera të lokucionit, në burim, janë fjalë korrelative të kësaj lidhëze në fjalinë drejtuese. Megjithatë nga lidhja shumë e ngushtë që ekziston midis tyre mund të na lejohet ta shohim lidhëzën *qi* bashkë me fjalët korrelative të saj si një lokucion lidhëzor.

Lokucioni *djerie mbë herë qi* jep idenë e një caku kohor: *Nd ato dit dërgoi Zotynë mortajënë ndë Israelt ndënatant djerie mbë herë qi ordhënuom kle n Sinëzot* «Immisitque Dominus pestilentiam in Israel, de mane usque ad tempus constitutum» (382b44 Samuelli II 24,15). Lokucioni *mbë herë qi* tregon njëkohësi.

Në shembëllën e Buzukut kemi njëkohësi të pjeshme: veprimi (më i shkurtër) i fjalisë drejtuese ndodh në një çast të kohës së veprimit (më të gjatë) të fjalisë kohore: *E prashtu itëni nquom, përse i Biri i njeriut të vinjë mbë herë qi ju nukë kujtoni* «Et vos estote parati: quia qua hora non putatis, Filius hominis venit» (374b14 Luka 12,40). Lokucionet *përherë qi*, *gjithë herë qi*, *për gjithë herë qi* shprehin bashkëpërkim kohësor veprimesh që përsëriten, p.sh. *gjithë shenjtitë e tū, lusmë, Zot, qi për gjithë vend ata na ndimofshinë: ashtu qi përherë qi ata neve kur na raftë ndë mend për meritat të tyne, na ndjefshim ndimënë e tyne* (12b31); *E forca m ashtë me u dhanë me e ditunë këtë kat, kur buri me gruot të vet flenë, gjithë herë qi ata të uzonjinë njani me tjerërit, qi të mos përkit faqe më faqe, ata ndë kat qi thotë: Non mechaberis, bienë* (62b10); *gjithë shenjtitë e tū, lusmë, Zot, qi mbë gjithë vend ata na ndimofshinë: ashtu qi për gjithë herë qi ata neve na rafshinë ndë mend për meritat e tyne, na ndjefshim ndimënë e tyre* (16a33; 22b36; 30a37).

6) Lokucioni *parë se* del te Buzuku njëzet e dy herë<sup>57</sup>.

Në periudhën me fjali kohore të ndërtuar me lidhëzën *parë se* veprimi i fjalisë drejtuese paraqitet si pararendës i veprimit të së varurës kohore. Në tekstin latin lokucionit *parë se* të Buzukut i përgjigjen zakonisht *antequam* e *priusquam*, që kanë jo vetëm të njëjtin kuptim, po edhe të njëjtin ndërtim me lidhëzën shqipe.

57) Te Buzuku ka edhe dy raste ku *parë* dhe *se*, ndonëse janë pranë, nuk formojnë një lokucion lidhëzor, por ruajnë kuptimet e tyre, d.m.th. njëra ndajfolje kohe, tjetra lidhëz krahasore: *parë se punënë e shpirtit sheh punënë e kësaj jete* (64b12); shih edhe 24a28.

Folja kallëzues e fjalisë kohore të ndërtuar me lidhëzën *parë se*, mund të jetë në mënyrën dëftore (në të tashmen, në të pakryerën, në të kryerën e thjeshtë, në të kryerën e të kryerën e plotë) e në lidhore (në të tashmen e në të kryerën) p.sh.:

në dëftore: *Klofshinë porsi bari qi lindetë përmbi shtëpit, qi parë se vjen ndukunë anshtë përvëluotë* «Fiant Sicut foenum tectorum: quod priusquam evellatur exaruit» (28a27 Psalm 128,6); *Për të vërtetë, për të vërtetë u juve thom, parë se Abraami ish, u jeshë* «Amen amen dico vobis: Antequam Abraham fierit, ego sum» (186b43-4 Gjoni 8,58); *Por kush kle aj qi kle për gjā, e muo më përū e u angra n gjithësej parë se ti vinjë?* Quis igitur ille est qui dudum captam venationem attulit mihi, et comedi ex omnibus priusquam tu venires? (148a6 Gjenezza 27,33); *E panë për së largu e parë se u afëruo atyne, ata u kujtuonë me e nvrām* «Qui cum vidissent eum procul, antequam accederet ad eos, cogitaverunt illum occidere» (144a23-4 Gjenezza 37, 18); *N së zanët nfill e parë se ish shekulli zanë u jam kriuom* «Ab initio, et ante saecula creata sum» (26a21 Ekleziastiku 24,14); *u grish emënitë e ti Jezu, porsi kle grishunë n engjëllit parë se ish zanë ndë bark* «vocatum est nomen eius Jesus, quod vocatum est ab angelo priusquam in utero conciperetur (320b44 Luka 2,21) etj.»<sup>58</sup>

në lidhore: *Bjerëmë n gjājet sote, e më ban gjellë të shishime, e të hā e të të bekonj përpara Tinëzot parë se u të vdes* «Affer mihi de venatione tua, et fac cibos ut comedam, et benedicam tibi coram Domino antequam moriar» (146a24 Gjenezza 27,7); *E tash ya thom parë se të jetë bām, përse, qysh kloftë bām, ju të besoni* «Et nunc dixi vobis priusquam fiat: ut cum factum fuerit, credatis» (264b19 Gjoni 14,29) etj.

Siç shihet nga shembëllat e sjella më sipër, fjalia kohore e ndërtuar me lidhëzën *parë se* mund të rrijë si para ashtu edhe pas kryesores. Buzuku ka respektuar kurdoherë vendin e fjalisë kohore në tekstin latin dhe prandaj raporti i barabartë 11 raste prepozicioni e 11 raste postpozicioni nuk zbulon ndonjë veçanti sintaktike të shqipes.

7) Lokucioni *sā ku* del vetëm dy herë në përkthimin e lat. «in momento» me shprehjen e gjallë *sā ku bane kryq*. Veprimi i fjalisë kohore të ndërtuar me këtë lokucion në të vërtetë nuk kryhet, por, duke qenë një veprim i rëndomtë e që bëhet sa të hapësh e të mbyllësh sytë, merret si masë për të përcaktuar sa kohë zgjat veprimi i fjalisë kryesore. Shembëllat e Buzukut janë: *klenë qitunë ndë liqët e klenë ngranë n luajnshit, sā ku bane kryq* «intromissit in lacum et devorati sunt in momento coram eo» (190b2 Danieli 14,41); *E sā ku bane kryq, kur të bjerë gareta e mbrapmeja; ajo të bjerë, e të vdekunite tue u ngjallë të dëlirë e pā ndonjë gjimt, e na të ndëronemi* In momento, in ictu oculi, in novissima tuba: canet enim, et mortui

58) Mënyra dëftore te fjalitë kohore të ndërtuara me këtë lidhëz në shqipen letrare të ditëve tona nuk ndeshet më, po ka vijuar të përdoret nga autorë gegë deri nga fundi i shekullit të kaluar e fillimi i këtij shekulli, khs, p:sh: *Perëndia i laftit i uduk atit t'ynë Abrahamit, kur ishte ndë Mesopotani, para se pat ndenjun ai ndë Harran K; Kristoforidhi, Dhiata e re, 1872, Punët 7,2; Para se kje dhanë sheji i luf-tës...* Sh. Gjeçov, *Agimi i gjytetnis*, Shkodër 1910, f. 69; *nuk e paçë paa t'and vlla para se erdha nuse* Ndoc Nikaj, *Fejesa n'djep*, Shkodër 1918, f. 33. Për toskërishten nuk dimë që me këtë lidhëz të jetë përdorur ndonjëherë dëftorja.

resurgent incorrupti, et nos inmutabimur» (380a23 Korintasit I 15, 52).

Në vend të kësaj shprehjeje që s'dimë a përdoret edhe sot apo jo, Grigori ka mbë një të mbillurë të siut pas gr. *ἐν ριπῇ ὀφθαλμονό*, kurse Kristoforidhi përdor një shprehje popullore sa çel e mbyll *sytë*.<sup>59</sup>

#### 4. Lidhëzat kushtore

Kategoria e lidhëzave kushtore te Gjon Buzuku paraqitet mjaft e varfër në krahasim me gjuhën e sotme. Barrën e shprehjes së raporteve kushtore në periudhë e mban te ky autor vetëm lidhëza në dhe tri lokucione të formuara me anë të saj: *në kloftë qi, në kloftë se e se . . . . në (se në)*, që janë përdorur dy të parat nga një herë, kurse i treti katër herë.

1) Lidhëza *në* (para zanoreve *n*) del te Buzuku 301 herë, dhe është kështu një ndër lidhëzat që kanë dendurinë më të lartë. Ajo është përdorur me kuptimin e lidhëzës *si* të latinishtes. Folja-kallëzues e fjalisë kushtore të ndërtuar me lidhëzën *në* mund të jetë në mënyrën dëftore (139 herë), në dëshiroren (153 herë) dhe në habitoren (9 herë). Kur është në mënyrën dëftore, ajo përdoret më fort në të tashmen e në të pakryerën, më rrallë në të kryerën e thjeshtë, në të kryerën e në të kryerën e plotë, p.sh. *në kã et, epi të pie* «si sitit, potum da illi» (102a10 Romanët 12,20); *Duroni në u hjek kush mbë sherbëtyrë* «Sustinetis enim, si quis vos in servitutum redigit (108a4 Korintasit II 11,20); shih edhe 108a5, 6, 11, 12, 13, 14, 15, 41, 108b5, 19; 110b1, 10, 11 etj. etj.; *u në flasë sã gluhë kanë njerëzitë* «Si linguis hominum loquar» (11b1 Korintasit I 13, 1); *Ti në dinje hirë e Tinëzot* «Si scires donum Dei (160b22 Gjoni 4,10) *E ky në mos ish n Sinëzot, nukë të mujtëke me bãm asndonjë kafshë* «Nisi esset hic a Deo, non poterat facere quicquam (178a17 Gjoni 9,33); shih edhe 184b43; 186a35; 186b36; 194b45, etj. etj. *E tash në pãe Suzanënë, thuo përndenë qish lis e pae* «Nune ergo si vidisti eam, dic sub qua arbore videris», (166a36 Danieli 13,54); *U në fola keq, dëshmomë në kam folë keq. E në fola mirë, përse më nvret?* «Si male locutus sum, testimonium perhibe de malo: si autem bene, quid me caedis? (222a15, 16 Gjoni 18,23); shih edhe 56b36; 68a20; 274b39 etj.; *ti në e kē shpūm kon, thuojmë* «si tu sustulisti eum, dicito mihi» (246b42 Gjoni 20,15); shih edhe 222a16; 282b39; 336a23 etj.); *ti në ishnjë klenë këtu, em vëllã nukë ish vdekunë* «si fuisses hic, frater meus non fuisset mortuus» (182a38 Gjoni 11,21); shih edhe 254a20; 286b42; 292b4 etj.

Përsa i përket dëshirores, në shumicën dërmuese të rasteve është përdorur e tashmja e fare pak e kryera: *E u në dasha me u lëvduom, nukë të banj pors i pãditunë* «Nam etsi voluero gloriari, non ero insipiens» (108b19 Korintasit II 12,6); *Ti në ngritësh për vjedmis zemërësë sate vargtë të hiekeqit zakonit tit* «Si obstuleris de medio tui catenam» (118a36 Isaia 58,9) etj. etj.; *E Satanosi kondra vetëveti në kloftë dãm, si të jesë regjënja e tî?* Si autem et Satanas in se ipsum divisus est, quomodo stabit regnum ipsius? (150b21 Luka 11,18) etj.

59) Lokucioni *sa ku* del ndonjëherë edhe sot, por për të lidhur dy fjali të bashkërenditura kundërshtore (shih S. Prifti, *Sintaksa gjuhës shqipe*, Pjesa II, dispensa II Tiranë, 1962, f. 205).

Siç u tha edhe më lart, lidhëza *në* është përdorur nëntë herë edhe me folje në habitore, p.sh. *Tÿ profeta në të thanëkë kafshë të mëdhā, a s i kishnjē ti bām?* et si rem grandem dicisset tibi propheta, certe facere debueras» (152b37 Mbretërit II 5,13); *Zot, ti në klenë-kishnjē këtu, em vëllā nukē ish vdekunē* «Domine, si fuisses hic, non esset mortuus frater meus» (182b23 Gjoni 11,32); *E u në mos arkeshë, e u në mos keshë thanë atyne, të mos paskishnē kat* «Si non venissem et locutus fuisset eis, peccatum non haberent» (352b5 Gjoni 15,22); shih edhe 42b17; 222a35; 324b4; 352a38; 352b9; 378b40<sup>60</sup>.

Është për të vënë re se lidhëza *në* te Gjon Buzuku është mjeti themelor i shprehjes së raporteve kushtore në periudhë. Ajo përdoret te ky autor edhe në raste që sot gati nuk dëgjohen në gegërishten, si p.sh. me një folje në të pakryerën e në të kryerën e plotë të dëftores, ose me një folje në dëftore të shoqëruar nga pjesëza e mohimit *mos* (shih shembujt më lart). Që nga Buzuku e këtej shqipja, e veçanërisht gegërishtja veriore, ka përpunuar mjaft mjete e mënyra të tjera për shprehjen e raporteve kushtore.

#### Lidhëza lokucione

1) Lokucioni *në kloftë qi* është përdorur vetëm një herë: *e në kloftë qi t u jesë kun gjākafshë, ju ta digjëni me zjarm* «Si quid residuum fuerit, igne comburetis» (220a30 Eksodi 12,10).

2) Lokucioni *në kloftë se* është përdorur gjithashtu vetëm një herë: *Qi ju n si gëzonī, e tash në kloftë se për pak t ini trazuom mbë shumë mëndyrë për të tentuom* «In quo exultatis, modicum nunc si oportet contristari in variis temptationibus (366a19 Pjetri I 1,6).

Këto lokucione janë gjykuar si të tilla duke u nisur nga vetëdija gjuhësore e sotme, po Buzuku mund të mos i ketë ndjerë kështu; atëhere aty do të dallonim lidhëzën kushtore *në*, foljen *kloftë* dhe lidhëza ftilluese *qi, se*.

3) Lokucioni *se ... në*, që e pamë në një rast me kuptim ftillëzues, del katër herë edhe si kushtor, po në tri shembëlla gjymtyrët e tij janë larg njëra-tjetrës.<sup>61)</sup>

Në dy shembëlla prej «Pasthënies» fjalia e varur e ndërtuar me këtë lokucion ka kuptim thjesht kushtor: *E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fëjyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë mā i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mirë. Përse nukē çuditëm se në paça fëjyem, këjo tue klenë mā e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë* (386 rreshti 37, 40).

Në dy shembëllat e tjera fjalia e ndërtuar me lokucionin *se ... në* ka kuptim kushtor-lejor, d.m.th. shpreh një supozim me të cilin bie në kundërshtim ajo që thuhet në fjalinë kryesore: *E se ajo në u haroftë, u nukē haronem n teje*. «et si illa oblita fuerit, ego tamen non obliviscar tui (184b17 Isaia 49,15); *E se gjithë në u skandalixonem n teje, u kurajtë të mos skandalixonem* «Etsi omnes scandalizati fuerint in te, ego numquam scandalizabor» (204b11 Mateu 26,33).

Në të katra shembëllat e mësipërme fjalia e varur rri para fjalisë kryesore.

60) Këto trajta kanë vërtet ndërtimin e habitores, po ngarkesa afektive e tyre ose është shumë e dobët, ose mungon krejt.

61) Shih për këtë lidhëz E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XV* «Studime filologjike» nr. 4, 1964 f. 96.

## 5. Lidhëzat shkakore

Edhe kategoria e lidhëzave shkakore te Gjon Buzuku paraqitet mjaft e varfër në krahasim me gjuhën e sotme. Barrën më të madhe të shprehjes së raporteve shkakore e ka marrë mbi vete lidhëza *përse*. Dy lidhëza të tjera shkakore janë *se* e *si*. Në dy-tri raste ka kaluar në lidhëz shkakore përemri lidhor *qi*.

1) Lidhëza *përse*<sup>62)</sup> e përbërë nga parafjala *për* e lidhëza e thjeshtë *se* është përdorur si shkakore 585 herë dhe është kështu lidhëza me dendurinë më të lartë nga nënrenditëset. Ajo është përdorur 200 herë për *lat. enim*, 210 herë për *quia*, 91 herë për *quoniam*, 13 herë për *nam*, 6 herë për *quod*, 6 herë për *quippe*, 3 herë për *etenim*, 3 herë për *autem* e 2 herë për *sed*: *Mos druoj Mëri, përse ti gjete hër ndaj Tenëzonë* «Ne timeas, Maria, invenisti enim gratiam apud Deum» (88b27 Luka, 1,30); *E ajo tue klanë pat qyrë mbë qiell, përse ajo kish shpënesë mbë Tenëzonë* «Quae flens suspexit ad caelum: erat enim cor eius fiduciam habens in Domino (164b30 Danieli 13,35) etj.; *Bekuom kloftë Zot Zoti ynë i Israelit, përse aj na vizitoi e bani të shpërblenëtë e popullisë vetë* Benedictus Dominus Deus Israhel: quia visitavit, et fecit redemptionem plebi suae (12a13 Luka 1,68), *Ki mishërier n nesh, Zot, ki mishërier, përse jemi fort plot t' idhunë; e përse shpirti ynë anshtë plot të thashuna të këqia, ansish qi kanë superbi të madhe* «Miserere nostri Domine, miserere nostri: quia multum repleti sumus despectione: Quia multum repleta est anima nostra: opprobrium abundantibus, et despectio superbis» (20a3, 4 Psalm 122,3-4) etj; *Lëvdoni Tënëzonë, o gjithë ju gjindja; lëvdoni atë, o gjithë ju populli, përse u forcuo mishërierja e ti përmbi në* «Laudate Dominum omnes Gentes: laudate eum omnes populi: Quoniam confirmata est super nos misericordia eius» (14b38 Psalm 116,1-2) *E atëherë kur këto të zihenë nfill me klenë, këqyrni, e ngrini krenëtë tuoj, përse u afëronetë të shpërblenëtë taj* «His autem fieri incipientibus, respicite et levate capita vestra: quoniam adpropinquat redemptio vestra» (84a43 Luka 25,28); *Ty të mbaston hiri em, përse vertytja eme ban perfet n sëmundet* «Sufficit tibi gratia mea: nam virtus in infirmitate perficitur» (108b30 Korintasit II 12,9). *Për të vërtetë edhe ti je n sish, përse n gluhet ti njihë* «Vere et tu ex illis es: nam et loquella tua manifestum te facit» (206b41 Mateu 26,73); *E ish Joakini fort i begatë, e kish një kopështë afërë shtëpisë ti, qi ndë të mbëlidhnishnë Xhuhitë, përse aj ish i parë e mā i ndershim n gjithë n sish* «Erat autem Joakim dives valde, et erat ei pomarium vicinum domui suae: et ad ipsum confluebant Iudaei, eo quod esset honorabilior omnium» (164a9 Danieli 13,4); *E Jezu nukë u kish besë atyne për vetëhenë, përse aj i njih gjithë* «Ipse autem Jesus non credebat semetipsum eis, eo quod ipse nosset omnes» (172a15 Gjoni 2,24) etj.; *duoj me u lām ndë kopështë, përse ish vapë* «voluitque lavari in pomario: aestus quippe erat» (164a32 Danieli 13,15); *E vdiq djalëtë e kësaj gruo natënë, përse ajo tue njetunë e mbyti ndë gjumët* «Mortus est autem filius mulieris huius nocte: dormiens quippe oppressit eum» (170a36 Mbretërit I 3,19) etj.; *Ju më grëshitëni Mjeshtrë e Zot; e ju mirë thoni:*

62) Për shkakoret *përse* e *se* shih edhe E.Lafe, *art. cit.*

**përse u jam** «Vos vocatis me Magister, et Domine: et bene dicitis: sum etemin» (218a40 Gjoni 13,13) etj.

Pesëdhjetë e gjashtë herë lidhëzës **përse** të Buzukut nuk i përgjigjet në tekstin latin ndonjë lidhëz shkakore. Në këtë numër përfshihen kryesisht rastet kur Buzuku marrëdhënjet e shkakut të shprehura pa lidhëz në frazën latine i ka dhënë shqip me anë të lidhëzës **përse**, p.sh. **Linii: përse ata verbënë janë** «Sinite illos: caeci sunt» (158a23 Mateu 15,14; shih edhe 20a39-40; 48a3; 176a32 etj.) ose kur pjesoren e tashme veprare me vlerë shkakore të latinishtes e ka dhënë shqip me një fjali lidhëzore me folje në mënyrë të shtjellë, p.sh. **E gjegj gjithë Israeli gjyqitë qi regji gjukou, e mbasandaj druojnë n faqejet së regjit, përse panë se urta e Tinëzot ish ndë zemërë të tî me bām gjyq** «Audivit itaque omnis Israel iudicium quod iudicasset rex, et timuerunt regem, videntes sapientiam Dei esse in eo ad faciendum iudicium» (170b22 Mbretërit I 3,28); shih edhe 34a33; 340a13 etj.

Por ka mjaft raste të tjera kur Buzuku ka shtuar vetë një **përse** ose e ka përdorur këtë lidhëz (zakonisht si shtesore) edhe në raste ku teksti latin ka *et, autem, sed*; p.sh. **Përse ti, Zot, bane qiellë e dhenë** «Tu fecisti caelum et terram» (138b31-2 Ester 13,10); shih edhe 104a10; 110a20; 112a27 etj.; **E këjo fjalë ish e fshehunë n sish, përse nukë mundë mernjinë për se aj flit** «Et erat verbum istud absconditum ab eis, et non intellegebant quae dicebantur» (112a13 Luka 18,34); shih edhe 122b35; 188b11; 254b43; 270a28 etj. **Përse engjëlli i Tinëzot dirgjë ndë një mot ndë bërakët e turbullon ujëtë** «Angelus autem Domini descendebat secundum tempus in piscinam; et movebatur aqua» (130b30 Gjoni 5,4), **Përse kështu thotë Zot Zoti ynë i Israelit** «Haec autem dicit Dominus Deus Israël» (138a8 Mbretërit I, 17,14)<sup>63</sup>; shih edhe 224a45; **Mos, atë Abraami; përse në voftë kush n së vdekunëshit atyne, kanë me u besuom e ata të pëndonenë së keqesë** «Non, pater Abraham: sed si quis ex mortuis ierit ad eos, paenitentiam agent» (142a43 Luka 16,30); shih edhe 222a31.

Lidhëza shkakore **përse** të Gjon Buzuku del në shumë raste edhe si shtesore, sidomos kur është përdorur për lat. *enim* ose *nam*: **E ashtu të mbrapëmitë të jenë të parë e të parëtë të jenë të mbrapm. Përse shumë janë grishunë, e pak janë të zgjedhunë** «Sic erunt novissimi primi, et primi novissimi. Multi enim sunt vocati, pauci vero electi» (106b25 Mateu 20,16); **Zot, u nukë jam i denjë tî me hîm ndë shtëpî teme, ma pur thuo një fjalë të vetëme, e të jetë shëndoshunë sherbëtori em. Përse edhe u jam nierî, tue pasunë soldata përndenë muo** «Domine, non sum dignus ut intres sub tectum meum: sed tantum dic verbo et sanabitur puer meus. Nam et ego homo sum sub potestate, habens sub me milites (102a38 Mateu 8,8-9); **Bekuom gjithë ata qi Tenëzonë druonë e qi ecnjënë pr udhë të tî. Përse të hāsh fëdigënë e duoret tuve; e ti je bekuom, e tÿ kā me të klenë mirë** «Beati omnes qui timent Dominum, qui ambulat in viis ejus. La-

63) Është me interes të shënohet se për këto dy shembëlla Kristoforidhi si edhe në përkthimet italisht, frëngjisht e gjermanisht të Dhjatës së re ka një lidhëz shkakore e jo kundërshtore, p.sh. it. *Poichè l'Angelo del Signore...; fr. car un ange descendait...; gjerm: Denn ein Engel fuhr herab...; Krist. Sepse kohë mbë kohë sdrypte engjulli...; it. poichè il Signore Dio d'Israele dice così...; fr: Car ainsi parle l'Éternel, le Dieu d'Israël...; gjerm: Denn also spricht der Herr, der Gott Israels:*

bores manum tuarum quia manducabis: beatus es, et bene tibi erit» (22a28 Psalm 127,1-2) etj.

Fjalitë shkakore të ndërtuara me lidhëzën *përse*, siç shihet edhe nga shembëllat e sjella deri këtu, qëndrojnë pas fjalisë kryesore. Folja-kallëzues e tyre është në mënyrën dëftore. Gjithësej vetëm në nja dy-tri raste fjalia shkakore ka dalë para kryesores, sepse Buzuku i ka lënë me renditjen që kanë në tekstin latin: **Përse** *ju nukë besuotë mbë muo, me më shenjtënuom përpara faqesë d bijet Israelit, e prashtu ju të mos shpiri këta të mbëljedhunë ndë dhët që u t ap atyne* «Quia non credistis mihi, ut sanctificaretis me coram filiis Israel introducetis hos populos in terram, quam dabo eis» (160a42 Numri 20,12); *Por përse u juve fola këto kafshë, një t idhunë mbushi zemërenë taj* «Sed quia haec locutus sum vobis, tristitia implevit cor vestrum» (256a26-7 Gjoni 16,6).

2) Lidhëza *se* si shkakore është përdorur prej Buzukut 50 herë. Në tekstin latin asaj i përgjigjen zakonisht lidhëzat *enim, quia, nisi quia, quod, quoniam*: *Mos druoj, Mëri, se gjete hër ndaj Tenëzonë* «Ne timeas, Maria, invenisti enim gratiam apud Deum» (11a41); *E por ndë këta mos gëzonë se shpirtënatë janë përndenë jū; por gëzonë se emënitë taj anshtë shkruom mbë qiellt* «Verum tamen in hoc nolite gaudere quia spiritus vobis subiciuntur: gaudete autem, quod nomina vestra scripta sunt in caelis» (368b25, 26 Luka 10,20) etj.

Në tetëmbëdhjetë raste Buzuku ka shtuar vetë një *se* shkakore, duke ndërruar ndonjëherë edhe kuptimin e periudhës, siç mund të vërehet te dy shembëllat e fundit: *Mos trembë, se u jam, kini shpënesë* «Confidete, ego sum, nolite timere» (118b39 Marku 6,50); *Mos m i për të trembunë, se ti je shpënesa n ditet së keqe* «Non sis tu mihi formidini; spes me a tu in die afflictionis» (196b15 Jeremia 17,17); *E mbassi starisfati i kërkoj, ujëtë ish bām venë, e nukë dij se kaha vjen; ma shrbëtorëtë e dinjinë, se kishnë marrë ujëtë;* «Ut autem gustavit architriclinus aquam vinum factam, et non sciebat unde esset: ministri autem sciebant, qui hauserant aquam» (100b17 Gjoni 2,9); *Zot, mos, se aj mū kā me qelbunë, përse qysh katërë dit anshtë ndë vort* «Domine, iam fetet, quadridanus enim est» (182b38 Gjoni 11,39).

Fjalia shkakore e ndërtuar me lidhëzën *se* rri gjithmonë pas kryesores.

3) Lidhëza *si*, e përdorur me kuptim shkakor, haset vetëm dy herë<sup>64</sup>. Në njërin rast Buzuku e ka shtënë në punë për të përkthyer një ablativus causae: *Pā se ata kishnë bām forcë kondra tī fort, e si kle forcuom n nevojet, u dha atyne Danielnë* «Vidit ergo rex quod irruerent in eum vehementer: et necessitate compulsus tradidit eis Daniele» (190a13 Danieli 14,29); në rastin tjetër: *E të dytënë ditë, si kish me u dām, dha dy denarë ostit e i tha* «Et altera die protulit dous denarios, et dedit stabulario, et ait» (292a14 Luka 10,35) shihet se Buzuku nuk ka shkuar pas tekstit latin, të cilit i mungon fjalia *si kish*

64) Që vlera shkakore e kësaj lidhëze ka dalë nga vlera kohore e saj, është një gjë që kuptohet vetiu, po për sintaksën shqipe është me interes të shënohet se kjo ka ndodhur që te Gjon Buzuku. Në shqipen e sotme përdorimi i *si-së* me vlerë shkakore është mjaft më i shpeshtë.

me *u dām*, po pas ndonjë teksti tjetër, ndoshta pas skr. *polazeçi*, ose pas gr. ὅτι ἐξήρατο (prandaj Kristoforidhi ka kur do të delte), duke e interpretuar këtë fjali si shkakore.

4) Lidhëza *qi*. Siç thamë në krye të trajtimit të kësaj kategorie lidhëzash, përemri lidhor *qi*, më ndonjë rast, ka kaluar në lidhëz shkakore: *Qish anshtë qi ju më kërkoni?* «Quid est quod me querebatis?» (98a37 Luka 2,49). *Qish frujt patë atëherë nd ato të bāme, qi tash ini turpënuom?* «Quem ergo fructum habuistis tunc in quibus nunc erubescitis?» (284b4 Romanët 6,21). Në shembëllën e mëposhtme, pa pasur parasysh tekstin latin, nuk mund të kuptohet se e dyta *qi* është përdorur me vlerën e një lidhëze shkakore: *uçili sýtë e tū, e shih të faruomitë tanë, e qytetnë, qi përmbi të anshtë grishunë emënitë tat; qi jo për të dërejtatë tanë na bām me na rām të lutunatë tonë përpara faqesë sate* «aperi oculos tuos, et vide desolationem nostram, et civitatem, super quam invocatum est nomen tuum: neque enim in justificationibus nostris prosternimus preces ante faciem tuam» (136a24 Danieli 9,18).

Te Gjon Buzuku dalin në dy-tri raste edhe fjali shkakore me lidhje bashkërenditëse kundërshtore ndërmjet tyre. Te e para nga këto mohohet një shkak për t'u paraqitur te e dyta në formë kundërshtimi shkakui i vërtetë i një pune. Kjo marrëdhënje shprehet me anë të korrelacionit lidhëzor *jo se . . . . por përse*, p.sh. *E këta e tha jo se atë i dhimbë për të vobegjit, por përse ish kusār* «Dixit autem hoc non quia de egenis pertinebat ad eum, sed quia fur erat» (212b12-3 Gjoni 12,6); *E ndë këta anshtë karitati, e jo se na duomë Tenëzonë, por përse aj do në* «In hoc est caritas: non quasi nos dilexerimus Deum, sed quoniam ipse dilexit nos» (274b9-10). Në një rast tjetër mund të nënkuptohet një *përse* pas lidhëzës kundërshtore *por : na të kemi besë mbë Tenëzonë për Krishtnë; e jo se na jemi të denjë na n vetëvetëhenë na me kujtuom ndonjë kafshë, si n vetëhej, por të mujtunitë tanë vjen n Sinëzot* «fiduciam autem talem habemus per Christum ad Deum: non quod sufficientes simus cogitare aliquid a nobis, quasi ex nobis: sed sufficientia nostra ex Deo est» (290b5-7 Korintasit II 3,4-5).

## 6. Lidhëzat rrjedhimore.

Te Gjon Buzuku lidhëzat rrjedhimore përfaqësohen nga *qi*, e cila del vetëm dy herë, *sā* që del dhjetë herë, lokucioni *aqë sā* që del shtatë herë, dhe lokucioni *ashtu qi* që del katër herë.

1) Lidhëza *qi*: *E thanë Xhudhītë ndër vetëhenë: Ku kā kŷ me votë, qi na të mos mundnjëmë me e gjetunë?* «Dixerunt ergo Judaei ad semetipsos: Quoi hic iturus est, quia non inveniemus eum?» (188b16 Gjoni 7,35); *E përmbi gjithë këto kafshë ndër ju e ndër në anshtë forcuom një e madhe gropë, qi ata qi n nesh duonë me ardhunë tek ju, s mundnjënë, as andej këha tek na* «Et in his omnibus, inter nos et vos chaos magnum firmatum est: ut hi qui volunt hic transire ad vos non possint, neque inde huc transmeare» (142a33 Luka 16,26).

2) Lidhëza *sā*, me *a* të gjatë, del te Buzuku dhjetë herë si lidhëz rrjedhimore. Në tekstin latin asaj i përgjigjen lidhëzat *ut, ita ut*, por ka edhe raste që Buzuku ka ndërtuar një fjali rrjedhimore në këtë lidhëz duke i ndryshuar marrëdhënjet sintaksore midis fjalive të ori-

gjinalit; p.sh. *e ndë një ças u bā një fortunë e madhe mbë detit, ashtu sā nava ish mbëluom n valëshit së detit* «et ecce motus magnus factus est in mari, ita navicula operiretur fluctibus» (104a7 Mateu 8,24); *Nd ato dit u sēmū djali e njëj ame n fëmejësh, e aqë e madhe kle sëmunda e tī, sa frymë ndë të nukë mbet* «Factum est post haec aegrotavit filius mulieris matris familias, et erat languor fortissimus, ita ut non ut non remaneret in eo halitus» (180b9 Mbretërit I 17,17); *Aqë u shumuonë ujënatë ndë forcë të tyne, sā mbëluonë gjithë majetë e malet nalta qi përndenë qiellt ishnjinë* «Et aquae praevaluerunt nimis super terram: operitque sunt omnes montes excelsi sub universo caelo» (230b3 Gjenezë 7,19); *E si rjetë patnë shtim, zunë të madh peshk, sā këputishnë rjetë* «Et cum hoc fecissent, concluserunt piscium multitudinem copiosam, rumpebatur autem rete eorum» (280b25 Luka 5-6).

Siç shihet nga shembëllat e mësipërme, lidhëza *sā* mund të ketë si korrelat në fjalinë kryesore ndajfoljen *aqë*. Ky korrelat gjendet në katër nga dhjetë shembëllat. Në të gjitha rastet fjalia rrjedhimore është postpozitive.

*Shënim.* Te shembëlla e parë: *ashtu sā nava ish mbëluom ...* ndajfolja *ashtu* është përkthimi i lat. *ita* dhe nga pikëpamja e shqipes *nuk* formon një lokucion rrjedhimor *ashtu sā*; më tej Buzuku *ita ut e ka përkthyer vetëm me sā* (shih 180b9 e 300a39).

3) Lokucioni *aqë sā*<sup>65</sup> me vlerën e një lidhëze rrjedhimore del te Gjon Buzuku shtatë herë. Në tekstin latin këtij lokucioni i përgjigjet vetëm *ita ut*, me përjashtim të dy rasteve kur Buzuku e ka përdorur pa vend një herë për *itaque* (176a41) dhe një herë tjetër për *ut* (me kuptim qëllimor 278a42). Fjalia rrjedhimore e ndërtuar me këtë lidhëz është kurdoherë postpozitive, p.sh. *E aj nukë ju përgjegj as fjalë, aqë sā gjukatësi çuditë fort* «Et non respondit ei ad ullum verbum, ita ut miraretur praeses vehementer» (208a39 Mateu 27,14); *E erdhnë e mbushnë të dÿ barkëtë, aqë sā duojnë me votë n fond* «Et venerunt et impleverunt ambas naviculas, ita ut mergerentur» (280b28 Luka 5,7) etj.

4) Lokucioni *ashtu qi* del vetëm dy herë me vlerë rrjedhimore dhe duket se është një kalk nga lat. *ita ut: e u të kem gjithë fë, ashtu qi u të derpëtonj gjithë maltë* «et si habuero omnem fidem, ita ut montes transferam» (110b8 Korintasit I 13,2); *porsi anshtë të dëshmuomitë për Krishtnë u forcuo ndë jū, ashtu qi ju nukë mëngoni as ndë ndonjë dhunëtie* «sicut testimonium Christi confirmatum est in vobis: ita ut nihil vobis desit in ulla gratia» (306a11 Korintasit I 1,6-7). Një tjetër frazë që përmban një *ashtu qi*, me sa na duket rrjedhimore (sado që nuk përjashtohet mundësia për të qenë qëllimore), e gjejmë te një nga ato pjesë të Ritualit që nuk janë të përkthyer, po të hartuara nga vetë Buzuku, rrethanë kjo që nuk na lejon të shfrytëzojmë origjinalin për të përcaktuar me siguri kuptimin e lokucionit në fjalë: *Trembu n idolashit së dreqit, pështyj e shaj gjithë të glanatë e dreqit, ashtu qi kurajtë atī mos i nfalesh* (78a22).

65) Në pajtim me S. Floqin (shih *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, në «Studime filologjike» nr. 2, 1965 f. 59) *aqë sā* do ta marrim si lokucion lidhëzor, por S. Floqi, siç duket, nuk e ka pasur parasysh autorin tonë më të vjetër, kur *aqë sa* e grupon në «mjete lidhëse relativisht të reja».

## 7. Lidhëzat qëllimore

Te Gjon Buzuku dalin këto lidhëza qëllimore: *përse*, *se*, *qi*, *tekë* dhe lokucioni *ashtu qi*. Lidhëza *tekë*; siç e ka provuar E. Çabej, është një huazim prej serbokroatishtes, e cila nga ana e saj, e ka marrë prej turqishtes, dhe nuk del te autorët e mëpastajmë.

1) Lidhëza *përse*<sup>65</sup> është më e përdorshme nga lidhëzat qëllimore. Ajo del me këtë funksion 333 herë. Në tekstin latin kësaj lidhëze i përgjigjet zakonisht lidhëza *ut* (273 herë) e lidhëza *ne* (20 herë) *E të hae tëlyenë e mjaltë, përse aj të dije me zgjedhunë të mirëtë n së keqi* «Butyrum et mel comedet, ut sciat reprobare malum, et eligere bonum» (88b11 Isaia 7,15); *E prashtu voluntjera u të lëvdonem përmbi sëmundë të mi, përse ndë muo të banjë vertytja e Krishtit* «Libenter igitur gloriabor in infirmitatibus meis, ut inhabitet in me virtus Christi (108b33 Korintasit II 12,9) etj. *Përse anshtë shkruom se aj të ordhënojë engjëijtë e ti për ty, e ata të mbanë mbë duor të tyne, përse kamba jote mos përpiqetë mbë gurt* «Scriptum est enim quia Angelis suis mandabit de te: et in manibus tollent te, ne forte offendas ad lapidem pedem tuum (120b42 Mateu 4,6); shih edhe 104b31; 106a14-5; 108b21, 23-4 etj.

Me fjali qëllimore të ndërtuara me lidhëzën *përse* Buzuku ka përkthyer edhe konjunktivin, infinitivin, supinin, gerundin e gerundivin final të latinishtes: *Ty të bekoftë i Zoti i Sionit, përse të mundë shofsh të miratë e Israelit për gjithë dit të jetësë glatë sate* «Benedicat tibi Dominus ex Sion: et videas bona Jerusalem omnibus diebus vitae tuae» (22a38 Psalm 127,5), shih edhe 22a40; *E u nukë e njohë; ma aj qi më dërgoi, përse u të pagëzonjë me ujë, aj më tha* «Et ego nesciebam eum: sed qui misit me baptizare in aqua, ille mihi discit» (98b32 Gjoni 1,33), shih dhe 12a38; 330a35; *E të klenëtë tanë anshtë edhe mbë qiellt, qi edhe presmë shelbuosinë tanë Jezu Krishtnë, qi të na përtërinjë korpne e t përvutit tinë, përse të kthenjë si të klenë n korpit së lavdit ti* «Nostra autem conversatio in caelis est: unde etiam Salvatorem expectamus Dominum Jesum Christum: qui reformabit corpus humilitatis nostrae, configuratum corpori claritatis suae» (312a14 Filipasit 3,20-21); *e t apënë ndër duor të gjindsë, përse të qeshënë n si e përse ta mundonjënë, e përse ta venë mbë kryqt, e të tretënë ditë të ngjalletë* «et tradent eum gentibus ad deludendum et flagelandum et crucifigendum: et tertia die resurget» (342b6, 7, 8 Mateu 20, 19); shih edhe 298b35; *Priftënitë por banjinë me heshtunë përse ata të gjegjishnë ligjetë* «Silentium faciebant in populo ad audiendam legem» (298b32 Esdra II 8,7); shih edhe 84b41. Në një rast fjalisë qëllimore me lidhëzën *përse* të Buzukut i përgjigjet në tekstin latin një emër foljor me parafjalën *ad*: *E gjithë këto kafshë ishnë thanë si për shembëllësë, e janë shkruom përse na të mondonemi* «Haec autem omnia in figura contingebant illis: scripta sunt autem ad correptionem nostram» (286b27 Korintasit I 10,11).

Rreth njëzet e pesë herë fjalisë qëllimore të ndërtuar me *përse*

65) Për qëllimoret *përse* e *se* shih edhe E. Lafe, art. cit.

te Buzuku nuk i përgjigjet një e tillë në tekstin latin. Është me interes të shënohet se në disa prej këtyre shembëllave përkthimi gjermanisht i Luterit ka një fjali qëllimore: *Mos e kthe faqenë tande në meje, përse u të jem mbë shembëlltyrë t atyne qi venë ndë liqët* «Non avertas faciem tuam a me : et similis ero descendentibus in lacum» gjerm. *verbirg dein Antlitz nicht von mir, dass ich nicht gleich werde denen, die in die Grube fahren* (48a5 Psalm 142,7); *u t i banj gjellë të shishime tit et, porsì aj dëshëron; e t ja shpijesh e të hae, përse aj të të bekonjë parë se vdes* «ut faciam ex eis escas, patri tuo, quibus libenter vescitur; quas cum intuleris, et comederit, benedicat tibi priusquam moriatur» gjerm. . . . *auf dass er dich segne vor seinem Tode* (146a30 Gjenezë 27,9-10); *Ashtu edhe ju mbani vetëvetëhenë vdekunë për të vërtetë për katet, e përse të gjellini në Tenëzonë, për Krishtnë Jezu Zotnë tanë* «Ita et vos existimate vos mortuos quidem esse peccato, viventes autem Deo in Christo Jesu» (284a3 Romakët 6,11); shih edhe 46a36; 70b19; 92b17; 134a9-10, 38; 152b12 etj.

Siç shihet nga shembëllat e sjella më sipër, fjalia qëllimore e ndërtuar me lidhëzën *përse* është përgjithësisht postpozitive, por nuk mungojnë dhe raste ku ajo del si prepozitive, p.sh. *E u nukë e njohë; ma përse ti banë me u ditunë Israelit, prashtu u ershë me pagëzuom nd ujë* «Et ego nesciebam eum : sed ut manifestetur Israhel, propterea veni ego in aqua baptizans» (98b26 Gjoni 1,32); *E përse u mos madhështonem në këso së mëdhashit së pânash, m ashtë dhanë të munduomitë e mishit* «Et ne magnitudo revelationum extollat me, datus est mihi stimulus carnis meae» (108b23-4 Korintasit II 12,7) etj. Në këto dy shembëlla e në të tjerat Buzuku ka respektuar topikën e tekstit latin.

Folja-kallëzues e fjalisë qëllimore të ndërtuar me lidhëzën *përse* është kurdoherë në mënyrën lidhore.

*Shënim.* Fjala *përse* del te Buzuku edhe pesë herë të tjera jo si lidhëz, por si ndajfolje shkaku ose qëllimi me kuptimin «prandaj, për atë shkak, për atë qëllim». Së pari me këtë funksion atë e gjejmë në një nga ato pjesë të fillimit të librit që Buzuku i ka hartuar vetë: *E ata përse përkitetë mase a të munda sillnjë mb udhë të keqe* (68a2). Në një rast *përse* është përdorur me kuptimin e lat. *quare*: *E ju përse nukë ruoni ordhëninë e Tinëzot . . . ?* «Quare et vos transgredimini mandatum Dei . . . ? (156b40 Mateu 15,3). Në tri raste të tjera *përse*-së së Buzukut në tekstin latin i përgjigjet ndajfolja *ideo*. Të parën prej këtyre tri shembëllave e kemi te një pjesë nga Ekleziastiku, fillimi i së cilës nëpër mesharët paraqitet pak ndryshe nga pjesa përkatëse te Dhjata e vjetër: *Të bekuomitë e Tinëzot përmbi krye të t dërejët, përse Zotynë i dha reditatnë, e i bani pjesë në së dymbëdhjetë farësh* «Benedictio Domini super caput iusti. Ideo detit illi Dominus haereditatem, et divisit illi partem in tribubus duodecim» (348a21 Ekleziastiku 44,26). Në këtë shembëll ku *përse* shihet se është një ndajfolje, transkribimi i E. Çabejt duhej të kish ndjekur pikësimin e mesharëve, të cilët (ata që kemi pasur në dorë) pas *iusti* kanë pikë, duke e mbajtur fjalinë që nis me *Ideo* si të pavarur nga e para. Kjo pjesë del edhe dy herë të tjera më parë, duke pasur në vend të *përse* një **e prashtu** : *Të bekuomitë e Tinëzot përmbi krye të t dërejët e prashtu atë Zotynë i dha ereditatnë* (314b13); *Të bekuomitë . . . e prashtu i dhë atë Zotynë ereditatnë* (318a16).

Në dy shembëllat e tjera *përse*-ja e Buzukut i përgjigjet korrelatit

ndajfoljor *ideo* të lidhëzave *ut e quoniam*<sup>67</sup>. Edhe në tekstin shqip ajo bën pikërisht punën e këtij korrelati, por ky korrelat një herë del i barabartë me lidhëzën (sepse Buzuku *ut* e përkthen me *përse*), kurse herën tjetër mbetet jashtë ndonjë korrelacioni, për arsye se lidhëzën *quoniam* të tekstit latin autori ynë e ka përkthyer gabimisht me *e*: **Përse gjithë kafshëtë bānj për të zgjedhunitë, përse edhe ata të kenë të shelbuomitë qi anshtë ndë Krishtnë Jezu** «Ideo omnia sustineo propter electos, ut et ipsi salutem consequantur quae est in Christo Jesu» (358a33 Timoteu II 2,10); **Përse ata të përzānë regjēninē e bukurisē, kunorēnē e shpēnesēsē n̄ doret sē Tinēzot; e aj t i mbēlonjē me dorē të djathtë të tī** «Ideo accipient regnum decoris, et diadema speciei de manu Domini: quoniam dextera sua teget eos (362b13-4 Urta 5,17).

2) Lidhëza *se* del si qëllimore shtatëmbëdhjetë herë. Në tekstin latin asaj i përgjigjet lidhëza *ut*. Veçantia e kësaj lidhëze në krahasim me lidhëzën *përse* është se folja-kallëzues e fjalisë qëllimore të ndërtuar me të, mund të jetë jo vetëm në mënyrën lidhore (8 herë), por edhe në urdhëroren (1 herë), në dëshiroren (5 herë) e në paskajoren (1 herë). Në dy raste (134b43; 170a13) përkthimi është i pasaktë dhe prandaj ato nuk i kemi përfshirë në këtë statistikë. Shembuj: **E këta ju tue bām, Zotynë ka me shtuom ndër jū, se të korētë taj të nglatetë djerie n̄ sē vjelash, e të vjelētë, djerie n̄ sē mbjellash** («Pashënia» 386 rreshti 34); shih edhe 108b28; 204b40; 2426b11; 252a35; 266a14; 312b20; 380a14; **Ata, Zot, qi për dhunētije tande përzānē sakratē misteria, t̄y të lusmē se për të vërtetë për qish mēndyrē ata i përzānē, na ep për të vërtetë e ato me klenē** «Quos tantis, Domine, largiris uti mysteriis: quaesumus; ut effectibus nos eorum veraciter optare digne- ris» (102b15 Oratio); **N dhunētijet sē qiellet na tue pasunē të bekuomitē, t̄y tue t u lutunē, o i mujtuni Zot, t̄y lusmē: se këta nē n̄ sakramentashit kloftē me të vërtetë për shēndet** «Coelestis doni benedictione percepta, supplices te, Deus omnipotens, deprecamur: ut hoc idem nobis et sacramenti causa sit, et salutis» (114b44 Oratio); shih edhe 180b1; 194a16, 27; 250b2; **N̄ dhunētijet sē shelbuomit sit, Zot, na nginjē, na t̄y lusmē përvutē: se na ansosh sē bāmēsh na me klenē përtërīm, qi na ato tue përzānē gēzonemi** «Salutaris tui Domine, munere satiati, supplices exoramur: cujus laetamur gustu, renovemur effectu» (24a22 Oratio).

3) Lidhëza *qi* del 40 herë si qëllimore. Fjalisë qëllimore të ndërtuar me këtë lidhëz në tekstin latin i përgjigjet një fjali qëllimore me lidhëzën *ut* ose me kallëzuesin në mënyrën lidhore. Ashtu si fjalia qëllimore me lidhëzën *se*, edhe fjalia qëllimore me lidhëzën *qi* mund ta ketë foljen-kallëzues jo vetëm në mënyrën lidhore (18 herë), po edhe në dëshiroren (16 herë), në urdhëroren (2 herë) e në paskajoren (3 herë)<sup>68</sup>: **neve na ep hir, qi n̄ komemoracionet sē saj na të gēzonemi, për të përmishērieshimit lutunē n̄ kēsosh sē këqjash e n̄ mordjet sē jetēsē glatē na të jemi liberuom**» da, ut cujus commemoratione laetamur, ejus pia intercessione ab instantibus malis, et a morte perpetua liberemur» (30b29 Oratio); shih edhe 42a44; 62b11; 68b28; 70a39; 70b26; 82a11, 40; 82b1, 30, 39; 92b15 etj.

67) Shih: József Herman, *La formation du système roman des conjonctions de subordination*; Akademie-Verlag, Berlin, 1963, f. 99, 104.

68) Një rast ku *qi* është shtuar pa nevojë (70a12) nuk është përfshirë në këtë statistikë.

Në lutjen e faqes 10, kur e ka përsëritur një faqe më tej, Buzuku e ka ndërruar mënyrën e kallëzuesit të fjalisë qëllimore nga lidhore në dëshirore: *neve na ep hir, qi na qi bajmë komemoracionë e saj e gëzonemi për të përmishëriershimët d lutunë n kësosh së këqiash e n mordjet së jetësë glatë na klofshim liberuom* (32a4). Të tjera shembëlla fjalish qëllimore me kallëzues në dëshiroren: *Gjithë shenjtitë e tū, lusmë, Zot, qi për gjithë vend ata na ndimofshinë* «Omnes Sancti tui quaesumus Domine, nos ubique adjuvent» (12b29; 16a31; 22b34; 30a35 Oratio); *Neve na ban hīr, o i mujtuni Zot, qi t ardhunitë e festësë të Birit tit neve na dhashtë ndimënë e gjellësë të kësaj jete, e pagëtyrënë e jetësë amëshuome neve na dhashtë hīr nu me e pasunë* Praesta, quaesumus omnipotens Deus: ut Filii tui ventura solemnitās, et praesentis nobis vitae remedia conferat, et praemia aeterna concedat» (92b6 Oratio); shih edhe 16a13; 18b10; 30a17 etj. *Ty tue u lutunë të lusmë, o i mujtuni Zot, qi ata qi n sakramentashit së tūsh janë rekriuom, me të pëlqyeme arësenje edhe na ep hīr me të shërbyem* «Supplices te rogamus Omnipotens Deus: ut quos tuis reficis sacramentis, tibi etiam placitis moribus dignanter deservire concedas» (98b3 Oratio); *Ty tue t u lutunë, fort të lutemi, Zot i mujtunë: qi ata qi përtërīm janë me sakramentat të tū, tū edhe me të pëlqyeme të bame me të shërbyem ya ep* «Supplices te rogamus, omnipotens Deum, ut quos tuis reficis sacramentis, tibi etiam placitis moribus dignanter deservire concedas» (110a33 Oratio); *Zot, ti qi trajtove farësë ymane pagëtyrë n së shëlbuomit së jetësë glatë, për virgjinitatit të zonjësë shenë Mëri, tū të lusmë, neve të na bajnsh hie, qi ajo për nē u lutë, qi për të merituom me pasunë tenë Zonë bāsinë e korpit tinë, Jezu Krishtnë Birë tand* Deus, qui salutis aeternae, beatae Mariae virginitate secunda, humano generi praemia praestitisti: tribue quaesumus, ut ipsam pro nobis intercedere sentiamus, per quam meruimus auctorem vitae suspicere, Dominum nostrum Jesum Christum Filium tuum (18b11 Oratio).

Duhet shënuar se fjalitë qëllimore me lidhëzat *se* e *qi* që e kanë kallëzuesin në dëshirore, urdhërore e paskajore, dalin vetëm nëpër lutjet e në ndonjë psalm, po jo nëpër copat e ungjijve. Duke gjykuar pas këtij fakti, përdorimi i mënyrave të mësipërme të foljes-kallëzues del si diçka e veçantë për stilin afektiv të lutjeve<sup>69</sup> dhe ka të ngjarë që t'i detyrohet praktikës kishtarë të atëhershme, të cilën Buzuku duhet ta ketë pasur parasysh në përkthimin e tij.

Veç 40 rasteve të përmendura më lart ka te Buzuku edhe një rast tjetër ku *qi* mund të merret më fort si lidhëz qëllimore, sadoqë pas origjinalit latin del të jetë një përemër lidhor: «*E pritnë një ditë të ngaeshime qi të munda vgjanjënë vetëmë*» «Et tunc in communi statuerunt tempus, quando eam possent invenire solam» (164a28 Danieli 13,15).

4) Një lidhëz qëllimore e veçantë e Buzukut është *tekë*, e cila del vetëm dy herë<sup>70</sup>: *E mbë gjithë visë o ndë varosh o ndë katund o ndë qytet*

69) Nga pikëpamja psikologjike këtu ka ndodhur shndrimi i një qëllimi në një dëshirë dhe kjo gjuhësisht është shprehur me zëvendësimin e lidhores nga dëshirorja.

70) Kjo fjalë del edhe dy herë të tjera: me kuptimin e lat. *saltem* në 348b14. Punët 5,15 dhe të lat. *tantum* 384b4-5 Jobi 1,12, pra jo si lidhëz. Shih më me hollësi E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXI* «Studime filologjike» nr. 2, 1966 f. 62.

vinjinë të sëmunitë ndë pjacat, e atī lutishnë, tekë të mundë i përkisnë fontë e petëkut tī «Et quocumque introibat, in vicis vel in villas, aut in civitates, in plateis ponebant infirmos, et deprecabantur eum, ut vel fimbriam vestimenti eius tangerent» (120a8 Marku 6,56); *E Filipi ju përgjegj: Nukë t u mbastonjë bukë për dyqind denarë tekë gjithëkush të marë k̄a pak* «Respondit ei Philippus: Ducentorum denariorum panes non sufficiunt eis, ut unusquisque modicum quid accipiat» (188b33 Gjoni 6,7).

5) Lokucioni *ashtu qi*, që e pamë më lart te lidhëzat rrjedhimore, del edhe me kuptim qëllimor. Katër raste të tilla i kemi në përkthimin e lutjes *Omnes Sancti tui* (e cila përsëritet tri herë me disa ndryshime të vogla), ku në tekstin latin ka një *ut* qëllimore: *Gjithë shenjtitë e tū lusmë, Zot, qi për gjithë vend ata na ndimofshinë: ashtu qi përherë qi ato neve kur na raftë ndë mend për meritat të tyne, na ndjefshim ndimënë e tyne* «Omnes Sancti tui, quaesumus Domine, nos ubique adjuvent: ut dum eorum merita recolimus: patrocina sentiamus» (12b31, khs. edhe 16a33; 22b36; 30a37).

*Pjesëza a si lidhëz ffilluese e qëllimore.* Te Gjon Buzuku pjesëza pyetëse *a* në disa fjali qëllimore ose kundrinore i është ngjitur pjesëzës të të lidhores duke dhënë një *a* të ose *a ta* (< *a* të + trajtën e shkurtër përemërore *e*), të cilat Buzuku i shkruan si një fjalë. Në transkribimin e E. Çabejt këto dy pjesëza janë shkruar gjithashtu bashkë për t'u dalluar nga rastet kur *a*-ja si pjesëz pyetëse ndiqet nga të-ja e lidhores<sup>71</sup>, megjithëse kështu mund të ngatërrohen me përemrat *atë, ata*. A ka ndonjë funksion lidhëzor kjo pjesëz *a* në bashkimet e mësipërme *a të e a ta*? Për t'iu përgjegjur kësaj pyetjeje le të analizojmë të dymbëdhjetë shembëllat përkatëse që kemi mundur të gjejmë në gjithë tekstin. Në shtatë prej këtyre shembëllave *a të* ose *a ta* i përkasin një fjalie qëllimore të ndërtuar me lidhëzën *përse*: *Ju të dini se k̄y lypën kun ndonjë faj të më vgjān, përse a të më vin kondra* «animadvertite, et videte quod occasiones quaerat adversum me» (152b12 Mbretërit IV 5,7); *ma u duo të vete përse a ta nqonj n gjumit*» sed vado ut a somno exsuscitem eum» 182a20 Gjoni 11,11); shih edhe 142a25; 160a23; 166b37; 188b9; 190a19. Në shembëllat e mësipërme pjesëza *a* nuk ka ndonjë funksion sintaktik, sepse lidhjen e fjalisë së varur me kryesoren e kryen *përse*-ja. Pjesëza *a* edhe mund të mungojë, pa e ndryshuar aspak kuptimin e periudhës. Nuk ka funksion lidhëzor kjo *a* as në dy shembëlla të tjera kur është përdorur me një fjali kundrinore: *e thashë dishipujet tuve ata a ta qisnë jashtë* «et dixi discipulis tuis ut eicerent illum» (300a13 Marku 9,17); *Përse askush nukë ban kun gjākafshë nde e n̄shehunë, por lypën a ta ban gjithëkush ta dij me klenë ditunë n̄ shekullit* «Nemo quippe in occulto aliquid facti et quaerit ipse in palam esse: si haec facis, manifesta te ipsum mundo» (190b24 Gjoni 7,4). Te e para nga këto fjali kundrinore duhet një lidhëz, por përpara e jo pas kryefjalës *ata*, ndërsa te fjalja e dytë lidhëza nuk është e domosdoshme.

Ndryshe qëndron puna në tri shembëllat e mëposhtme, ku kjo pjesëz është përdorur para foljes *mund*. As te Buzuku, as në gjuhën e sotme një fjali e varur qëllimore ose kundrinore me foljen modale

71) «Meshari» i Gjon Buzukut (1555), botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa e parë, Tiranë 1968, f. 99; shih edhe po prej tij *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe I* (në shtyp) fjalët *atë, ata*.

*mund* në mënyrën lidhore si pjesë të parë të kallëzuesit, nuk lidhet dot asindetikisht me fjalinë kryesore. Për këto arsye te këto shembëlla pjesëza *a* është bërë në të vërtetë një lidhëz: *E ata përse përkitetë mase a të munda sillnjë mb udhë të keqe* (68a3)<sup>72</sup> e por kërkonjinë **a të munda shtinjinë mbrenda** «et quaerebant eum inferre» (270a31 Luka 5,18); e *erdh a të mundë mer. frujt n si* «et venit quaerens fructum in illa» (304b10 Luka 13,6). Te shembëlla e parë dhe te e treta fjalia e varur është qëllimore, kurse te e dyta kundrinore.

Shembëlla të tilla të përdorimit të *a*-së para lidhores dalin edhe te autorë të mëvonshëm, khs. p.sh. *Aty Apostujitë tue u dhimtunë iu lutnë Krishtit a ta ngushëllonte* Bogdani II 69,19<sup>73</sup>.

## 8. Lidhëzat lejore

Kjo kategori lidhëzash te Gjon Buzuku përfaqësohet nga lokucionet *mirë se* e *mirë se në*.

Lokucioni *mirë se*<sup>74</sup> del gjashtë herë: tri herë në disa pjesë të Ritualit, të hartuara nga vetë Buzuku, e tri herë në copa ungjilli, të cilat ndonjëherë largohen mjaft nga origjinali, p.sh. *Mos vidh; mos grabit; kanë me mos ngënnyem as për ndonjë udhë: mos tue tregëtuom, mos tue blenë, mos tue shitunë e mā fort kon një të vobeg. Mirë se ligjeja thotë: mos të vobeg, mos të begatë* (62a34 Rituali); *E në duhetë me u lëvduom, mirë se muo gjā ndimë nukë më ep lavdi, ershë mbe e pnat e mbe e njehunat të Tinëzot.* «Si gloriari oportet, non expedit quidem; veniam autem ad visiones et revelationes Domini» (108b5 Korintasit II 12,1); *E të parëtë e priftënet e pleqtë e gjithë të mbëljedhunitë por lypnjinë dëshminj të rëshim kondra Jezut, përse ta banjinë me vdekunë; e nukë mundë vgjanjinë, mirë se shumë gjindishnë»* Principes autem sacerdotum et omne concilium quaerebant falsum testimonium contra Jesum, ut eum mortis tradent: et non invenerunt cum multi falsi testes accessissent» (206b4 Mateu 26,59-60); shih edhe 60b45; 64b40; 188a7.

Fjalitë lejore të ndërtuara me lidhëzën *mirë se* janë fjali të realitetit, sepse në to kushti që duhej të kishte si pasojë të kundërtën e asaj që thuhet në fjalinë kryesore, paraqitet si real, si ekzistues. Në katër nga gjashtë shembëllat e përmendura fjalia lejore është postpozitive dhe në dy prepozitive.

Me lokucionin *mirë se në*, i cili del katër herë, ndërtohen fjali lejore hipotetike (d.m.th. në to kushti që do të pengonte realizimin e asaj që thuhet në fjalinë kryesore nuk jepet si real, po si i mundshëm). Këtë karakter hipotetik e jep lidhëza kushtore *në*.

Në tekstin latin këtij lokucioni dy herë i përgjigjet *et si*: *E u perggjegj Jezu e tha: E mirë se u në dëshmonj për vetëvetëhenë, të dë-*

72) Te kjo shembëll *përse* nuk është lidhëz, por ndajfolje qëllimi (shih më lart f. 144).

73) Nga sa u shtjellua më sipër, ndryshe nga E. Çabej (*vep. cit., po aty*) besojmë se te të gjitha shembëllat në fjalë, vetëm pjesëza *a* duhet marrë si lidhëz, pra jo bashkë me *të*-në ose *ta*-në ( *të* + *e*) trajtëformuese të lidhores, dhe prandaj do të ishte më drejt që këto fjalë të shkruheshin veç e veç: *a të*, *a ta*. Për këtë arsye, vetëm në këtë rast i jemi larguar transkribimit të E. Çabejt.

74) Shih për këtë lidhëz «Meshari» i Gjon Buzukut (1955) botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa e parë, Tiranë 1968, f. 98.

*shmuomitë tem anshtë të vërtetë* «Respondit Jesus, et dixit eis: Et si ego testimonium perhibeo de me ipso, verum est testimonium meum (184b28 Gjoni 8,14); **E mirë se në u gjetë kun e pāligjeja për të dërejtë, atëhere ju t ini lum** «Sed et si quid patimini propter iustitiam, beati» (282a29 Pjetri I 3,14). Në dy raste të tjera Buzuku është larguar nga teksti latin: *Eni e kujtonemi kondra Jeremisë të kujtuom, si të munda nvrasmë, përse ligja nukë mundë bdirëtë, mirë se në mos paçim prift, as kshilli n s urtësh, as fjala e profecisë për punë n priftënish* «Venite et cogitemus contra Jeremiam cogitationes: non enim peribit lex a sacerdote, neque consilium a sapiente, nec sermo a propheta» (198a26 Jeremia 18,18); *përse të provuomitë e fesë saj të jetë mā e pāçmuome se ari, qi edhe mirë se n ashtë përvuom ndë zjarm, e por bdirëtë* «ut probatio vestrae fidei multo pretiosior sit auro, quod per ignem probatur» (366a23 Pjetri I 1,7); për këtë shembëll edhe Kristo-foridhi ka: «*qi të gjindetë p̄rovimi i besësë tuej ma i çimueshim se ari qi prishetë, ndonëse provohetë prej zjarrmit*».

Në tri nga katër shembëllat e mësipërme fjalia lejore është prepozitive e në një postpozitive.

## 9. Lidhëzat krahasore

Lidhëzat krahasore të thjeshtat *sā, se, si*, prej të cilave janë formuar një tok lidhëzash të përngjitura, i gjejmë që te Gjon Buzuku. Nga lidhëzat krahasore të përngjitura ky autor ka vetëm *kinëse* e *porsi*. Krahas *kinëse* është përdorur një herë si lidhëz edhe *kini*, që s'është tjetër veçse trajta e shumësit të urdhërores së foljes *kam*. Te Buzuku gjejmë edhe një lokucion krahasor interesant *porsi në*, që nuk përdoret në gjuhën e sotme.

### *Lidhëza të thjeshta*

1) Lidhëza krahasore *sā*, me *a* të gjatë, del te Buzuku vetëm pesë herë: një herë me një plotës krahasimi dhe katër herë me fjali të varur krahasore: *e këto oratë thuhënë aqë përm̄bī djalë sā përm̄bī vajzë* (72a5 Rituali); *U flas sā mundë njoh për fisi* «Secundum ignobilitatem dico» (108a8 Korintasit II 11, 21); *sā mā d madhit tit ata të jenë ndë hir, aqë n dhuntëtijeshit ata klofshinë shumuom* «quanto majestati tuae fit gratior, tanto donis potioribus augeatur» (198a17 Oratio); *Sā janë qielltë n dheut të nalta, aqë janë udhëtë e mi n suojshtit, e të kujtuometë e mī se tuojtë* «Quia sicut exaltantur coeli a terra, sic exaltatae sunt viae meae a viis vestris, et cogitationes meae a cogitationibus vestris» it. «Perchè quanto il cielo sovrasta alla terra, tanto la mia condotta è superiore alla vostra, e i pensieri miei ai vostri» (234b31 Isaia 55,9). *E sā mā fort aj u tho, ata aqë mā fort uinjinë tue predikuom* «Quanto autem eis praecipiebat, tanto magis plus paraedicabant» (290a39 Marku 7,36).

Nga shembëllat e sjella shihet se fjalia e varur mund të jetë prepozitive ose postpozitive. Te shembëllat me prepozicion lidhëza *sā* e fjalisë së varur ka si korrelat në fjalinë kryesore ndajfoljen *aqë*, dhe ky korrelacion *sā ... aqë* i përgjigjet korrelacionit latin *quanto ... tanto*.

2) Lidhëza *se del te Buzuku* 90 herë, nga këto 17 herë e përdorur në fjali krahasore dhe 73 herë me plotës krahasimi. Në tekstin latin asaj i përgjigjet zakonisht lidhëza *quam* ose një ablativus comparisonis.

Fjalitë krahasore me lidhëzën *se* i referohen zakonisht një gjymtyre të fjalisë kryesore, të shprehur me një mbiemër ose ndajfolje në shkallën krahasore, p.sh. *Ashtu atëherë vete e mer me vetëhenë shtatë të tjera shpirtëna, mā të këqī se anshtë vetë* «Et tunc vadit et adsumit septem alios spiritus neqviores se» (150b44 Luka 11,26); *e aj të mos u lanë ju me hīm nde e tentuom mā se ju mundë bani* «qui non patietur vos temptari super id quod potestis» (286b33 Korintasit I 10,13); shih edhe 64a21, 28; 64b8, 10, 36, 39; 66b3; 68a40; 98a5; 150b31; 296a31 etj.

Fjalja krahasore me lidhëzën *se* është kurdoherë postpozitive.

Plotësi i krahasimit me lidhëzën *se* në shumicën e rasteve del kur në tekstin latin ka një krahasim sipërie, p.sh. *Përse tash u afëruo të shelbuomitë tanë, mā se atëherë ku besuom* «Nunc emim prior est nostra salus, quam cum credimus» (84a18 Romanët 13,11); *E u juve thom se mā se profeta anshtë* «Etiam dico vobis, et plus quam prophetam» (86a37 Mateu 11,9); *Ati anshtë mā i madh se u* «Pater maior me est» (264b18 Gjoni 14,28) etj. Veç shembëllave të tipit të mësipërm, lidhëzën *se* me ndajfoljen *mā* e mbiemrin *i mirë* Buzuku e ka përdorur edhe për të përkthyer mbiemrin *perfectus*: *ata qi anshtë mā se të mirë* «quod perfectum est» (110b29 Korintasit I 13,10), *për mā të madh e mā se i mirë tabernakullë* «per amplius et perfectius tabernaculum» (186a29 Hebreasit 9,11); *popullinë e mirë e mā se të mirë* «plebem perfectam» (328a6 Luka 1,17). Te shembëlla e fundit ka një lloj përsëritjeje që ka vlerën e sipërores. Një tjetër shembëll e tillë del nëntë faqe më parë: *karitati uij të shumonetë mirë e mā se mirë* «caritas vestra magis ac magis abundet» (310b9 Filipasit 1,9).

3) Lidhëza krahasore *si*, e cila shërben për të shprehur një krahasim me karakter cilësor, del te Gjoni Buzuku 84 herë. Ajo shërben:

a) Për të lidhur një fjali të varur mënyrore ose krahasore me fjalinë drejtuese të saj. Me këtë funksion lidhëza *si* është përdorur 70 herë. Në tekstin latin në këto raste asaj i përgjigjen zakonisht ndajfoljet *sic, sicut*, e ndonjëherë lidhëza *ut*. Në 27 shembëlla lidhëza *si* ka si korrelat në fjalinë kryesore ndajfoljen *ashtu*. Këtij korrelacioni *si...ashtu* në tekstin latin i përgjigjet zakonisht korrelacioni *sicut...ita* ose *sicut...sic*, p.sh; *E tue votë dishipujtë banë si atyne ordhënoi Jezu* «Euntes autem discipuli, fecerunt sicut praecepit illis Jesus (202a30 Mateu 21,6); *ecëni e ruoni si dini ju, ite, custodite sicut scitis*» (210b43 Mateu 27,65); *U bana si ti më ordhënove* «factum est ut imperasti» (278a19 Luka 14,22); *gjithëkuj t apë pagëtyrënë si të ketë bām* «reddet uniuque secundum opus eius» (360a5 Mateu 27,65); *përse si aj anshtë, e na jemi mbë këtë shekullë* «quia sicut ille est, et nos sumus in hoc mundo» (274b32 Gjoni I 4,17) etj.

*Si janë shëgjetëtë ndë dorë të d mujtunit Zot, ashtu janë bijtë e profetëvet apostoj* «Sicut sagittae in manu potentis: ita filii excusorum» (22a19; 24b33 Psalm 126,4); *Si Krishti ndjeu juve, ashtu edhe ju ndijeni* «sicut et dominus donavit vobis, ita et vos» (104a41 Kolasasit 3,13); *e si më ordhënoi Ati, ashtu banj* «et sicut mandatum dedit mihi Pater, sic facio» (264b25 Gjoni 14,31) etj.

Siç shihet edhe nga shembëllat e mësipërme, kur lidhëza *si* ka si korrelat në fjalinë kryesore ndajfoljen *ashtu*, fjalia mënyrore, njësoj si në tekstin latin, është prepozitive. Vetëm në një rast ajo del si postpozitive ndaj një fjalie kryesore mungesore: *E ashtu, Atë; si t̄y kle nde e p̄lqyem* «Ita Pater, quoniam sic fuit placitum ante te» (368b36 Mateu 11,26). Ndër 43 shembëllat e tjera pa korrelat, 34 herë fjalia mënyrore a krahasore me lidhëzën *si* është postpozitive e 9 herë prepozitive.

b) Për të ndërtuar një plotës mënyre. Me këtë funksion lidhëza *si* është përdorur 6 herë, p.sh. *Ju gjukoni si për zakon ̄ mishi e u nukë gjukonj kana* «Vos secundum carnem iudicatis: ego non iudico quemquam (184b33 Gjoni 8,15); *E gjithë këto kafshë ishnë dhanë si për shembëllesë* «Haec autem omnia in figura contingebant illis» (286b26 Korintasti I 10,11). shih edhe 168b8; 290b7; 312a14; 372a45.

c) Lidhëza *si* del në 4 raste edhe me një kallëzues emëror: *Të kujtuometë e m̄i nukë janë si tuojtë, as udhëtë tuoj nukë janë si të m̄itë* «Non enim cogitationes meae, cogitationes vestrae: neque viae vestrae, viae meae» (234b30, 31 Isaia 55,8); shih edhe 124b2; 254b45.

ç) Në 4 raste të tjera lidhëza *si* del edhe me një plotës predikativ: *E ata n̄ierëz qi me të ishnë m̄be e ecunit, si të marë ̄ banë* «Viri autem illi qui comitabantur cum eo, stabant stupefacti» (320a1 Punët 9,7); *Këta janë ata qi na kishnjim për të qeshunë, e si për befë e për dhunë* «Hi sunt, quos habuimus a aliquando in derisum, et in similitudinem improperii (362a4 Urta 5,3), shih edhe 64a19; 284a37.

*Shënim:* Ka te Gjon Buzuku gjithësej tetë shembëlla ku *si* del si ndajfolje lidhore. Fjalia e varur, e prirë nga kjo fjalë lidhëse, shtjellon, përcakton kuptimin e një gjymtyre emërore të fjalisë kryesore: *e muo të më bijësh cihariq, si shkon kafsha* «et renuncia mihi quid agatur» (144a13 Gjenezja 37,14); *e banë kshill ndër vetëhenë si të mundë zinjinë Jezunë* «et consilium fecerunt ut Jesum dolo tenerent, et occiderent» (202b27 Mateu 26,4); *E tho atyne qi ishnë grishunë një shembëlltyrë, ata si të zgjidhnjinë kryetë e tryesëvet* «Dicebat autem ad invitatos parabolam, intendens quomodo primos accubitus eligerent» (296b14 Luka 14,7); shih edhe 68b3; 198a25; 204a13; 310b22; 238b4.

### Lidhëza të përngjitura

1) Lidhëza e përngjitur *kinëse* është një nga ato fjalë që kanë dalë prej fjalish: *kinë* është urdhërorja *kini*, te e cila *i*-ja e pathek-suar është ndërruar në *ë*<sup>75</sup>. Kjo lidhëz del te Buzuku dy herë: *E kush nukë le me shkuom fjala e njaj plaku për të dërejtë ndaj të, kinëse aj k̄a e aj s k̄a* (64a23 Rituali); *tue mos u b̄am kinëse di kafshë të mëdh̄a, ma kushtou t p̄rvutet* «non alta sapiens, sed humilibus consentientes» (100a40 Romanët 12,16).

Është me interes të shënohet për mënyrën e formimit dhe kronologjinë e kësaj lidhëze se Buzuku në një rast ka përdorur vetëm trajtën *kini* të urdhërores me kuptimin *kinëse*: *bani kini nukë e sheh* «pertransiit» (292a8 Luka 10,32).

2) Lidhëza *porsi* del të Gjon Buzuku 539 herë. Ajo është sinonime me lidhëzën e thjeshtë krahasore *si*, por, duke qenë e përngjitur me

75) Shih: E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XII*, «Studime filologjike», XVIII (I) 1964 nr. 1 f. 68.

një pjesëz përforcuese, e jep më qartë idenë e identitetit ose të ngjashmërisë së madhe midis mënyrës së veprimit që shpreh fjalia e varur dhe mënyrës së veprimit që shpreh kryesorja.

Lidhëza *porsi* përdoret:

a) Me një fjali mënyrore ose krahasore 147 herë. Kuptimi i mënyrës në këtë rast del nga krahasimi i veprimit të fjalisë kryesore me veprimin e fjalisë së varur. Në tekstin latin lidhëzës *porsi* të këtyre fjalive i përgjigjet zakonisht ndajfolja *sicut* e në disa raste të rralla *quemadmodum*, *tamquam* ose lidhëzat *ut*, *prout*, *quasi*, p.sh. *Zot, kthe të zanëtë tanë, porsi kthenetë torenti ndë mjesëditët* «*Converte, Domine, captivitatem nostram, sicut torrens in Austro* (20b45 Psalm 125,4); *mos jesmë të dëshëruom n kafshëshit së këqia, porsi janë shumë* «*nun simus concupiscentes malorum, sicut et illi concupierunt*» (286b14 Korintasit I 10,6); *bani zemëratë tuoj të lëshonjënë dritë, porsi e lëshon luqerra ndë t errëtit* «*cui benefactis attendentes quasi lucernae lucenti in caliginoso loco*» (336b22 Pjetri II 1,19) etj. Në disa raste Buzuku ka përkthyer me një fjali mënyrore me lidhëzën *porsi* një emër me parafjalët *iuxta* ose *secundum* të tekstit latin: *E vote e bani porsi e ordhënoi Illi* «*Quae abiit, et fecit iuxta verbum Eliae*» (138a13 Mbretërit I 17,15); *Lësho mā tash shërbëtuorë tand, Zot, n paq, porsi kle thanë fjala jote* «*Nunc dimittis servum tuum, Domine, secundum verbum tuum in pace*» (28b42 Luka 2,29) etj. Në të gjitha shembëllat e kësaj kategorie fjalia e varur mënyrore vjen pas kryesores.

Në 17 raste lidhëza *porsi* ka si korrelat në fjalinë kryesore ndajfoljen *ashtu*. Ky korrelacion *porsi...ashtu* thekson ngjashmërinë e madhe ose identitetin e mënyrës së veprimit të fjalisë së varur me mënyrën e veprimit të kryesores. Në tekstin latin korrelacionit *porsi...ashtu* të Buzukut i përgjigjen *quomodo...sic, quomodo...ita, sicut...sic, sicut...ita*: *E porsi përpara faqesë tyne u santifikove ndë nē, ashtu përpara faqesë sanë të jësh madhështuom n sish* «*Sicut enim in conspectu eorum sanctificatus es in nobis, sic in conspectu nostro magnificaberis in eis* (134a2 Ekleziastiku 36,4); *porsi Krishti u ngjall n mordjet për lavdit të t Et, ashtu edhe na ecnjëmë ndë gjellë të rē për të* «*quomodo surrexit Christus a mortuis per gloriam Patris, ita et nos in novitate vitae ambulemus*» (282b28 Romanët 6,4); shih edhe 12b12; 114b38; 124b6; 216b1 etj. Fjalia mënyrore është në këto raste zakonisht prepozitive. Ka vetëm tri shembëlla ku ajo del si postpozitive dhe në një prej tyre vjen fill pas ndajfoljes korrelat *ashtu*: *e ashtu e gjetnë porsi gratë thanë kishnë* «*et ita invenerunt sicut mulieres dicerunt*» (242a15 Luka 24,24), shih dhe 312a2; *mā mos gjellinjë kush ashtu porsi anshtë dëshiri i nierëzet, por si anshtë vullundedja e Tinëzot* «*ut iam non hominum desiderio sed voluntate Dei quod reliquum est in carne vivat temporis*» (366a30 Pjetri I 4,2). Ka vetëm një shembëll te Buzuku, ku ndajfolja korrelat *ashtu* është shkëputur nga fjalia kryesore duke formuar me lidhëzën *porsi* një si lokucion lidhëzor *ashtu porsi*: *ashtu porsi dërgove Engjëllinë shenjt tand Rafaelnë tek Tobia e tek Sara e bia e Raguelit, edhe këtyre, Zot, ti të denjonesh me dërguom të bekuomitë tat* (82b30).

Kuptimi mënyror i fjalive me lidhëzën *porsi* del nga krahasimi i dy veprimeve, që bëhet nëpërmjet kësaj lidhëze. Ndërkaq ky krahasim mund të paraqitet si real ose si ireal. Kjo varet nga mënyra dhe koha e foljes-kallëzues të fjalisë mënyrore. Te Gjon Buzuku fjalitë mënyrore në bazë të të cilave qëndron një krahasim real.

përbëjnë shumicën dërmuese të fjalive mënyrore me lidhëzën *porsi*. Folja-kallëzues e këtyre fjalive është zakonisht në një nga format e së shkuarës (e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer, e kryer e plotë, e kryer e tejshkuar) të dëftores, fare rrallë në të tashmen dhe vetëm dy herë në të tashmen e lidhore në periudhën që pason: *por ata porsi dëshiri të i hjekë, kanë me gjetunë e me mbëljedhunë mjeshtra të rëshim, qi t u apënë të pëlqem porsi ata të duonë* «sed ad sua desideria coaceruabunt sibi magistros, prurientes auribus» (370a18,20 Timoteu II 4,3).

Fjalitë krahasore irrealë me lidhëzën *porsi* janë të paka te Buzuku. Folja-kallëzues e tyre është në të pakryerën ose në të kryerën e lidhore dhe vetëm një herë në të pakryerën e lidhore-habitores: *ata kanë me e përzanë fëdigënë e tyne porsi të jenë fëdigunë* «recepterunt mercedem suam» (112b41 Mateu 6,16); *U ashtu rjedh, jo porsi të mos jeshë segūr* «Ego igitur sic curro, non quasi in incertum» (106a11 Korintasit I 9,26); *e na e mbajtim porsi të klenëkë plot plagë* «et nos putavimus eum quasi leprosum» (214b39 Isaia 53,4); shih edhe 108a9; 120b20; 376b8, 9.

b) Lidhëzën *porsi* e gjejmë dy herë edhe me fjali kallëzuesore në përkthimin e një paragrafi nga Ungjilli i Lukës që përsëritet në një mënyrë joidentike: *kloftë muo porsi ti thuo; muo kloftë porsi anshtë fjala jote* «fiat mihi secundum verbum tuum» (32b44; 90a5 Luka 1,38).

c) Njëqind e pesëdhjetë e shtatë herë lidhëza *porsi* del me fjali përcaktore. Në këtë numër njëqind e pesëdhjetë e dy shembëlla janë të tipit: *Të zanëtë e nfill të Ungjillit shenjtë porsi shkruon (shkrou) Matheu (Marku, Luka, Gjoni), të cilave në tekstin latin u përgjigjet formula Sequentia sancti Evangelii secundum Matheum (Marcum, Lucam, Iohannem).*

Te fjalia kryesore e kësaj formule të Buzukut duhet nënkuptuar kryefjala (përemri dëftor asnjans *këta*) dhe këpuja e kallëzuesit emëror (*anshtë*). Si shembëlla të tjera fjalish përcaktore me lidhëzën *porsi* po përmendim: *E bani e ama e tī gjellë t amblë, porsi dëshir i ati i tī kish* «Paravit illa cibos, sicut velle noverat patrem illius» (146a41 Gjenezja 27, 14); *Për të vërtetë ju mundë dini të klenëtë tem porsi kleshë n pari, kur jeshë ndër Xhudhūt* «Audistis enim conversationem meam aliquando in Iudaismo» (332a6 Galatasit 1,13); shih edhe 226a44; 226b3, 35, 38.

4) Në pak raste lidhëza *porsi* del edhe me fjali kufizore *Krishti vdiq për katetë tonë, porsi thonë të Shkruometë* «Christus mortuus est pro peccatis nostris secundum scripturas» (290a5 Korintasit I 15,3); *Zoti ynë Jezu Krishti n faret së Davidit u ngjall n mordjet, porsi thotë Ungjilli em, qi u punonj* «Memor esto Jesum Christum resurrexisse a mortuis ex semine David, secundum evangelium meum in quo laboro» (358a30 Timoteu II 2,8-9) etj.

d) Lidhëza *porsi*, si të gjitha lidhëzat krahasore, shërben për të lidhur jo vetëm dy fjali, por edhe dy gjymtyrë fjalie. Me këtë funksion ajo del 229 herë. Atë e gjejmë në radhë të parë me plotësinë e krahasimit e të mënyrës. Krahasimi i shprehur me anë të kësaj lidhëze ka karakter cilësor, por në të parën nga shembëllat që po rendisim Buzuku e ka përdorur edhe në një krahasim me karakter sasior: *E bukurë e e mirë formuom, o bija e Jeruzalemit, e aqë e madhe porsi ushtëria qi anshtë trajtuom për luftë* «Pulchra es, et decora filia

Jerusalem: *terribilis ut castrorum acies ordinata*» (22b2 Antifona); *Kur u jeshë i vogëlë, porsì të vogjëlitë flasë, porsì i vogëlë gjegjeshë, porsì i vogëlë kujtonje* «Cum essem parvulus, loquebar ut parvulus, sapiebam ut parvulus, cogitabam ut parvulus» (110b31-2, 32, 33 Korintasit I 13,11) *e jo ta dij gjithëkush, ma porsì njshehunë* «non manifeste, sed quasi in occulto» (190b41 Gjoni 7,10); *Ju duoltë porsì mbë një kusar, me armë e me tojaga* «Tamquam ad latronem existis, cum gladiis et fustibus (206a31 Mateu 26,55); *mbë këtë mëndyrë anshtë i dashuni em, porsì kaprolli o mangy i sutësë* «similis est dilectus meus capreae, hinnuloque cervorum» (332a36); *E aty ndërroi fytyrënë . . . . tue zditunë porsì dielli; e petëkatë e tì y banë porsì bdora* «Et transfigurantus est. . . . et resplenduit facies eius sicut sol: vestimenta autem eius facta sunt alba sicut nix» (336b39, 40 Mateu 17,2) etj.

Në pak raste lidhëza *porsì* del edhe me një kallëzues emëror ose në një plotësor predikativ: *aj tÿ të të jetë porsì nierë i publikuom* «Sit tibi sicut ethnicus et publicanus» (156a5 Mateu 18,17); *e të jetë porsì ullini lavdi i tì, e era e tì porsì e Libanit* «et erit quasi oliva gloria eius: et odor eius ut Libani» (300b25, 25-6 Osea 14,7); shih edhe 320b27, 28 etj;

*E y bëshë porsì nieriy qi nukë gjegjetë, e porsì aj qi nukë kã ndë gojë të tì të përgjegjunë* «Et factus sum sicut homo non audiens: et non habens in ore suo redargutiones» (42b43-4, 44 Psalm 37,15); *na y bãm porsì plehëtë e fshitë të këtë shekulli* «tamquam pargamenta huius mundi facti sumus» (350a12 Korintasit I 4,13); shih edhe 20b38; 44b45; 46a1, 2; 214b33, 35, 36; 344b25.

#### Lidhëza lokucione

I vetmi lokucion lidhëzor krahasor që del te Buzuku është *porsì në*. Ky lokucion, që del vetëm shtatë herë, përdoret me fjali krahasore irrealë. Ai shërben për të karakterizuar një veprim nëpërmjet një krahasimi të supozuar me ato kushte, në të cilat do të mund të vëreheshin dukuri analoge, dhe në elementet e këtij lokucioni janë shprehur si krahasimi (*porsì*) ashtu dhe kushti (*në*). Folja kallëzues e fjalisë së varur me lokucionin *porsì në* del vetëm në të pakryerën e në të kryerën e plotë të dëftores dhe vetëm një herë në një trajtë që nga ndërtimi duket si e tashme e habitores, po ka vlerën e së pakryerës së dëftores. Ja disa shembëlla: *E sana e fushësë qi sod anshtë e nesëret vete gjithë nde e djegunë, porsì në ish klenë ndë furët* «Si autem faenum agri, quod hodie est et cras in dibanum mittitur» (294b5 Mateu 6,30); *Nd ato dit u mbëlodhnë popullia m Jeruzalem, porsì në klenëkë një nierë* «Congregatusque est omnis populus quasi vir unus» (298b6 Esdra II 8,1); *Moti anshtë i shkurtënë: ata qi kanë grã, porsì në mos i kishnë, . . . . ata qi kanë porsì në mos kishnë, ata qi kanë të pëlqyem mbë këtë shekullë, porsì në mos e kishnë* «tempus breve est: reliquum est, ut, qui habet uxores, tamquam non habentes sint. . . . et qui emunt, tamquam non possidentes: et qui utuntur hoc mundo, tamquam non utantur» (376b7, 10, 12 Korintasit I 7, 29-31); shih edhe 120b15; 254a19.

\* \* \*

Nga ky punim, që i kushtohet sintaksës së shkrimtarit më të vjetër të letërsisë shqipe, shihet se që në shekullin XVI shqipja e shkruar kishte një sistem lidhëzor të plotë, të aftë për të shprehur

llojet kryesore të raporteve të ndryshme sintaksore. Sistemi lidhëzor i shqipes së mesit të sh. XVI, ashtu siç na dëshmohet te «Meshari» i Gjon Buzukut, paraqitet pa fjalë shumë më i thjeshtë se sistemi lidhëzor i shqipes së sotme, jo vetëm sepse që nga koha e autorit tonë e deri sot kanë rrjedhur më se katërqind vjet, kohë gjatë së cilës shqipja si gjuhë shkrimi, ka ecur shumë përpara në rrugën e saj të zhvillimit, por edhe sepse vëllimi i kufizuar i tekstit dhe vetë lënda e tij nuk do t'i kenë dhënë rast përkthyesit të përdorë edhe të tjera lidhëza që duhet të ketë pasur shqipja e asaj kohe.

Duke krahasuar sistemin lidhëzor të Buzukut me sistemin lidhëzor të gjuhës së sotme, bie në sy se, në pjesën më të madhe, në elementet e tija themelore më të rëndësishme, ky sistem është ruajtur, duke pësuar disa ndryshime në kushtet sintaktike e në dendurinë e përdorimit për lidhëza të veçanta. Kështu p.sh. lidhëza këpujore e në gjuhën e sotme nuk ka atë denduri që vumë në dukje për Buzukun (pavarësisht nga stili biblik i «Mesharit»), pasi sot përdoret mjaft shpesh lidhëza këpujore *dhe*, e cila mungon si te Buzuku, ashtu edhe te autorët e tjerë të vjetër. Gjithashtu denduria e përdorimit të lidhëzës *edhe* në gjuhën e sotme është më e lartë se te Buzuku.

Megjithatë, mund të vihet re lehtë se disa prej lidhëzave të Buzukut nuk kanë aritur deri sot e disa të tjera kanë pësuar ndryshime semantike. Nga lidhëzat që nuk kanë arritur deri sot, shumica janë huazime, si veçuesja *opur*, kundërshtoret *mā* e *pur* dhe qëllimorja *tekë*. Gjithashtu të dyja lidhëzat lejore të Buzukut *mirë se* (pas gjase kalk prej it. *benché* — shih f. 104 shënim 21) e *mirë se në* nuk janë ruajtur. Sot gjuha shqipe përdor të tjera lidhëza lejore, të cilat në kohën e autorit tonë më të vjetër nuk do të kenë qenë formuar. Lidhëza *ndonëse*, për shembull, del së pari te Pjetër Budi, dhe paraqitet me një larmi trajtash, çka dëshmon se ishte ende në formim e sipër<sup>76</sup>. Duke pasur parasysh këto, mund të themi se kategoria e lidhëzave lejore është më e reja ndër lidhëzat nënrenditëse të shqipes.

Ka edhe disa lidhëza të tjera që dalin vetëm te Buzuku ose që janë tipike për të p.sh. *a* si qëllimore, *mos* si këpujore mohore, *māse* si kundërshtore, *përse* si shkakore, qëllimore e ffilluese, *qysh* e *përsā* si kohore, lokucioni *porsi në* me vlerë krahasore, *sā ku* me vlerë kohore e ndonjë tjetër etj. Sot *mos* nuk përdoret më si lidhëz, po vetëm si pjesëz, nuk ndeshen gjëkund as lokucionet *porsi në* e *sā ku*, as kundërshtorja *māse*.

Për disa kategori lidhëzash bien në sy dallime të theksuara midis gjendjes së tyre te Gjon Buzuku dhe gjendjes së sotme. Te lidhëzat ffilluese mbizotëron *se-ja*, e përdorur me këtë vlerë 473 herë, ndërsa *përse* e *qi* janë përdorur si ffilluese përkatësisht 3 e 6 herë. Kjo statistikë tregon se vlera ffilluese e *qi-së*, të paktën për gegërishten, është më e vonë se e njëjta vlerë e *se-së*. Në gjuhën e sotme lidhëza *që*, siç dihet, ka një përdorim shumë të gjerë, por deri tani nuk janë studjuar mirë rrethanat e denduria e përdorimit të njërës e të tjetrës. Kategoria e lidhëzave vendore paraqitet mjaft e varfër, përfaqësohet vetëm prej *ku*, *tek* e *tuk*, që janë përdorur përkatësisht 4, 8 e 12 herë. Nuk dalin lidhëza vendore të përngjitura ose lokucione, me të cilat është e pasur gjuha e sotme. Ndoshta kjo

76) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* (dorëshkrim).

do shpjeguar me numrin e vogël të fjalive vendore lidhëzore (gjithësej 24), se është vështirë të mendohet që shqipja e sh. XVI të mos ketë pasur edhe lidhëza të tjera për të shprehur lloje të ndryshme marrëdhënesh vendore. Kategoria e lidhëzave kohore paraqitet relativisht e pasur si me lidhëza të thjeshta e të përngjitura, ashtu edhe me lokucione. Nga të parat sot *përsā*, *qysh* e *se* kanë dalë nga përdorimi, kurse të tjerat vazhdojnë të përdoren me po atë vlerë. Te lokucionet kohore bie në sy se gati gjysma e tyre janë formuar me pjesëmarrjen e përemrit lidhor *qi* dhe të emrit *herë*: *djerie mbë herë qi*, *gjithë herë qi*, *mbë herë qi*, *për gjithë herë qi*, *përherë qi*. Sot asnjë prej tyre nuk përdoret më, po, nga ana tjetër, janë formuar lokucione të reja të këtij tipi, si *kurdoherë që*, *gjithsaherë që*, ky i fundit mjaft i rrallë. Te lidhëzat kushtore të tërheq vëmendjen mungesa e *po-së* dhe mbizotërimi i përdorimit të *në-së* (301) herë mbi të tjerat: *në kloftë qi* e *në kloftë se* nga një herë dhe *se në* 4 herë. Megjithatë është me interes të shënohet se këto lokucione, që mund të duken pak a shumë si të reja, na dokumentohen që në sh. XVI. Ndoshta i takon Buzukut merita e formimit të tyre, po kjo gjë nuk mund të pohohet me siguri, ashtu siç as nuk mund të mohohet prerë. Lidhur me shprehjen e raporteve kushtore në gjuhën shqipe, është me interes të përmendim se te Buzuku nuk gjejmë raste të gërshetimit të raporteve kohore me raporte kushtore e të shndrimit, mbi këtë bazë, të lidhëzave kohore në kushtore. Një veçori karakteristike e gjuhës së Buzukut është edhe përdorimi i lidhëzës *përse* si lidhëz kryesore e shkakut dhe e qëllimit: ajo del 586 herë si shkakore, ndërsa shkakoret e tjera: *qi* 3 herë, *se* 50 herë e *si* 2 herë, dhe 333 herë si qëllimore, ndërsa qëllimoret e tjera: *a* 3 herë, *qi* 40 herë, *se* 17 herë e *tekë* 2 herë. Me këto kuptime lidhëzën *përse* e gjejmë edhe te autorë të tjerë të vjetër, po sot fjala *përse* nuk përdoret më si lidhëz, veçse në trajtën e sinkopuar *pse*. Kategoria e lidhëzave shkakore, që te Buzuku përfaqësohet vetëm nga katër lidhëza, tri të thjeshta *qi*, *se*, *si* dhe një e përngjitur *përse*, gjatë këtyre katër shekujve është pasuruar me mjaft lidhëza të reja, të përngjitura e lokucione, si *sepse*, *ngase*, *siç*, *pasi*, *derisa*, *meqë*, *ngaqë*, *meqenëse*, *duke qenë se*, *për shkak se*, *për arsye se* etj., po asnjë ndër to nuk ka denduri përdorimi aq të lartë mbi të tjerat, siç pamë për *përse-në* e Buzukut. Përsa u takon qëllimoreve, këtu bashkë me *përse-në* ka dalë nga përdorimi dhe lidhëza e thjeshtë *se* dhe barra kryesore e shprehjes së raporteve qëllimore ka rënë mbi lidhëzën *që*. Me pjesëmarrjen e kësaj lidhëze janë formuar edhe lokucionet qëllimore me *qëllim që* e *në mënyrë që*, nga të cilat i pari, në disa stile, ka një përdorim relativisht të gjërë. Kështu për kategorinë e lidhëzave qëllimore, ashtu si për ftillueset, mund të thuhet se ka pësuar më shumë ndryshime e zhvillime të brendshme cilësore, pa u zgjeruar nga pikëpamja sasiore. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për lidhëzat rrjedhimore. Këtu duhet përmendur dëshmimi që në sh. XVI i lokucioneve *aqë sã* e *ashtu qi* (në vend të këtij të fundit sot përdoret *kështu që*). Lidhëzat krahasore të Buzukut përdoren dhe sot me po ato kuptime, por denduria shumë e lartë e lidhëzës *porsi* (539 herë) në krahasim me *si* (84 herë), duhet parë si veçori e stilit të Buzukut, i cili duke e ndjerë dallimin midis *si* e *porsi* (kjo e fundit do të thotë «pikërisht si, tamam si», pra e jep në mënyrë më të qartë idenë e një krahasimi identiteti),

e ka gjykuar këtë si më të përshtatshme për karakterin e lëndës së librit të tij.

Nga libri i Buzukut mund të nxirren të dhëna me interes edhe për të hetuar kushtet e mënyrën e formimit të disa lidhëzave, siç kemi vënë në dukje në hyrje të këtij punimi.

Ky punim morfosintaktik për lidhëzat te Buzuku duhet të pasohet nga studime të këtij lloji edhe për autorët e tjerë të vjetër. Kështu mund të ndiqet hap pas hapi zhvillimi i strukturës së periudhës dhe i mjeteve lidhëse të shqipes që nga Buzuku e deri sot. Plotësimi i kësaj detyre është me rëndësi si për sintaksën historike ashtu edhe për historinë e zhvillimit gjuhës letrare.

Kur e kishin përfunduar këtë punim, u njohëm me një studim të A. Çirrinçones mbi sintaksën e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë, në pjesën e fundit të të cilit trajtohet sintaksa e periudhës<sup>77</sup>. Në të vërtetë autorja është mbështetur kryesisht te Buzuku e te Kristoforidhi, duke e klasifikuar edhe këtë të fundit në grupin e shkrimtarëve të vjetër. Për studimin në fjalë shpresojmë të paraqesim një recension te po kjo revistë, në një nga numrat e vitit të ardhshëm.

### *Pasqyra e lidhëzave sipas funksionit sintaktik*

#### A) Lidhëzat bashkërenditëse:

- 1) Lidhëza këpujore: *as, e, edhe, mos*;  
lokucione: *jo se...ma...edhe, jo se...por (edhe), pors...ashtu (edhe), si...ashtu (edhe)*.
- 2) Lidhëza veçuese: *a, ndo, o, opur, ose*.
- 3) Lidhëza kundërshtore: *ma (mā), māse, po, por, pur, veçëse*.

#### B) Lidhëzat nënrenditëse

- 1) Lidhëza ftilluese: *se, përse, qi*;  
lokucione: *se në*.
- 2) Lidhëza vendore: *ku, tek, tuk*.
- 3) Lidhëza kohore: *djerie, kur, mbassi, përsā, qysh, sā, se, si, tek, tuk*;  
lokucione: *djerie kur, djerie mbë herë qi, djerie mos, djerie sā gjithë herë qi, mbë herë qi, parë se, për gjithë herë qi, për herë qi, qish kur, sā ku*.
- 4) Lidhëza kushtore: *n(ë)*;  
lokucione: *në kloftë qi, në kloftë se, se në (se...në)*.
- 5) Lidhëza shkakore: *përse, qi, se, si*.
- 6) Lidhëza rrjedhimore: *qi, sā*;  
lokucione: *aqë sā, ashtu qi*.
- 7) Lidhëza qëllimore: *a, përse, qi, se, tekë*;  
lokucione: *ashtu qi*.
- 8) Lidhëza lejore: *mirë se, mirë se në*.
- 9) Lidhëza krahasore: *kinëse, kini, pors, sā, se, si*;  
lokucione: *pors në*.

77) Angela Cirrincione, *Sintassi Albanese degli antichi scrittori*, Roma 1968, 120 f.

## Pasqyra alfabetike e lidhëzave\*

- |  |  |
|--|--|
| 1. <i>a</i> veçuese 1                    | 37. <i>përse</i> fthilluese 3              |
| » qëllimore 3                            | » shkakore 586                             |
| 2. <i>aqë sã</i> rrjedhimore 1           | » qëllimore 333                            |
| 3. <i>as</i> këpujore 208                | 38. <i>po</i> kundërshtore 4               |
| 4. <i>ashtu qi</i> rrjedhimore 2         | 39. <i>por</i> kundërshtore 177            |
| » » qëllimore 4                          | 40. <i>porsi</i> krahasore 539             |
| 5. <i>djerie</i> kohore 14               | 41. <i>porsi...ashtu (edhe)</i> këpujore 2 |
| 6. <i>djerie kur</i> kohore 8            | 42. <i>porsi në</i> krahasore 7            |
| 7. <i>djerie mbë herë qi</i> kohore 1    | 43. <i>pur</i> kundërshtore 4              |
| 8. <i>djerie mos</i> kohore 8            | 44. <i>qi</i> fthilluese 6                 |
| 9. <i>djerie sã</i> kohore 5             | » shkakore 3                               |
| 10. <i>e</i> këpujore 8071               | » rrjedhimore 2                            |
| 11. <i>edhe</i> këpujore 10              | » qëllimore 40                             |
| 12. <i>gjithë herë qi</i> kohore 1       | 45. <i>qish kur</i> kohore 1               |
| 13. <i>jo se...ma...edhe</i> këpujore 1  | 46. <i>qysh</i> kohore 5                   |
| 14. <i>jo se...por (edhe)</i> këpujore 5 | 47. <i>sã</i> kohore 19                    |
| 15. <i>kinëse</i> krahasore 2            | » rrjedhimore 10                           |
| 16. <i>kini</i> krahasore 1              | » krahasore 5                              |
| 17. <i>ku</i> vendore 4                  | 48. <i>sã ku</i> kohore 2                  |
| 18. <i>kur</i> kohore 131                | 49. <i>se</i> fthilluese 473               |
| 19. <i>ma (mã)</i> kundërshtore 103      | » kohore 5                                 |
| 20. <i>mãse</i> kundërshtore 19          | » shkakore 50                              |
| 21. <i>mbassi</i> kohore 27              | » qëllimore 17                             |
| 22. <i>mbë herë qi</i> kohore 1          | » krahasore 90                             |
| 23. <i>mirë se</i> lejore 6              | 50. <i>se n(ë)</i> fthilluese 1            |
| 24. <i>mirë se në</i> lejore 4           | » » kushtore 1                             |
| 25. <i>mos</i> këpujore 50               | <i>se...në</i> kushtore 3                  |
| 26. <i>ndo</i> veçuese 2                 | 51. <i>si</i> kohore 124                   |
| 27. <i>n(ë)</i> kushtore 301             | » shkakore 2                               |
| 28. <i>në kloftë qi</i> kushtore 1       | » krahasore 84                             |
| 29. <i>në kloftë se</i> kushtore 1       | 52. <i>si...ashtu (edhe)</i> këpujore 4    |
| 30. <i>o</i> veçuese 136                 | 53. <i>tek</i> vendore 8                   |
| 31. <i>opur</i> veçuese 1                | » kohore 5                                 |
| 32. <i>ose</i> veçuese 1                 | 54. <i>tekë</i> qëllimore 2                |
| 33. <i>parë se</i> kohore 22             | 55. <i>tuk</i> vendore 12                  |
| 34. <i>për gjithë herë qi</i> kohore 1   | » kohore 2                                 |
| 35. <i>përherë qi</i> kohore 1           | 56. <i>veçese</i> kundërshtore 1           |
| 36. <i>përsã</i> kohore 4                |  |

\*) Përbri çdo lidhëze shënohet funksioni sintaktik dhe numri i përdorimeve të saj me atë funksion.

## R é s u m é

## LES CONJONCTIONS DANS LE PREMIER LIVRE EN ALBANAIS

Dans ce travail est traité le système des conjonctions de l'albanais au XVII<sup>e</sup> siècle, d'après la matière qu'offre le «Missel» ou «Livre d'heures» de Gjon Buzuku (1555), le texte le plus ancien qu'on connaisse de la littérature albanaise. L'auteur Lafe est en train de préparer le vocabulaire complet de cet écrivain, et il a mis sur fiches, à cette intention, tout mot du livre, indiquant sa fréquence. C'est ainsi qu'il a formé une cartothèque d'environ 80 mille fiches. Celle-ci lui a permis de traiter dans cette étude en détail les valeurs des conjonctions, les circonstances syntaxiques de leur emploi et de donner pour toute conjonction une statistique exacte.

Le travail en question comporte deux parties. Dans la première sont traités les types de conjonctions au point de vue de leur origine et de leur construction. A cet égard, l'auteur Lafe a réparti les conjonctions employées dans le «Missel» en deux groupes; a) primaires, «originaires», c'est-à-dire qui ne dérivent pas d'autres parties du discours et b) dérivées, c'est-à-dire formées par d'autres parties du discours. Dans le premier groupe rentrent les conjonctions *e*, *edhe*, *ma*, *në*, *o*, *opur*, *po*, *por*, *pur*, *tekë*. De celles-ci, la disjonctive *opur* (utilisée une seule fois) et l'adverbatif *pur* (employée quatre fois) proviennent à l'évidence de l'it. *oppure*, *eppure*, tandis que *tekë*, employée comme finale, représente un turquisme emprunté par l'intermédiaire du serbocroate et ne résulte point chez les autres auteurs anciens.

Les conjonctions dérivées, qui constituent le deuxième groupe, sont plus nombreuses que les primaires et ont, au point de vue de leur construction, la facture simple, agglutinée ou bien celle des locutions. Les conjonctions simples sont de deux sortes, au point de vue de leur source: une partie, *ku*, *kur*, *si*, *tek*, *tuk* se rattachent génétiquement à des adverbes pronominaux et semblent être assez anciennes dans la langue; les autres, *qi*, *qysh*, *sā*, *se*, sont formées à partir de formes causales figées des pronoms interrogatifs et conjonctifs. I compte encore trois conjonctions simples de source non pronominale: la disjonctive *a*, qui dérive de la particule interrogative *a* la comparative *kini*, qui n'est autre que la forme de la deuxième personne du pluriel impératif du verbe «avoir», et la temporelle *djerie*, qui est dans le même temps aussi une préposition.

Les conjonctions juxtaposées ont, d'ordinaire, le deuxième élément de la juxtaposition une conjonction pronominale simple; en revanche, le premier élément peut être:

- encore une conjonction: *ose* (< *o+se*), *porsi* (< *por+si*),
- une préposition: *mbassi* (< *mbas+si*), *përsā* (< *për+sā*),  
*përse* (< *për+se*),
- ou bien un adverbe: *māse* (< *mā+se*), *veçëse* (< *veç+se*).

Il y a encore trois conjonctions juxtaposées, formées sans la participation de quelque simple conjonction pronominale: *as* (particule interrogative *a* + particule négative *s*), *mos* (une particule négative formée par l'agglutination de deux particules négatives *mo+s*, employée chez Buzuku comme conjonction copulative avec le sens «as») et *n̄do* (< conjonction conditionnelle *në* + verbe (*ti*) *do*).

Le «Missel» ou «Livre d'heures» de Gjon Buzuku compte encore environ vingt-cinq locutions. La plupart de celles-ci sont formées avec le concours d'une conjonction simple, qui occupe dans la locution la dernière place. Le mot ou les autres mots peuvent être:

- a) des adverbes: *aqë sā*, *ashtu qi*, *mirë se*, *parë se*, *sā ku* (dans la dernière locution la conjonction *sā* est placée avant l'adverbe *ku*);

- b) des prépositions: *djerie kur, djerie sã, qish kur;*
- c) une forme verbale: *kinë se;*
- d) une forme verbale précédée par une autre conjonction: *në kloftë qi, në kloftë se;*
- e) des conjonctions *porsi në, se n(ë);*
- f) une particule *djerie mos* (la particule *mos* de cette locution se trouve placée après la conjonction *djerie*).

Un certain nombre d'autres locutions sont formées avec le concours du pronom conjonctif *qi*. Dans toutes ces locutions qui ont une valeur temporelle, le pronom *qi* se rapporte au nom *herë* ou bien à l'adverbe *përherë*, qui contient ce nom: *gjithë herë qi, për gjithë herë qi, mbë herë qi, djerie mbë herë qi, përherë qi*.

L'autre groupe de locutions est formé par celles appelées conjonctions doubles: *jo se... ma... edhe, jo se... por (edhe), porsi... ashtu, si... ashtu, se... në*. Les quatre premières sont des locutions caractéristiques copulatives, la dernière une locution conditionnelle.

La deuxième partie de ce travail est intitulée: *Types de conjonctions au point de vue des fonctions syntaxiques, observations sur leur emploi*.

C'est en appliquant la division traditionnelle des conjonctions coordonnées et subordonnées, et de chacun de ces deux groupes en des sousgroupes particuliers, que l'auteur a brossé en détail les sens et les diverses circonstances d'usage pour chacune des conjonctions. La deuxième partie du travail résulte être ainsi, en fait, une syntaxe des propositions réunies par des conjonctions chez Gjon Buzuku. Un intérêt particulier offrent les données statistiques et les comparaisons avec la langue actuelle. Les conjonctions coordonnées font état des trois groupes suivants:

- a) copulatives: *as, e, edhe, mos, jo se... ma... edhe, jo se... por (edhe), porsi... ashtu (edhe), si... ashtu (edhe);*
  - b) disjonctives: *a, ndo, o, opur, ose;*
  - c) adversatives: *ma (mã), mãse, po, por, pur, veçese:*
- Les conjonctions subordonnées sont divisées en:
- a) explicatives: *se, përse, qi, se në;*
  - b) locatives: *ku, tek, tuk;*
  - c) temporelles: *djerie, kur, mbassi, përsã, qysh, sã, se, si, tek tuk, djerie kur, djerie mbë herë qi, djerie mos, djerie sã, gjithë herë qi, mbë herë qi, parë se, për gjithë herë qi, përherë qi, qish kur, sã ku;*
  - d) conditionnelles: *n(ë), në kloftë qi, në kloftë se, se në;*
  - e) causales: *përse, qi, se, si;*
  - f) finales: *a, përse, qi, se, tekë; ashtu qi;*
  - g) consécutives: *qi, sã, aqë sã, ashtu qi;*
  - h) concessive: *mirë se, mirë se në;*
  - i) comparatives: *kinëse, kini, porsi, sã, se, si; porsi në.*

Au total, les 188 pages conservées entières du «Missel» de Gjon Buzuku font état de 56 conjonctions (simples, juxtaposées et locutions), dont dix usitées à deux ou plusieurs acceptions. Si l'on compte ces dernières comme des mots à part pour toute acception qu'elles peuvent assumer, alors le nombre général des conjonctions atteint les 75, dont 26 ne sont usitées qu'une seule fois, et 9 seulement deux fois chacune. De là, on constate une forte disproportion dans la fréquence d'usage des conjonctions. Cela peut être observé parfaitement dans le tableau récapitulatif alphabétique des conjonctions, que l'auteur a insérée à la fin de son travail.

Néanmoins, on peut affirmer que dans le premier siècle de son existence comme langue littéraire, l'albanais avait un système parfait de conjonctions, apte à extérioriser les principaux genres de rapports syntaxiques différents. Tout de même, le système de conjonctions de l'albanais de la moitié du XVe siècle se présente indubitablement, comme le confirme d'ailleurs le «Missel» de Gjon Buzuku, bien

plus simple que le système albanais des conjonctions actuelles, non seulement en raison du fait que depuis le temps de l'auteur et à nos jours soient passés plus de quatre siècles, temps durant lequel l'albanais littéraire a marché beaucoup sur sa voie de développement, mais aussi en raison du fait que le volume limité du texte et le caractère même de la matière qu'on y traite n'ont pas pu donner l'occasion d'employer encore d'autres que doit avoir compté l'albanais de cette époque.

Si l'on compare le système de conjonctions de Buzuku avec celui de la langue d'aujourd'hui, on est frappé que ce système ait été conservé, en sa plus grande partie, dans ses éléments fondamentaux et plus importants. Les quelques modifications ne sont que le ressort des conditions syntaxiques et de l'intensité d'usage pour des conjonctions isolées.

Tout de même, on peut remarquer fort bien que plusieurs des conjonctions de Buzuku n'ont pas rejoint nos jours, que d'autres ont subi des modifications sémantiques. De conjonctions qui n'ont pas rejoint nos jours, la plupart sont des emprunts, comme la disjonctive *opur*, les adversatives *mā* et *pur*, et la finale *tekë*. De même, les deux conjonctions concessives de Buzuku *mirë se* (selon toute vraisemblance, un calque de l'it. *benchè*) et *mirë se në* n'ont pas été conservées. La langue actuelle albanaise emploie d'autres conjonctions concessives, qui aux temps de notre plus ancien auteur ne devraient pas avoir été formées. La conjonction *ndonëse*, p.ex., résulte tout d'abord chez Pjetër Budi, et offre une variété de formes, ce qui atteste qu'elle était encore en cours de formation. Compte tenu de tout cela, on peut affirmer que la catégorie des conjonctions concessives est la plus récente entre les conjonctions de subordination de l'albanais.

On a encore d'autres conjonctions qui résultent seulement chez Buzuku ou bien qui sont typiques à lui, p.ex. *l'a* comme finale, *mos* comme copulative négative, *māse* comme adversative, *përse* comme causale, finale et explicative, *qysh* et *përsā* comme temporelles, la locution *porsi në* de valeur comparative, *sā ku* de valeur temporelle et quelque autre, etc. *Mos* n'est pas usité actuellement comme conjonction, mais seulement comme particule; on ne rencontre nulle part non plus les locutions *porsi në* et *sā ku*, et non plus l'adversative *māse*.

Pour quelques catégories de conjonctions on est frappé par des distinctions entre leur état chez Gjon Buzuku et la situation actuelle. Du nombre des conjonctions explicatives prédomine *se* employé avec cette valeur 473 fois; en revanche, *përse* et *qi*, usitées comme explicatives, se réduisent respectivement à 3 et 6 emplois. Cette statistique indique que la valeur explicative du *qi*, du moins pour le guègue, est plus récente que la même valeur de *se*. En albanais actuel, la conjonction *që* a, comme on sait, un usage beaucoup plus large, mais jusqu'à maintenant n'ont pas été étudiées dûment les circonstances et l'intensité d'usage de l'une ou de l'autre. La catégorie des conjonctions locatives se présente encore plus pauvre. Elle est représentée seulement par *ku*, *tek* et *tuk* qui tiennent l'usage respectivement 4, 8 et 12 fois.

Ne résultent pas des conjonctions locatives juxtaposées ou locutions, dont est riche la langue actuelle. Cela doit être expliqué, vraisemblablement, par le petit nombre de propositions locatives conjonctives (en tout 24), compte tenu qu'il serait difficile de supposer que l'albanais du XVI<sup>e</sup> siècle n'ait pas eu aussi d'autres conjonctions à extérioriser différents genres de rapports locatifs. La catégorie des conjonctions temporelles se présente relativement riche tant de conjonctions simples et juxtaposées, que de locutions. Des premières sont désuètes actuellement *përse*, *qysh* et *se*, tandis que les autres tiennent toujours l'usage avec la même valeur.

Du nombre des conjonctions conditionnelles l'attention est attirée par l'absence de *po* et la prédominance dans l'usage de *në* (301 fois): *në kloftë qi* et *në kloftë se*, chacune une fois, et *se në*, quatre fois. Tout de même, il est intéressant de noter que ces locutions, qui peuvent paraître plus ou moins récentes, sont documentées depuis

le XVI<sup>e</sup> siècle. C'est peut-être à Buzuku que revient le mérite de leur formation, mais cela ne peut être affirmé avec certitude, comme ne peut être affirmé définitivement.

Pour ce qui est de l'extériorisation des rapports conditionnels en albanais, il est intéressant de mentionner que chez Buzuku on ne trouve pas des cas d'enchevêtrement des rapports temporels avec des rapports conditionnels et de la mutation, sur cette base, des conjonctions temporelles en conditionnelles. Une particularité caractéristique de la langue de Buzuku est aussi l'usage de la conjonction *përse* comme principale conjonction de cause et de but: elle résulte 586 fois comme causale, tandis que des autres causales on a: *qi* 3 fois, *se* 50 fois et *si* 2 fois; elle résulte 333 fois comme intentionnelle, tandis que les autres finales on a: *a* 3 fois, *qi* 40 fois, *se* 17 fois et *tekë* 2 fois.

Dans ces acceptions nous retrouvons la conjonction *përse* également chez d'autres auteurs anciens, mais aujourd'hui le mot *përse* n'est plus usité comme une conjonction, que sous la forme syncopée *pse*.

La catégorie des conjonctions causales, qui chez Buzuku est représentée seulement par quatre conjonctions, trois simples *qi*, *se*, *si*, et une agglutinée *përse*, s'est enrichie au cours de ces quatre siècles de plusieurs nouvelles conjonctions, juxtapositions et locutions, comme *sepse*, *ngase*, *siç*, *pasi*, *derisa*, *meqë*, *ngaqë meqenëse*, *duke qenë se*, *për shkak se*, *për arsye se*, etc. Pourtant, aucune de celles-ci n'enregistre une intensité d'usage aussi élevée sur les autres, que celle que nous venons de voir dans le *përse* de Buzuku.

Pour ce qui est des finales, ici avec *përse* est tombée en désuétude aussi la conjonction simple *se*, du fait que la principale charge d'extériorisation des rapports intentionnels est tombée sur la conjonction *që*. C'est avec le concours de cette conjonction qu'ont été formées aussi les locutions finales *me qëllim që* et *në mënyrë që*, dont la première enregistre, en certains styles, un usage relativement ample. Ainsi, on peut faire remarquer pour la catégorie des conjonctions finales, de même que pour celles explicatives qu'elle a enregistré un plus grand nombre de mutations et de découvertes qualitatives intérieures, sans s'élargir pour cela au point de vue de la quantité.

La même observation peut être faite aussi pour les conjonctions consécutives. On doit mentionner en cela l'attestation au XVI<sup>e</sup> siècle des locutions *aqë sa* et *ashtu qi*, et que, au lieu de cette dernière on emploie, actuellement, *kështu që*. Les conjonctions comparatives de Buzuku sont employées aussi de nos jours avec les mêmes acceptions, mais l'intensité très forte de la conjonction *porsi* (539 fois) par rapport à *si* (84 fois) doit être considérée comme une particularité du style de Buzuku. Celui-ci, ressentant la distinction entre *si* et *porsi* (cette dernière signifie «exactement comme, précisément comme»), donc fournit d'une façon plus évidente l'idée d'une comparaison d'identité), l'a considérée comme plus idoine pour le caractère de la matière de son livre.

Du livre de Buzuku on peut tirer des données intéressantes à suivre également les conditions du mode de formation de quelques conjonctions, comme nous l'avons fait ressortir dans la partie introductive de ce travail.

Ce travail à la fois morphologique et syntaxique sur les conjonctions chez Buzuku doit être suivi par des études de ce genre aussi sur les autres auteurs anciens. Ainsi, on pourra suivre pas après pas le développement de la structure de la période et des moyens de conjonction en albanais depuis Buzuku jusqu'à nos jours. Cette tâche a son importance aussi pour la syntaxe historique au même titre que pour l'histoire de l'évolution de la langue littéraire.